KUQ E ZI – 2012 - VITI XX Nr.69 .

K U Q E Z I

REVISTE KULTURORE EURO–SHQIPTARE

28 NENDOR
1912-2012

RROFTË
100 VJETORI I PAVARËSISË

Shqiptarve s'kanë ç'u duhën ideologjitë e hueja duke pasë një te vetmën të tynën, Shqiptarizmin, Idealin Kombëtar.

THEMELUE NE BRUKSEL
ME TETOR 1993
E DREJTUE
NGA LEK PERVIZI

BASHKEPUNTORE

Myrteza Bajraktari, Robert Elsie,
H.-J. Lanksch, Mergim Korça,
Thanas Gjika, Frtiz Radovani,
Daniel Gazulli, Paul Tedeschini,
Tomorr Aliko, Piro M. Tase,
Arben Sebastej, Mark Bregu,
Gjovalin Kola, Kastriot Marku,
Visar Zhiti, Peter Tase,
Lahutari Shqiptar,

PAJTIMI VJETOR

Belgjikë.....40 Euro
Europë.....50 "
Amerikë, Australi.....60 "
Shqipni, Kosovë.....20 "

Pranohën ndihma të
veçanta vullnetare

==========

PAGESAT
Me llogari Bankare ose
Postë të thjeshtë
Llogari Bankare

Nr. 001-2138758-81
BNP PARIBAS FORTIS
BELGIQUE
Adresa :
Revista Kuq e Zi
Rue de la Victoire, 18
1060 Bruxelles
Belgique
E-mail : lekpervizi@gmail.com

Bahen edhe porosi blerje librash që disponojmë.
Kontaktoni me email të mësipërm.

PERMBAJTJE

* Editorial Historik
Lek Pervizi 4

* Kngresi i Manastirit
Redaksia..... ...6

* Nderimin të njeriut që themeloi shtetin shqiptar
Musa Ahmati……...8

* Miresevjen Meshar….
Visar Zhiti……11

* Në kopshtin e Gestemanit
Fritz Radovani.....12

* Kambanat e Zotit për mikun tonë…
Kole Traboini……. 13

* Daniel Gazulli, jetshkrim
Krist Gjinaj……14
* Poezi të përkthyeme
Daniel Gazulli……14

* Skënderbeu ifshehur ndër arkivat greke
Aren Llalla…… …15

* Greva e Urisë
Mediat…….....15
* Flamuri në Deçiç
Palok Traboini……17
* Pse Skënderbeu nuk duhet me fol toskrisht ?
Nik Klementi…….. 18
* Papa Klementi
Vlash Prendi…… …19
* Konica në Bruksel
Agron Shele…….....23
* Kush kishtevma të drejtë…
Redaksia……24.
* Nji Nanë…100 Nana…
Jozef Razdi……..25
* The dangerous truth abaout communist crimes
David Satter……...27
* Te huajt për Shqipërinë e Shqiptarët
Piro M. Tase……..28
* Loro Boriçi, bir'I denjë I Shkodrës
Fran Radoja……...31
* Objekte figurative kushtuar Skënderbeut
Ilia Karanxha……..33

GEZUAR
100 VJETORIN
E PAVARESISE

ISMAIL QEMALI
Vlorë, 28 Nëndor 1912

EDITORIAL HISTORIK

100 Vjetori i Pavarësisë erdhi.

Gjithë Kombi Shqiptar po e prêt ditën e madhe me padurim. Shumë shqiptarë plot entuziazëm patriotik janë nisun në kambë nga Kosova e Maqedonia drejt Vlorës, me marrë pjesë në këtë ngjarje të madhe të papërsëritshme për brezat e tanishëm. Ato do t'u tregojne nipave e stërnipave se si udhëtuen nëpër Shqipni si dikur Isa Buletini me trimat e tij, për me e festue 28 Nëndorin 2013 në 100 vjetorin e tij. Pikërisht atje
në Vlorën heroike ku Ismail Qemali me atdhetarët e tjerë ngrii Flamurin e Gjergj Kastriotit Skënderbeut duke shpallun botnisht Lirinë e Pavarësisnë e Shqipnisë, pas 500 vjet robni, nën turkun aziatik, që e kishte lanë vendin në prapambetje e injorance të plotë. Tue i mohue gjuhën e të drejtat qytetare, e tue i trajtue shqiptarët si skllavë e merçenarë, kudo që ia kërkonte nevoja. Tue i tretun larg ne vise të hueja, për t'i përdorun si mish për top. Vërtet se i ngrit disa shqiptarë në pozita të nalta deri si vizirë e pashallarë . Por ç'banë këta për vendin e tyne ? A nuk ishin pashallarë shqiptarë që i shtypnin kryengritjet e popullit të tyne me hekur e zjarr ? Por Zoti ua ktheu për së mbari mendjën në kohët e fundit, dhe ia kushtuen jetën e veprimtainë e tyne, rilindjës shqiptare. Ringjalljsë së këtij kombi aq të lashtë, që perandoria turke e kishte varrosun, sipas saj, përgjithmonë. Por jo, shqiptarët si një trup i vetëm u çuen si legëndari Gjergj Elez Alia për ta mposhtun Balozin e zi aziatik. Brohoria e popullit shqiptar ditën e 28 nëndorit 1912, dhe bataret përshëndetëse të armëve ushtuen mbi mbarë botën. Shqipnia kishte fitue Lirinë e Pavarësinë. Rroftë Liria ! Rroftë Pavarësa ! Rroftë Flamuri kuq e zi ! Rroftë Kombi Shqiptar ! U deshën jo vetëm 500 vjet por mijavjeçarë që Kombi Shqiptar të dilte para botës krenar dhe i pamposhtun. Që në harta e botës, në globin tokësor, të shënohëshin kufijt e Shqipnisë dhe emni Albania. Vërtet të cunguem e të mohuem në madhësin e tyne të vërtetë, por kryesorja u njoh zyrtarisht shteti shqiptar faktik, me kufij e me qeveri e administratë shqiptare. Turkia na kishte marrë të keqen e kishte thye qafën, përtej grykës së Dardaneleve. Të atyne Dardanëve luftëtarë trima që dikur sundonin gjithë Azinë e Vogël. E kjo binte simbolike për shqiptarët, pasardhësit e Dardanëve të lashtë, që zunë vend pas Luftës së Trojes në Kosovën e tanishme, qe ahere quhej Dardani. Këto shtjellime rikujtohën në këtë ditë të madhe historike, e shenjtë për çdo shqiptar. Kështu, ndonse me vonesë vitesh e shekujsh, haka shkoj te i zoti, Shqipnia i fitoj Lirinë e Pavarësinë aq të dëshirueme prej shekujsh. Ishte Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i pari ndër shqiptarët e mëdhej, që e ngriti flamurin me shqipen dykrenëshe në kalanë e Krujës më 28 Nëndor 1443, 570 vjet ma parë, dhe foli burrnisht : « Lirinë nuk ua solla unë, atë e gjeta midis jush ! Rrnoftë Liria ! » Ishte Gjergj Kastrioti që mrekulloi botën me veprat e mëdha luftarake, duke i ba ballë fitimtar fuqisë ma të madhe të kohës, që ishte perandoria osmane. Ishte pra, Skënderbeu që e bani të njohun Europës se në gjinin e saj ishte i përfshimë një popull i lashtë, një komb i vjetër, Kombi Shqiptar. Prandaj me 28 Nëndor 1912 Liria e Pavarësia do të shpallëshin me ngritjën e Flamurit të Kastriotit. Po ashtu do të festohen 100 vjetori me atë Flamur e kështu në gjithë përvejetorët e ardhshëm.

Por shqiptarëve u desh të përballonin edhe stuhi të tjera shkatërruese. Padrejtësi historike të pashëbëëlta. Pushtimn e huej të Italisë fashiste, dhe dikaturën e tmerrshme komuniste, që bani kërdinë në popullin e vet. Nuk ka penë, as nuk i përshkreu as fjala, krimlet qe bani terrori komunist në Shqipni. Tue eliminue e asgjesue, intelektualët e patriotët ma të shquem e familjet e mëdha të Shqipnisë. Tue e izolue vendin nga bota, nga perparimi e zhvillimi, e tue klthye në një gjendje prapambetje e vorfnie, materiale, mendore e shpirtnore. Pasojat, mjerisht, vazhdojnë të ndihen edhe sot e kesaj dite, me një çoroditje absurde që ka përfshi botën politike shqiptare, që nuk gjenë një gjuhë të përbashkët për mirëvajtjën e vendit dhe krenarin e Kombit Shqiptar.

Lek Pervizi :
Gëzuar 100 vjetori !

Qoftë i mbarë ky 100 vjetor për të ua kthye mendjen ne vend politikanëve dhe partive, që t'i kushtohen seriozisht e me mirëkuptim e marrëveshje reciproke dhe te sinqerte, problemeve vendore e kombetare. Te vlejë kjo festë e madhe për lehtësimin e pranimit të Shqipnisë në Bashkimin Europian, ku patjetër do të gjejnë zgjidhje gjithë problemet shqiptare. Nuk kemi se ç'shtojmë ma gjatë, sepse vetë kremtimi i 100 vjetorit të Pavarësisë, flet ma së miri dhe e lëshon mesazhin e tij urues për një Komb Shqiptar të Bashkuem.

Rroftë 100 vjetori i Pavarësisë !

Rroftë 28 Nëndori !

Rroftë
Flamuri Kuq e Zi !

Rroftë Kombi i Bashkuem Shqiptar !

FLAMURTARË HISTORIKË TË LIRISË

GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEG
Krujë, 28 Nëndor 1443

Vlorë 28 Nëndor 1912

FLAMURI KOMBETAR
që u ngrit në Vlorë
më 28 Nëndor 1912.

DED GJO LULI
Deçiç, 1911

LUIGJ GURAKUQI
Vlorë, 28 Nëndor 1912

MURAT TOPTANI
Vlorë, 28 nNndor 1912

GJIN PJETER PERVIZI
Milot, 28 Nënsor 1912.

DOM NIKOLL KACORRI
Vlorë, 28 Nëndor 1912



AVDI TOPTANI
Vlorë, 28 Nëndor 1912

Nder e lavdi Luftëtarve e Patrtiotëve

Të Rindjës Kombëtare Shqiptare !

ARMET E GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEU NE TIRANE NGJARJE HISTORIKE E MADHE

Armët e Skënderbeut erdhën në Shqipni për 100 vjetorin e Pavarësisë, dhe do të mbahë t'ekzpozueme në Muzeumin Kombëtar qe ti i admirojë populli. Kjo në sajë të Shtetit mik austria, që ka dashun të nderojë shqiptarët në Jubileun e madh të 100 vjetorit , që në figurën e Skënderbeut e shohin veten të identifikuem si Komb e popull shqiptar.

Qeveria Austriake i beri këtë nder të madh popullit shqiptar, që me sytë e vet të shohë ato armë që për 25 vjet, sa qe gjallë Gjergj Kastrioti Skënderbeu, i kallën tmerrin turk-osmanllive duke ua shpartallue ushtritë njena pas tjetrës. Këto armë ruhën në Muzeumein e Vienës prej 550 vjet. Nuk ka ma ngjarje të madhe për shqiptarët e vërtetë që të shohin me sytë e tyne ato armë të lavdishme dhe atë shpatë mizore që tmerronte sulltanët, sa që kujtonin mos ishte ndonjë shpatë magjike. Diçka magjike ishte, sepse magjia qendronte ne krahun e fuqishëm të Gjergj Kastriotit Skënderbeut.

Me pamjen e këtyne armëve, na duket sikur e kemi aty vetë Kryetrimin, Heroin e Madh të Kombit Shqiptar. i gatshëm me rrok shpatën, si dikur, në mbrojtje të trojeve arbnore, me i shpartallue përsëri ushtritë anadollake që akoma e kanë synimin te Shqipnia e vogël, por që ka nxierrë një vigan të madh të cilit nuk mund t'i baje ballë askush. Aq ma pak turkoshakët që 28 Nëndori 1912 i përzuni përfundimisht përtej Bosforit, pë të mos guxue ma kurrë me shkel mbi trojet shqiptare.

Kongresi i Manastirit priu pavarësinë e shtetit shqiptar

PERPJEKJET PER ALFABETIN E SHQIPES

Rruga e shkronjave shqipe, është rruga e gjuhës dhe historisë së popullit shqiptar. Rruga e shkronjave shqipe, është rruga e shkollës e librit dhe shkrimit shqip. Rruga e shkronjave shqipe, është rruga e jetës dhe rruga e lirisë shqiptare.

Tash kur shkruajmë këta rreshta, në shënim të përvjetorit të shkronjave shqipe. Kthehemi 104 vjet mbrapa, më 14-22 nëntor të vitit 1908 në Manastir, tash qytet nën juridiksionin e Maqedonisë, ku pat filluar punimet Kongresi me rëndësi të madhe për gjuhën, kulturën, historinë dhe çështjes shqiptare përgjithësisht. Ruga e shkronjave shqipe, është rruga e gjuhës dhe hsitorisë së popullit shqiptarë. Rruga e shkronja shqipe, është rruga e shkollës e librit dhe shkrimit shqip. Rruga e shkronja shqipe, është rruga e jetës dhe rruga e lirisë shqiptare. Kongresi i Manastirit, tuboi personalitetet më të ditur, intelektualët dhe shkrimtarët më të angazhuar të gjuhës, letërsisë dhe kulturës shqiptare, të cilët në këtë kongres do të vendosnin njërën nga problemet themelore të gjuhës shqipe, vendosjen e një alfabeti të shqipes. Kongresi i Manastirit u mblodh në kohën, kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare, po arrinte kulmin e qëllimet e saj kundër synimeve osmane e sllavo-greke, për të cilën shumë patriotë e pishtarë të shkrimit të shqipes flijuan jetën. Përpjekjet e tyre për shqipen e shkruar kishin një vazhdë të përgjakshme në kohë dhe hapësirë shqiptare. Që nga viti 1462, kur merret dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe e gjerë në vitin 1908, kur u mbajt Kongresi i Manastirit, 36 shkronjat, shenjat grafike të cilat shënojnë 36 tingujt e gjuhës sonë, kaluan rrugë të mundimshme, shkronjat tona kaluan këtë rrugë sa edhe vet populli që fliste gjuhën e këtyre shkronjave. Sa me të drejtë Sami Frashri për këtë thotë; "Është për tu çuditur, qysh ka rrojtur gjerë më sot kombi shqiptarë, duke mos shkruar e duke mos kënduar gjuhën e vetë, kur janë humbur kaq kombe, që shkruanin e këndonin gjuhën e tyre. Siç janë syrjanët, kaldënjasit, latinët e të tjerë". Kushtet e egra që i rrezikonin nga të gjitha anët, të cilat i kaloi alfabeti ynë, që nga osmanët që synonin të përhapnin përmes mejtepeve e medreseve sa më bindshëm fenë islame e kultin e saj, në të cilat shkrimi i fëmijëve shqiptarë bëhej me alfabet arab. Kishat në anën tjetër vepronin me alfabet latin e grek, e një kohë edhe me atë sllav. Kishin të vetmin qëllim, shkombëtarizimin e shqiptarëve, sepse ndjenja shqiptare ishte pengesë që jo vetëm pengonte fenë islame dhe shtrirjen e ortodoksizmit, por, ajo edhe urrehej me gjelazi në formë e përmbajtje primitive. Patriarkana Greke, aleate e

këtij morali të keq, mundohej me gjitha mjetet të formojë bindje, se shqiptarët janë të topitur për kulturë, madje shqiptarët nuk kanë asnjë dëshmi nga e kaluara e tyre primitive. Ky veprim grek mundohej të bind opinionin e kohës, se shqiptarët që më kohë nuk kanë pasur elementinqenësor kombëtar GJUHËN, mjetin elementar, jo vetëm kulturor, por edhe kombëtar. Ata injoronin, se gjuha e shqipe është gjuhë barbare. Andaj e mallkonin dhe e ndëshkonin çdo shqiptarë, që përpiqej të shkruante e të mësonte gjuhën kombëtare. E si duket, çdo veprim që me masa shtrënguese mundohej ta ndalonte i huaji, shqiptarëve iu shtonte rrezistencën. Kjo përpjekje e vetëdisimit shumë shqiptarë të moteve të rëndë i ka bë të mëdhenj kombëtarisht. Përkundër urrejtjes e represalieve të të huajve kundër gjuhës, kulturës dhe popullit tonë, iluministët tanë, dëshmorë të gjuhës e kombit, kurrë nuk u përulën para sakrificave. Me vetsakrificë ata shkruanin abetare e tekste shkollore dhe ato i shpërndanin ndër bashkombasit, që të mësojnë gjuhën e tyre. Në këto rrethana, ata hapën edhe shkollat e para, si ajo e Korçës dhe simotrat e saj të mëvonshme. Nuk ka dyshim se fara e hedhur nga Naum Veqilharxhi, Pandeli Sotiri, P. K. Negovani, P. N. Luarasi e rreshti i madh pas këtyre pishtarëve të arsimit tonë kombëtarë, do të jetë ftillues i mbarsëm nga farëhedhësit e mirë, të niset kjo rrugë e mbarë e të vijë gjerë në ditët tona. Pionierët e saj të nderohen e të çmohen prej gjithë breznive që vijnë pas tyre. Kësaj rrugë të trasuar, kësaj kulle të madhe e të fortë, të cilës themelin ia vuan pishtarët tanë të lavdishëm, më vonë çdo shqiptarë atdhedashës "i ka vuar nga një gurë, që ajo të jetë edhe më e madhe e më e fortë". Kjo është kalaja e kulturës sonë kombëtare sot.

Alfabeti ishte problem i dorës së parë për gjithë shqiptarët përparimtarë të shekullit 19-të. Megjithëkëtë, ky shekull kaloi pa e zgjedhur problemin e shkronjave të shqipes. Edhe pse kësaj rrugë rrugëtuan personalitetet e gjuhës dhe kulturës kombëtare, që nga Buzuku, Budi, Bogdani, Matrënga, Bardhi e të tjerë shkrimtarë të veriut, që veprat e tyre i shkruanin me alfabet latin, ata herë-herë tentuan që ato ti zëvendësojnë me ndonjë shkronjë të veçantë përshtatur natyrës fonetike të gjuhës shqipe. Shkrimtarët e jugut, të njohur me emrin Bejtexhi, Nazim Frakulla, H.Z.Kamberi. M.K.Çami, Dalip e Shahin Frashri e të tjerë, shkruanin shqipen me alfabet arab, nga të cilët nuk vërehet ndonjë tentim në drejtim të zgjidhjes së një alfabet të shqipes. Ndërsa arbreshët matanë Adriatikut, patën angazhime në zgjidhjen e alfabetit të gjuhës arbëreshe.

Veçohet De Rada me dy Kongreset e mbajtura për gjuhën shqipe. Kamarda bëri tendencë për një alfabet të ri, por nuk pati jehonë /Alfabeto generalo Albano Epirotika/. Rrugës së shkronjave shqipe, pos individëve prinë edhe shoqëritë patriotike të shqiptarëve jashtë dhe brenda atdheut. Alfabeti gjatë ishte pikësynim i të gjithë shqiptarëve, sepse shkrimi i shqipes me shkronja të njësuara, peshonte edhe njësimin e vet shqiptarëve. De Rada me të drejtë shkruante, "Alfabeti nuk duhet të shkaktojë, që ne të zihemi si gratë" Kjo zgjidhje do të bënte

një zgjim të tërësishëm dhe do të ndihmojë për shkëputje nga okupuesit dhe aspirantët grabitqarë. Përpjekjet e Rilindëseve ndikuan që ata të veprojnë të përbashkuar në çështjen kombëtare, ata krijuan alfabete të shqipes dhe ato i përhapnin ndër shqiptarët. Kështu, Naum Veqilharxhi hartoi alfabetin origjinal në vedi, të cilin u mundua ta përhap në Shqipëri. Kristoforidhi përdori alfabetin e veçantë me vetëm dy shkronja të huazuara nga greqishtja, Jubani përdori alfabetin latin edhe pse ai numërohej ndër autorët e parë të shekullit të kaluar me veprën "Raccolta di conti popolari rapsodia albanesi". Edhe Pashko Vasa në vitin 1878 kishte një alfabet të veçantë, i cili pati afirmim bukur të gjerë dhe pati ndikim edhe në alfabetin e sotëm, për dallim ka vetëm 10 shkronja. De Rada me punën e tij prej vigani, gjashtë dekada u muarr me letërsinë dhe gjuhën shqipe, por edhe çështjes së shkronjave të shqipes nuk iu nda. Më 1836 botoi veprën "Këngët e Milosaut" me alfabet latin, të kombinuar me disa shkronja greke e disa të tjera konvencionale. Kurse më 1894 dha një alfabet të veçantë të kombinuar me shkronja latine e greke. Më parë kishte botuar edhe një gramatikë në Firence më 1870, "Grammatica della lingua Albanese". Kamarda hartoi tri alfabete të një pas njëshme. Më 1870 botoi alfabetin e tij më të përsosur i cili ofrohet shumë me këtë të sotshmin, edhe pse siç thamë më parë, ai nuk kishte ndonjë shtrirje të madhe, ai i jep shkas Kamardës të numërohet ndër filologët tanë të mëdhenj. Kuptohet edhe me veprat tjera nga fusha e gjuhësisë.

Përpjekjet shqiptare për alfabetin e shqipes, gjatë gjithë shekullit 19-të, ishin të pandërprera. Nuk ka dyshim, patriotët e Rilindjes Kombëtare këtë çështje e kishin me prioritet që kërkonte zgjidhje të shpejt. Nuk mungonin shkrimet e angazhimet personale të autoriteteve kompetente, të shkrimtarëve dhe dijetarëve, as angazhimet e tyre në grupe dhe shoqëri të organizuara shqiptare jashtë e brenda atdheut. Një tentim për këtë çështje të madhe e njohim edhe nga i madhi Ismail Qemaili me bashkëveprimtarë, V. Pashën, Kristoforidhin e Hoxhë Tahsinin, Poashtu një tjetër iniciativë e njohur më 1869 dhe prapë më 1872, që nuk u kororizuan me ndonjë sukses. Megjithëkëtë, këto njihen për fille të mbara në këtë drejtim. Filologu ynë i famshëm Kristoforidhi edhe një herë tentoi më 1877 të bëjë një zgjidhje, por edhe kjo nuk doli fatlume. Megjithatë, këto tentime nuk janë të pafrytshme, meqë, mu këto ishin nisje e mbarë për një shtruarje të përbashkët të kësaj çështjeje kombëtare. Vetëm një vit pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit më 1879, u formua Shoqëria e Stambollit, çështjen e alfabetit e shtroi në përmasa të gjëra. Këtu mbahet mbledhja e 28 personaliteteve autoritative, mes tyre edhe tre Vëllezërit Frashri, Abdyli, Naimi e Samiu, së bashku edhe me P.Vasën, Said Toptanin, H. Tahsinin, Ali Vrionin, Koto Hoxhin, Ibrahim Dimën, Nikollë Bonotin, Anastas Frashërin e shumë atdhetarë të tjerë. Këto autoritete formojnë në Stamboll shoqërinë "Drita" dhe pas tre numrave të revistës me emërin "Drita", revista merr emrin "Dituria", e cila nga katër variantet e mundshme të alfabetit të kësaj shoqërie, ai i Sami Frashërti u bë bazë për hartimin e teksteve dhe veprave të botuara më vonë nga kjo shoqëri. Në shoqërinë e Stambollit u botua Abetarja e parë shqipe në 20.000 kopje, që doli me emrin "Alfabetore e Gjuhës Shqipe". Alfabeti i kësaj shoqërie u njoh me emrin Alfabeti i Stambollit, ose edhe Alfabeti i Frashërve, i cili një kohë pati jehonë të madhe edhe në shumë koloni shqiptare, si në Bullgari, Rumani dhe në disa hapësira të trollit amë në Shqipëri. Çështja e një ABECEDE të gjuhës shqipe, ishte jo vetëm aktuale, por edhe e domosdoshme në këtë vlug të ngjarjeve historike të popullit tonë. Në të njëjtën kohë shqiptarët ishin përballur edhe me kërkesa të vështira politike teknike dhe praktike, për shkak të gjeturisë së shtypjes, mundësisë tipografike që dispononte autonomia turke. Se kishte disa propozime në këtë tubim. Alfabeti i Stambollit dominoi shumë kohë, megjithatë, nuk pati shtrirje në gjithë kombin. Ai u përhap shumë në shqipen e jugut, ndërsa në veri dominonte Alfabeti i Shoqërisë "Bashkimi" të Shkodrës. Alfabeti i Stambollit u pranua për shumë arsye, në dorë të parë ishin arsyet politike, fonetike dhe gjeolinguistike, me të cilat ky alfabet ju dha grusht të fortë armiqve të gjuhës sonë në aspektin politik, ndërsa në parimin fonetik kishte "çdo shkronjë të ketë vetëm një zë dhe për një zë një shkronjë në vete". Parim që nuk do të zbatohet as në Kongresin e Manastirit, edhe pse ky alfabet do të shërbejë për bazë dhe kishte idhëtar edhe Mjedjen. Për çështjen e alfabetit, përpjekjet shqiptare nuk marrin fund, Shoqëria e Stambollit përdori për bazë shkronjat dhe fonemat e alfabetit latin me çka iu kundërvu tendencave armiqësore të më parshme turkomane e grekomanë. Përkundër shtrirjes së tij në trollin shqiptarë, jashtë tij gazetat përdornin alfabetet e tyre të veçanta. Kjo ishte frymë e pa konsoliduar në shkallë të gjerë kombëtare dhe tendencë e pashuar nga armiqtë, që gjuha shqipe të mos ngrite nivelin e saj me shkronja të veçanta. Andaj, nga shqiptarët me kënaqësi vështrohej përcjellja e shkrimeve të saj, po aq sa vështrohej me kërcënim nga të huajt. Kështu vepruan "Albania"e Konicës, që ishte tribunë e shtypit të kohës, "Kombi" në Amerikë dhe të tjera, përveç Bukureshtit dhe Sofjes.

Shekulli 20-të shqipen e gjeti pa një alfabet të përbashkët për gjithë shqiptarët. Sipas dokumenteve të njohura, shqipja e fillimit të shekullit 20-të, përdorte shtatë apo tetë alfabet të ndryshme, vitet e mëhershme në shkrimet e pakta të shqipes përdoreshin edhe 52 alfabete, nga kjo me të drejtë ankohej lexuesi i kohës, çka do të bënte i mjeri shqiptarë për ta kënduar gjuhën e tij? Cilat ti merr, e cilat ti lë? Gjendja e tillë për shqiptarët e atëhershëm, me shkallë të ultë të arsimimit, ishte shumë e komplikuar dhe kërkonte një zgjidhje sa më të shpejtë e fatlume. Përball forcave përparimtare kombëtare, armiqtë e gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve, përpiqeshin që me çdo kusht, ta mbanin popullin tonë në një gjendje pakrye. Disa nga ata dilnin gjëja se përkrahnin myslimanët, e të tjerët dilni, se përkrahnin të krishterët. Kështu me këto "përkrahje" të njërës palë të pengonin palën tjetër, thjeshtë ata pengonin gjitha proceset shqiptare në këtë drejtim. Fundi i shekullit 19-të dhe fillimi i shekullit 20-të, përveç rritës së madhe të Lëvizjes Kombëtare për lirimin e shqiptarëve nga zgjedha pesë shekullore e Turqisë. Patriotët shqiptarë vazhduan luftën, lëvizja rritej, lufta politike pa aleatë thuaja vendnumëronte, ndërsa lëvizja kulturore zgjerohej. Rritej numri i krijuesve dhe veprave artistike në gjuhën shqipe si edhe numri i revistave, gazetave, shoqërive kulturore jashtë dhe brenda tokave tona, Rrjeti dhe niveli i shkollës shqipe u zgjerua, krahasuar me atë të fillimit në Korçë (7 mars 1887), Realisht u poqën kushtet që edhe çështja e alfabetit që ishte afër zgjidhjes të përkryhet. Me iniciativën e Klubit "Bashkimi" të Manastirit, u ftua Kongresi i Manastirit, i cili do të mbahej në Manastir prej 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908. Për këtë ngjarje monumentale të gjuhës, kulturës dhe historisë shqiptare, që merret ndër ngjarjet dhe datë më e madhe historike e shpirtërore kombëtare, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që i priu shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar, më 28 ëntor 1912 në Vlorë.Iinfluencë të madhe kishte kleri katolik i veriut At Gjergj Fishta, që atë kohë drejtonte shoqërinë "Bashkimi" në Shkodër. Temë e vetme e këtij Kongresi ishte zgjidhja e alfabetit të shqipes. Në Kongres morën pjesë 150 të deleguar nga të gjitha viset dhe kolonitë shqiptare, në mesin e tyre kishte edhe konzujë të huaj, në Kongres ishin të përfaqësuara edhe besimet fetare. Delegatët, sipas dëshmive të kohës, vinin të hipur në kuaj, ishin të veshur solemnisht dhe solemnisht priteshin nga shqiptarët anas të Manastirit me rrethinë. Përfaqësuesve në Kongres të Manastirit, vendorët para ndërtesës ku mbahej kongresi ju shtruan rrugën me qilima e sixhade, që nga ura gjer te ndërtesa tri katshe me kupolë, ku tuboheshin të deleguarit, të cilëve nga vendorët iu sigurua edhe roje për mirëvajtjen e sigurisë gjatë punës së Kongresit. Delegatët ishin nga Manastiri, Shkodra, Durrësi, Elbasani, Vlora, Gjirokastra, Shkupi, Kolonja, Janina, Selaniku, Bukureshti, Konstanca, SHBA-të, Sofja, Egjipti dhe Italia. Kongresi zgjati disa ditë. Për datën e fillimit ka mendime kontestuese, disa thonë Kongresi filloi më 12 nëntor, disa mendojnë më 1 nëntor, madje një konzul serbë thotë se Kongresi u mbajt diku në dhjetor. Por, data e 14 nëntorit, sipas gjithë dokumentacionit dëshmon realitetin dhe saktësinë e vërtetë të mbajtjes së Kongresit të Manastirit. Kongresi që në fillim zgjodhi kryetarin e Kongresit Mit-hat Frashërin të birin e Abdyl Frashërit,, Sekretare u zgjodh Parashqevi Qiriazi ndërsa nënkryetar i Kongresit u zgjodh Grigori Cilka dhe 11 anëtarë të tjerë. Kongresi zgjodhi edhe një Komision të zgjeruar nga shoqëritë "Bashkimi dhe "Agimi", Shoqëria e Stambollit dhe personalitete tjera nga shoqëritë dhe kolonitë shqiptare, që pas diskutimeve, propozimeve dhe mendimeve të ndryshme, më 22 nëntor 1908 Komisioni solli një konkluzë. Në të cilën para Kongresit u sollën dy alfabete alternative të mundshme për përdorim të barabartë, të cilat vet koha, në zbatueshmërinë praktike të tyre, do të dëshmojë cili nga ata të merret për alfabet të shqipes dhe për gjithë shqiptarët. Për variant u moron Alfabeti i Stambollit dhe një alfabeti me bazë alfabetin latin. Komisioni dhe Kongresi vendosen, që në të gjitha shkollat dhe në të gjitha revistat dhe shkrimet e shqipes, të përdorën këto dy alfabete alternative. Komisioni përbëhej nga këta anëtarë: Atë Gjergj Fishta, Kryetar. Luigj Gurakuqi, Sotir Peci, Mit-hat Frashri, Shahin Kolonja, Dhimitrak Budi, Ndre Mjedja, Fehmi Topuli, Nuset Vrioni dhe Grigor Cilka, anëtarë. Të gjithë u zgjodhën me votë të

fshehtë. Në këtë komision u zgjodhën personalitete eminente me qëllim të mos bazohen në alfabetet e deri atëhershme të përdoruar në gjuhën shqipe, edhe pse më parë Kongresi kishte vendosur që për alfabet të shqipes të mbështetej në alfabetin latin, i cili për gjitha parimet gjuhësore i përgjigjej shqipes. Komisioni mori për çdo tingull të shqipes veç e veç një shenjë grafike të veçantë, gjegjësisht për çdo tingull një shkronjë. Analiza e thellë e praktikës gjuhësore për disa tinguj kërkoi një punë e gjatë. Pas diskutimeve të rrepta, të nivelit gjuhësor e shkencor, në mes të delegatëve në Kongres, u murr vendim, që disa tinguj të shqipes, duhet të shënohen me dy shenja grafike. Kështu që, më 22 nëntor 1908, Komisioni arriti të propozon qëndrim definitiv para Kongresit. "Pasi që u kënduan verbalist ditëve tjera, e pasi që e pamë, se puna që kishim bërë ishte mjaft e madhe, por jo aq sa të na kënaqë të gjithëve, e ti shërbente si përparim dhe ditirisë ndër ne; Të shtyre edhe nga disa shkaqe të përjashtme e shtyem prapa, e me pëlqim të të gjithëve u vendos që: Të merret ABECE-ja e Stambollit, e me te së bashku, një ABECE thjeshtë latine, që të përdorën bashkërisht në mes të shqiptarëve". Nga kjo vërehet, se Kongresi i Manastirit nuk e zgjodhi përfundimisht çështjen e alfabetit të shqipes. Por, Kongresi e thjeshtoi shumë rrugën e pakrye që deri atëherë e mundonte shkrimin e shqipes. Padyshim ky trasim lehtësoi shumë zgjedhjen definitive, që do të arrihet brenda një kohe relativisht të shkurtër më 1910. Korpusi fonetike e fonologjik i shqipes, ligjet dhe zhvillimet e brendshme të gjuhës sonë, përmbushen me 36 shkronjat e kërkuara kahmot, që janë përkatëse me 36 tingujt fonetik të shqipes, shkronjat me bazë latine të cilat i kemi sot të afërta me shkronjat e shumë gjuhëve të zhvilluara të botës. Prej këtu e tutje shqiptarët me punën e tyre i dhanë hov luftës dhe punës krijuese mendore edhe kundër pushtuesve dhe lakmisë së tyre për të imponuar shqiptarëve gjuhën e tyre. Hovi i zhvillimit të gjithmbarshëm të vetëdijes shqiptare për gjuhën dhe zhvillimin e vlerave pozitive shpirtërore kombëtare, dobësoi furinë e synimeve imponuese dhe nëpërkëmbjen e këtyre vlerave kombëtare nga të huajt. Për Kongresin e Manastirit gjithë pjesëmarrësit e në veçanti Fishta, Mjedja, Mit-hat Frashri, Gurakuqi, Grameno, Hilë Mosi, Bajo e Qerqiz Topuli e shumë të tjerë, kanë luajtur rol me rëndësi, alfabetet e të cilëve kanë pasur ndryshime gjatë kohës, gjerë në Kongresin e Manastirit. Vitet e para pas Kongresit të Manastirit filluan protestat shqiptare për mbrojtjen e alfabetit kombëtar të Manastirit, në Berat masa dogji abetaren me shkronja arabe-turke, ndërsa në Korçë protestuesit kënduan këngën e alfabetit shkruar nga mësuesja Parashqevi Qiriazi. Protesta u organizuan për mbrojtjen e alfabetit kombëtar të Manastirit nga gjonturqi dhe fryma greke. Në mbrojtje të alfabetit shqiptarët u organizuan edhe në Përmet e Elbasan. Përkundër kërcënimeve antishqiptare turke e greke, Kongresi i Elbasanit vendosi, që nga mesi i shtatorit të hap Shkollën Normale në Elbasan, e cila për shkak të rrethanave filloi punën më 1 dhjetor 1909.

Tash kur po përmbyllet një përvjetor i moshës së moçme për shkronjat tona dhe nivelin e rritës së vlerave të gjuhës shqipe. Përkujtojmë vështërsitë dhe punën e mundimshme të atdhetarëve shqiptarë, përpjekjet shumëvjeçare të tyre, që ne sot të ligjërojmë e të shkruajmë alfabetin e trashëguar nga stërgjyshërit tanë të lavdishëm. Ky alfabet ka ngritur lartë kalanë gjithëdijes shkencore dhe vlerave shpirtërore të artit e kulturës sonë kombëtare. Sot jemi të barazuar me civilizimin e popujve që dikur ua kishin lakminë, dhe ka bërë të na lakmojnë edhe ata, që dikur nuk na kanë shikuar me simpati, as neve për popull të moçëm, e as gjuhën tonë për gjuhën më të vjetër e të përve çme.

==========



NË NDERIM TË NJËRIT PREJ THEMELUESVE TË SHTETIT BASHKËKOHOR SHQIPTAR – IMZOT NIKOLLË KAÇORRIT

Nga Dr. MUSA AHMETI,
Center for Albanian Studies
Budapes

Studimet monografike për figura të shquara kombëtare dhe fetare të mbështetura në kërkimetë thelluara profesionale, hulumtime arkivore dhe shfrytëzim të një literature të bollshme të fushave të ndryshme, e plotësuar edhe me burime dytësore si memoaret apo rrëfime-intervista të personave të gjallë, kur shkruhen nga penda të mençura dhe profesionale, domosdoshmërisht përbëjnë një ngjarje kryesore dhe janë literaturë e pashmangshme për rishikimin dhe rishkrimin e historisë sonë kombëtare. Qëmtimi me kujdes, ballafaqimi kritik me burime relevante, vlerësimi racional dhe paraqitja logjike me një gjuhë të rrjedhshme e të pastër, e bëjnë monografinë për imzot Nikollë Kaçorrin një vepër themeltare për burrështetasit shqiptarë që sot zënë vend në lterin e nderuar të themeleve të shtetit bashkëkohor shqiptar. Konceptualisht e përgatitur sipas metodës kronologjike, duke filluar përgjatë fundshekullit XIX dhe pjesës së parë të shekullit XX, me një përqendrim thelbësor te personaliteti i imzot Kaçorrit, duke u kthyer në retrospektivë për një historik të shkurtër të Lurës dhe të tërë krahinës, e cila përgjatë shekujve nxori figura të shquara, të respektuara dhe kombëtarisht të nderuara, autorët Nikollë Loka e Angjelin Shtjefni sjellin informacione dhe të dhëna të reja për fisin e Kaçorrëve të Lurës, për jetën, zakonet, traditën, besën, të cilat ndërlidhen me mjeshtëri me elemente të tjera të së drejtës zakonore, etnologjisë dhe etnografisë popullore shqiptare si dhe me segmente të veçanta të përditshmërisë lurase.

Hulumtimi për jetën dhe veprën e imzot Nikollë Kaçorrit për autorët Nikollë Loka e Angjelin Shtjefni, siç vërehet nga vetë studimi i tyre, nuk ka qenë i lehtë dhe pa sfida e të papritura. Megjithatë, insistimi tyre në përballimin e të gjitha pengesave bëri që ne të kemi në dorë një monografi të vyer dhe shumë të çmuar, të sistemuar me pedantëri, të mbushur me të dhëna të reja, të sakta dhe preçize, të cilat mbështeten në shumë burime dhe në këtë mënyrë njëherë e përgjithmonë zhdukin mjegullën dhe hamendësimet, datat e gabuara dhe pasaktësitë e shumta të cilat përcjellin jetën dhe veprën e imzot Kaçorrit deri me sot.

Shtjellimi i shtresëzuar i një rrëfimi shkencor sipas modaliteteve bashkëkohore, kritike të monografive të specializuara, studiuesin e lexuesin i bën që me padurim të lexojnë faqe pas faqe një jetë të panjohur, por shumë të bujshme që nga fëmijëria e varfër, gjë pothuajse e zakonshme për pjesën dërrmuese të shqiptarëve, pastaj shkollimin, studimet e më vonë jetën kishtare që nga shugurimi dhe përkushtimi për jetën fetare (ku kthimi i tij në atdhe e vendlindje "festohet sikur të ishte një dasmë"), ngritjen dhe bllokimin në hierarkinë kishtare dhe pastaj ballafaqimin me patriotin dhe nacionalistin e përkushtuar për atdhe deri në vdekje. Në fund, si mbyllje një shtesë e përzgjedhur me dokumente, informacione dhe materiale të ndryshme që janë një pasqyrë e një dallgëzimi dhe emocioni përfundimtar, si vetë jeta e imzot Nikollë Kaçorrit, për t'u prehur në qetësinë e amshimit të përjetshëm në atdheun e dashur – Shqipërinë e tij.

Studimi i historisë bashkëkohore, veçanërisht i periudhës që i takon edhe imzot Nikollë Kaçorrit kërkon shumë kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm të lartë, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër ballafaqim të shpeshtë të burimeve të reja me "tabutë e krijuara për shumë vite" nga emra ta njohur të historisë së popullit shqiptar me idetë tanimë të vjetëruara dhe të tejkaluara të qasjes së metodologjisë së vjetër shkencore të personaliteteve dhe ngjarjeve të veçanta. Strukturalisht e ndërtuar sipas binomit të paralelizmit qëndror "Fe e Atdhe" pa një dallim ose favorizim thelbësor religjioz apo patriotik, vepra besnikërisht realizon qëllimin e autorëve për ta paraqitur këtë binom që shquhet sidomos te shqiptarët. Laiciteti i të riut Nikollë, ndërthuret me mjeshtëri pa u vënë re me petkun e priftit don Nikollë, duke mos përjashtuar atë më kryesoren dashurinë për atdheun, vendlindjen, popullin dhe në asnjë situatë, besimtarët. I formuar në rrethet intelektuale arsimore të kohës, me një shkathtësi të veçantë të përdorimit të gjuhëve të huaja që njihte, prifti i ri as edhe një herë nuk i shkëput lidhjet dhe interesimin për atdheun që ndodhej nën një shtypje të rëndë nga një pushtues mizor, në momente shumë të rëndësishme të kthesave të mëdha historike të mbijetesës dhe të shtetëformimit modern. Nuk ishte fare e lehtë të veprohej në kushtet e survejimit, ndjekjes e burgosjes, të torturave mizore dhe sfidave nga më pabesueshmet, megjithatë, burrëria dhe shpirti liridashësh ngadhnjyen mbi të keqen, duke e bërë tani

Bust i Dom Nikoll Kaçorrit
në Durrës
nga Qazim Kertusha.

priftin e pjekur dhe të ngritur në hierarki kishtare, të nderuar në popull e në bajraqe, të respektuar në kuvende e takime, imzot Kaçorrin, dëshmitar të njërës prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së kohës moderne, shpalljes së pavarësisë së shtetit modern shqiptar.Me origjinë nga një krahinë e varfër, me specifika shumë interesante, me një besë e burrëri të panjollosur, me një zgjuarsi natyrore, imzot Kaçorri edhe kur ishte zv/kryeministër (në fakt, në shumë raste e për shumë kohë ushtroi detyrën e kryeministrit kur Ismail Qemali mungonte, kur ndodhej jasht shtetit) por edhe më vonë, në përballjen me Esat Pashën dhe hordhitë haxhiqamiliste ai tregoi mençuri e pjekuri duke marrë vendime të drejta të cilat edhe sot e kësaj dite janë të padiskutueshme. Studimi monografik që kemi në dorë qëndron për shumë arsye më lart se vepra të ngjashme të botuara deri me sot. Për këtë, merita kryesore është vetë personaliteti të cilit i kushtohet vepra, por edhe koha në të cilën jetoi dhe rrethanat të cilat e ndoqën atë. Nuk është rasti i parë që një klerik intelektual shqiptar i formuar dhe i brumosur me dije nëpër qendrat universitare të Europës, të vërë në veprim binomin "Fe e Atdhe". Por, rasti i imzot Kaçorrit është shumë intersant dhe me specifika tepër të veçanta. Autorët, Nikollë Loka e Angjelin Shtjefni kanë prekur dhe trajtuar në rrafshin horizontal shumë momente të rëndësishme, njëri prej të cilëve është edhe fenomeni i "laramanizmit ose kriptokatoliçizmit." Për shkak të rëndësisë që ka ky fenomen, por edhe për vetë ndërlidhshmërisë funksionale me ngritjen hierakike kishtare të imzot Nikollë Kaçorrit mendojmë se atij i duhet kushtuar një vëmendje e posaçme. Autorët pohojnë në studimin e tyre se: "Lura sot paraqet një rast unikal në Europë. Ajo është e përzier në fe, jo thjeshtë si krahinë me fshatrat e saj, por edhe brenda të njëjtës strehë familjare. Nuk ka shtëpi që të mos jetë lidhur në trungun e vet me familje të fesë tjetër. Kështu, për të krishterët, apo myslimanët personat e fesë tjetër janë vëllai, nipi, kushëriri, miku dhe, duke qenë të tillë, ata janë pjesë e pandarë e tyre ku, përballë lidhjes së fortë të gjakut, ndryshimet në besim kalojnë në rend të dytë" dhe vazhdojnë më tutje me një fakt tjetër shumë domethënës: "babai i Nikollë Kaçorrit, Vokrri (…), ndonëse katolik i devotshëm, ishte martuar me Hane Vladin, një vajzë myslimane nga Lura (…), myslimanët e shtëpisë së Vladit, edhe ata të përzier në fe, ishin shumë të lidhur me nipat e tyre katolikë, pa asnjë lloj paragjykimi (…), ndërsa edhe xhaxhai i Nikollës ishte mysliman." Si fenomen

"Laramanizmi ose Kriptokatoliçizmi" është i njohur dhe daton që në mesjetën e vonë, përkatësisht që nga koha e fillimeve të pushtimeve osmane. Në literaturën historike, fenomeni i "Laramanizmit te shqiptarët" është trajtuar më se një herë, por pa u thelluar në specifikat, kushtet, arsyet dhe rrethanat që ndikuan në përhapjen dhe shtrirjen e këtij fenomeni te shqiptarët në përgjithësi dhe në rastin konkret në Lurë, në veçanti. Është trajtuar në mënyrë sipërfaqësore nga autorë që janë vetë me origjinë "laramane ose kriptokatolike" të cilët nuk kanë mundur t'i mënjanojnë paragjykimet, kështuqë punimet e tyre nuk e kanë trajtuar thellësisht dhe gjithanshmërisht këtë problematikë mjaft të ndjeshme për shoqërinë tonë.
Duke u marrë me personalitetin e imzot Nikollë Kaçorrit, autorët Nikollë Loka e Angjelin

Shtjefni i futen me mjeshtri brendisë së këtij problemi duke vënë në dukje se ky fenomen është shumë i veçantë në Lurë dhe në rrethinat e saj. Në shtjellimin e tyre profesionalo-shkencor, ata i qasen "laramanizmit ose kriptokatoliçizmit" përmes vetë figurës qendrore të imzot Kaçorrit kur pohojnë se "e ëma dhe xhaxhai i Nikollës ishin myslimanë." Në studim ka mbetur disi i pasaktësuar sa duhet shkaku se pse imzot Kaçorri nuk u emërua ipeshkv?
Në të vërtetë, jo vetëm në këtë studim monografik, por edhe në shkrime të tjera është thënë se shkaktar ishte "aktiviteti patriotik ose angazhimet politike". Një pohim i tillë nuk është i qendrueshëm, për faktin se Selia e Shenjtë, kishte në dorë një argument tjetër tepër të rëndësishëm, e që deri me sot nuk është shkelur apo anashkaluar. Ky argument është: imzot Nikollë Kaçorri ishte "Laraman ose kriptokatolik" dhe kishte edhe në familjen e ngushtë e të gjerë myslimanë! Sipas të Drejtës Kanonike, si ipeshkv apo në një funksion tjetër më të lartë kishtar cilidoqoftë ai, nuk mund të emërohet në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast, një përson që ka origjinë ose të kaluar të tillë. E Drejta Kanonike është shumë e rreptë dhe një gjë të tillë e sanksionon në mënyrën më rigoroze të mundshme. E vetmja mundësi për emërimin e tij si ipeshkv mund të ishte, rasti kur imzot Nikollë Kaçorri, ipeshkvi ose kryeipeshkvi që e kishin propozuar atë, i janë drejtuar "Penitencierisë së Shenjtë – Sacra Penitentieria" dhe nëse ky dikaster si njëri ndër më të rëndësishmit dhe me kompentenca direkte për çështje kërkonte Papës leje të veçantë, në rastin tonë, që imzot Kaçorri të mund të emërohej me gjithë këtë 'njollë' në biografinë e tij apo të familjes së tij. Me një bulë të veçantë, Papa jepte miratimin e tij për të proceduar me emërimin, dhe për këtë njoftohej edhe Kolegji i Kardinalëve. Ne nuk kemi informacione nëse imzot Kaçorri apo ipeshkv Bardhi i janë drejtuar "Penitencierisë së Shenjtë" për një gjë të tillë, sepse dokumentet që ruhen në arkivin e "Penitencierisë së Shenjtë" në kushte tepër të rrepta sigurie dhe pas shumë garancish përkatëse. (Për informacion mund të themi se njëra nga studiueset e rralla në botë që ka pasur fatin të bëjë kërkime shkencore në këtë fond, në Arkivin Sekret të Vatikanit, /Archivio Segreto Vaticano/ është shqiptarja, Prof. Dr. Etleva Lala). Pra dëshirojmë të ripërsërisim se shkak për mosemërimin e imzot Kaçorrit si ipeshkv në Shkup, Shkodër apo Durrës është origjina e tij prej "laramani ose kriptokatoliku" dhe asgjë tjetër personale, politike apo fetare, etj. Libri "Burrështetas shqiptar në Altarin e Atdheut-Imzot Nikollë Kaçorri, një vepër e kompletuar, sipas të gjitha kritereve shkencore bashkëkohore, shpresojmë se do të jetë shtysë edhe për studiues të tjerë që do të studiojnë jetën dhe veprën shumë komplekse dhe tepër interesante të imzot Nikollë Kaçorrit, duke studiuar edhe më imtësisht veprimtarinë e tij të palodhshme fetare e patriotike, veçmas këtë të dytën, ku mendojmë se ka ende shumë hapësirë për studime sistematike dhe të organizuara nga ana e institucioneve të specializuara për këtë çështje, qoftë Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë etj. Në fund të fundit, të gjithë ne ia kemi borxh një gjë të tillë kësaj figure poliedrike, atdhetare, që ta vëmë atë në vendin e tij, aty ku i takon në lterin e lirisë, si njëri prej themeluesve të shtetit bashkëkohor shqiptar. Autorët Nikollë Loka e Angjelin Shtjefni na ofrojnë në mënyrën më të ndershme dhe bujare, më profesionale dhe të sinqertë këtë studim të mirëfilltë duke kontribuar në ndriçimin e figurave madhore kombëtare si dhe duke dhënë ndihmesë për rishikimin dhe rishkrimin e historisë së popullit shqiptar.



Dokumenti i Pavarësisë me firmën e Ismail Qemalit në krye të nënshkrimeve të tjera.
Deklarata është shkruar në një letër me vija që duket si e shkëputur nga një fletore, ndoshta nga ajo ku mbahej proces verbali. Në pjesën e pasme ka edhe gjashtë firma të tjera.
(Foto : Kel Marubi, rizbuluar nga Niko Kotherja).
Shënimi nga Ilir Ikonomi në librin e tij « PAVARESIA », udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit.
UET Press 20

Visar Zhiti

MIRËSEVJEN MESHAR LIBRI YNË I PARË…



Pritje e grumbulluar në breza, ëndërr e përbashkët dhe e atyre që s'janë!Përzier me ca mister dhe me gëzim! Një libër!… i pari fare. Aty nisi… Do t'i afrohemi më shumë se kurrë, do të mund ta shohim si dorën tonë, që shkruan… Meshari i shqiptarëve, i gati 5 shekujve më parë, që ka mbetur i vetmuar në një Bibliotekë të huaj, ndër më të mëdhatë në botë e më të rëndësishmet, vjen në tokën e gjuhës së vet për herë të parë. Sikur kthehet nga një mërgim i gjatë si harrimet. Dhe shpërthejnë emocioni dhe malli, përsiatjet dhe kujtimet. Rimëkëmja e një kombi vjen nga e kaluara , nëse e dashuron atë, thotë një i mënçur i madh. Do të vijë nga qielli Meshari, se libër qiellor është. Me avion nga Roma do të zbresë në aeroportin "Nënë Tereza" dhe mes pritësve, sigurisht do të dalin dhe hijet e Budit, Bardhit e Bogdanit, e poetëve themeltarë, Naimi e Fishta, do të dalë hija e romancierit të parë shqiptar, Ndoc Nikaj, e atyre që nisën prozën moderne shqipe, Koliqi e Kuteli, gruaja e parë shkrimtare, Musine Kokalari, do të vijnë nga Kosova Mekuli, Shkreli, Podrimja, do të dalin fëmijët me tufa me lule.
Vendoseni në një shtrat topi si heronjtë Librin e Parë, mbështilleni me Flamurin Kombëtar dhe çojeni drejt qendrës së Kryeqytetit, aty ku pret në bronz Heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.
Dhe të presin në radhë shqiptarët, me mijëra, të ardhur nga të gjitha trevat e të shohin Librin e tyre të Parë, ta prekin. Kemi udhëtuar me shekuj drejt tij…
NË KËRKIM TË MESHARIT:
Mesharin së pari e zbuloi në Vatikan gjakovari Gjon Nikolë Kazazi më 1740. Sepse deri atëhere dihej i humbur. Pastaj sikur u harrua prapë dhe më 1909, një vit pas Kongresit të Manastirit, kur si alfabet i shqipes u konfirmuan sërisht shkronjat latine, ato të Mesharit, e rigjeti Pal Skiroi nga Palermo dhe përsëri më 1930 At Justin Rrota nga Shkodra, që e fotografoi në tre kopje dhe i shpërndau.
Më 1968 "Mesharit" iu bë një (ri)botim shkencor në Tiranë me faksimile dhe trasnskribim, paisur me një studim të gjerë nga profesor Çabej.
Ndërsa origjinali dergjej atje, në Vatikanin e ndaluar. Duke u harruar. Studuesit nuk kishin mundësi të dilnin nga Shqipëria diktatoriale sa herë t'u duhej, por kur nisnin ndonjë, misioni ishte ndryshe…

* * *

Autori Gjon Buzuku, prifti katolik nga Veriu i Shqipërisë, mbase nga fshatrat e bregut perëndimor të liqenit të Shkodrës, famullitar i një kishe jo larg vendit të botimit të librit, ndoshta në trevat e Ulqinit a të Tivarit a gjetiu në Bregun Dalmat, por dhe në Venedik, sipas një mendimi më të përgjitshëm, pra, ai, Buzuku, është kështu dhe autori i parë i letërsisë shqiptare. I botuar më 1555, i papërcaktuar se ku, se i mungojnë 16 faqet e para bashkë me ballinën.
"Meshari" i tij nuk është thjeshtë një libër kishtar, që përmban lëndë të ndryshme biblike të përkthyer, liturgji, të shoqëruar me copëza proze tregimtare. Rëndësia e tij është e jashtzakonshme, jo vetëm për historinë e gjuhës tonë, por për gjithë kulturën e kombit, identitetin e tij. Vepra është parë dhe si sintezë e botës së një populli, shpirt dhe mendësi, kahu i ecjes dhe çelsi i shumë enigmave. Aty gjejmë, ndër të tjera, se si kanë folur shqiptarët në Mesjetën e tyre, pa evoluimin e dukshëm të dy dialekteve tona, si ka folur Skënderbeu dhe na bën të besohet që të ketë patur dhe vepra të tjera paraprirëse. Të zhdukura (!?!). Buzuku ndjek kështu një traditë të konsoliduar të shkrimit të shqipes, që do të vijojë dhe me autorë të tjerë.
Gjuha shqipe ndjehet e kultivuar, kurse në pasthënie shprehet qartazi dashuria për atdhe si frymëzuese e kësaj bëme për të ndritur mendjet e bashkatdhetarëve.
"Meshari" është shkruar me alfabetin latin me shkronja të tipit gjysmëgotik, i zakonshëm në atë kohë në Italinë e Veriut. Dhe për tingujt e shqipes që nuk i ka latinishtja, janë përdorur dhe pesë shkronja të posaçme, të ngjashme me ato të alfabetit cirilik. Gjithsesi libri ndihmon dhe linguistët indo-europianistë në rrafsh të gjerë.

DY TREGIME ME MESHARIN: (diplomaci)

1. Edhe unë e kam kërkuar Mesharin tonë, kam ëndërruar të jem përballë tij. Shqipëria qe hapur, pa diktaturë, duhej të shkonim drejt Mesharit. Dhe nga i burgosur politik, isha caktuar të punoja në ambasadë… Kisha hyrë në portat e shtetit të Vatikanit, të rrethuar me mure të larta dhe me roja zviceriane me shtiza të gjata ndër duar. Më ishte dukur sikur isha futur jo vetëm në një kështjellë paqësore, por dhe në një tjetër kohë, shumë të ngjashme me përjetësinë. Qetësi dhe rrugët bosh, me vetura të ndaluara dhe ajër si i manastirtë. Dëgjoja hapat e mi nëpër gurë. U ktheva andej nga Biblioteka e famshme. Plotësova ç'duhej me rigorozitet dhe kërkova Librin e Parë Shqip. Doja ta shihja, ta merrja ndër duar, ta ledhatoja… Vetë Prefekti i atëhershëm i Bibliotekës, një kanadez hollak me uniformë të stilizuar prifti, e zezë e gjitha, me pakëz jakë të bardhë, se nga shkoi nëpër ca labirinthe, në Mesjetë me siguri dhe u kthye me një sasi fletash ndër duar, pergamena apo fotokopje të tyre?
- Ky është libri që kërkon? – më pyeti në italishten e tij të bukur, me pakëz akcent.- Shikoje… E mora librin me duart që më dridheshin.
- Jo, jo! – thashë me pikëllim të thellë, megjithëse nuk e kisha parë kurrë.
- Do ta gjejmë, – shtoi gjithë siguri. – Këtu asgjë nuk humbet. Do të jetë në rikonstruktim. Ndjeva dhëmbje, dyshim dhe frikë. Të jetë zhdukur vërtet? I vetmi ble që kishte mbetur në të gjithë botën dhe për çudi nuk ndodhej në atdheun e vet. Rreziku i grabitjes, i zhdukjes së tij, me qëllim, pa qëllim, ishte, është… unë s'besoj se bleu tjetër i "Mesharit" tonë humbi rastësisht në Raguzë, para do kohe. Ç'duhet bërë?…
Dhe kundërlajmi mbërriti. Gjithë ngazëllim u ula mbi makinën e shkrimit, poshtë në zyrën time të ëndheshme, kantinë a bodrum, ç'kishte qenë dikur, në vilën e Ambasadën dhe shkruajta fjalinë e parë, rraha tastat me po ato shkronja si të "Mesharit".
U gjet… – dhe thashë me vete: Shekulli nuk mund të mbyllej pa 'Mesharin' tonë… të rikonstruktuar. Po çoja informacionin në Tiranë,

ku qe përhapur lajmi në media se në Vatikan nuk gjendej më Meshari ynë. Po mua më lajmëroi vetë Prefekti i Bibliotekës se këtu asgjë nuk humbiste, kush i përhapte këto lajme të pavërteta? Libri është gati për përdorim, – përfundoi ai me zë siperan . Po gati për në atdhe kur do të jetë? 2. Dhe në një ditë romane plot me diell, në fundin e dhjetëvjeçarit të parë të shekullit XXI, u nisëm nga ngrehina shkretane e ambasadës tonë. Megjithatë më dukej ditë solemne. Takim drithërues, i ëndërruar gjithë jetën. Vetura e sorrtë e ambasadorit na futi në shtetin e vogël, por të madh, në atë shpirtëror, të Vatikanit. Ja portat e Bibliotekës. Kolegu ynë, Zef Bushati, kishte folur me miqtë e tij për një takim me… Mesharin. Po dridhesha. Sikur ndizeshin vetvetiu qirinj. Mezi po prisja në sallë. S'po kuptoja ç'po flisnim. Dhe ja, një nga punonjësit e Bibliotekës së famshme erdhi, e solli. I ngazëllyer dhe ai prej ngazëllimit të syve tanë. M.E.SH.A.R.I. Ja, i vërteti, i gjallë. E prekëm me rradhë. Sipas hierarkisë. Me kujdes, jo ashtu, gati thirri punonjësi i Bibliotekës. Unë i fundit. Doja të qaja. Kur m'u duke se nuk po më shikonte kush, e putha. Fletët ishin të mbrojtura. Duhet ta sjellim në Shqipëri, gjëmoi një zë brenda meje. Patjetër, patjetër. Unë kam parë "Mesharin", doja t'i tregoja kujtdo që takoja, kam prekur Librin tonë të Parë dhe ditët e mia sikur u ndanë para dhe pas Mesharit. Sa i madh do të ishte gëzimi i përbashkët, kur shqiptarët të gjitha ta shihnin librin e tyre të parë në vendin e tyre! Natyrisht që duhet festuar… REALIZIMI I ËNDRRËS: Por dhe mund të kërkohej të vinte këtu për pak kohë ky libër i mërguar, të ekspozohej, të vizitohej nga të gjithë, të prekej me sy, me duar, të shikonte ai libër shqiptarët e vet. Po, na thoshin, mund të bëni një kërkesë zyrtare. Por… ngrinin supet. S'ka ndodhur ndonjëherë. Si me Mona-Lizën, edhe ajo ka dalë nga Luvri. Buzëqeshnin.

Shteti mund të bëjë, ja, ne jemi shteti, ka ambasadorë, avionë, reciprocitet, agjentë, të ketë dhe pakëz fantazi dhe dashuri më shumë… për të kaluarën. Ne i dhamë kohë më parë Vatikanit Kodikët tanë për një ekspozitë atje, u befasua Roma e madhe, çuam dhe të famshmin, të Purpurtin, që me të drejtë u vu mbi një shtrat topi, kur e nisëm. Dhe Vatikani mund të na i kthejë nderin duke na dërguar "Mesharin" mysafir në dheun amë, kështu bisedonim me njëri-tjetrin në tryza diplomatike. Dhe harrohej "Meshari" si të ishte libri i trashë i menysë së restoraneve.

Ndërroheshin ambasadorët, ministrat e Kulturës, por jo dëshira e thukët për të patur Mesharin mes nesh. Dhe një ditë, kur isha kthyer, ia thashë zotit Aldo Bumçi, e dëgjoi, heshti, u entuziazmua kujdeshëm, u prek… Po, po, u përgjigj, do ta sjellë Qeveria jonë në këtë 100 vjetor të themelimit të shtetit modern shqiptar. Dhe nisi çështja "Meshari". U hartuan shkresa, marrëveshje, me po ato shkronja me të cilat është shkruar dhe "Meshari", i firomosi Ministri, pastaj Biblioteka jonë Kombëtare me Biblioteka e Vatikanit… erdhën përgjigjet nga jashtë me po ato shkronja me të cilat është shkruar dhe "Meshari". U bënë verifikimet e sigurisë, u kontrolluan kushtet. Meshari do të vijë do të ekspozohet në Tiranë. Mbas 457 vjetësh. 5 shekuj… Nderimet më të mëdha meriton dhe Meshari ynë, rindiznim bisedën. Një tempull, një piedestal. Pranë armëve të Gjergj Kastriotit – Skënderbeut. Dhe ato do të vijnë… Të derdhim në bronz fjalët e shqipes së vjetër, me shkronjat latine, ato zgjodhëm, edhe pse ishim të rrethuar nga alfabete cirilikë. Ishte prirja jonë natyrale me Perëndimin Europian, ën së dashunit së botës s'anë. …u Doni Gjoni, i biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gjã të ëndigluom ën së shkruomit shenjtë… desha me u…për sã mujta me ditunë, me zhdritunë pak mendetë e… Të ndriçojmë mendjet e njerëzve, ja si thotë, përsëritnim fjali të shenjta të Mesharit, pra ky ka qenë edhe njëri nga qëllimet për të cilin e bë Meshari ynë. Dhe është dhe një lutje që nuk e ka asnjë meshar në botës, e shtoi Buzuku ynë: Gjithë popullsinë… ndër Arbanit ata n'mortajet largo, ty të lusmë. O Zot. Te Arbëria, pra aty i rreh zemra Buzukut. ËNDRRA PËRSËRI SI EPILOG: Meshari mbi një shtrat topi, Libri i Parë i Shqiptarëve, i një nga gjuhët më lashta të botës, asaj që shpjegon emrat e perëndive, siç thoshin rilindasit tanë. Tallazitet Flamuri Kombëtar që e mbështjell Veprën. Nga të dy anët e bulevardit njerëzit duartrokasin. Makina që tërheq topin me Librin përsipër, sipas protokollit, i afrohet qendrës së kryeqytetit. Ndal aty tek shtatorja e Gjergj Kastriotit- Skënderbeut, Heroit Kombëtar me dimensione europiane. Libri gati është moshatar me armët e Skënderbeut, po është më i ri Libri se armët në përgjithësi dhe bota duhet të kthehet tek arma e librit për t'u harruar gjithë armët e tjera, përsërisja me vete. Dhe njerëzit në rradhë për të parë Librin e tyre të Parë. Qëndrojnë para tij, përkulen me nderim Nga fletët e tij gumëzhijnë zëra, pyje, lumenj, vringëllima shpatash, orteqe eposesh, digjen qirinj, dridhen gishtrinj, mijëra – të një populli, shkëlqejnë sy, si yjet, që edhe kur shuhen, drita e tyre vjen e pavdekur, diellore, gjithë dashuri e amëshueme, del frymë nga ato fletë, por edhe gjak, del vetë ëndrra, fjalë, fjalë, fjalë të librave pafund të një populli, shkresa, memorandume, ultimatume, përgjigje, kujtesa kolektive, e folura jonë që përmbledh jetë, atë që shkoi e atë që do të vijë, vetë përjetësinë. U kthye Meshari, Mesh- ari, meshë e artë është kjo ditë. Dhe më shumë se aq…

Xhenc Bezhi

"ENGJULLI I KALVARIT"

(Daniel Gazullit)

Engjulli i kalvarit,
pinjoll
i familjes "anmike",
zbret nga Kryqi
e u heqë lakun nga fyti
xhelatëve të vet.

Engjulli i kalvarit
ngjyrat e ylberit kërkon
e me penelin e Kryqit
një andërr për nesër,
të bardhë, të bardhë,
pikturon.

Engjulli i kalvarit
shekujve një e nga një
shkronjat e mbiemnit të tij,
u dhuroi,
dhe fli si të parët
ai bahet sërish
për Shqiptari.

Fritz Radovani

NË "KOPSHTIN E GJETSEMANIT" U THYE NJË DEGË ULLINI…

Kjoftë edhe një degë e vogel **ullini... gjithmonë na ka sjellë Paqen…**

Jo pak, shtëpia në Shkoder, na **kujtonin "Kopshtin e Gjetsemanit"…**

Ka vite, shumë vite perpara, që një **ditë pata hy në "Kopshtin e Gjetsemanit" të** qytetit të Shkodres, në shtëpinë e Gazullorëve, tek Arra e Madhe, ku atëherë jetonte një mik i vertetë i imi, mësuesi i nderuem Simon Gazulli. Kujtojshe ma vonë se nga ai kopësht kam pa disa here me **Simonin edhe nipin e Tij Danielin…Edhe** Ky i brezit të kulturuem i fisit të vjeter dhe shumë të njohun që në kohen e Gjergj Kastriotit, Gazullorëve të Sapës.

Pak vite perpara mora një mesazh, **mbrenda të cilit ishte një poezi: "Rrëmaji".**

Danieli shenon: Kushtue.

.”Një Monument nën dhe” nga Fritz Radovani...

Një gumzhimë e mnerëshme
prej Rrëmajit del
e merr për ajrì Alpeve.
Mandej përplaset fort
e kthen
ku njerëzit kalamendë,
ligshtue prej lëngatës së gjatë,
i trandë ajo piskamë,
që po i thërret
me u zgjue
e me u mbledhë
aty prej nga vjen gjama:
Në Rrëmaji.
Aty
me ba bè në Kryqa
se nuk kanë ma me ia lëshue
zezanen Shkodër
gjaksorëve,
që e shkallmuen në trup
e në shpirt
me drapën e çekan.

Një gumzhimë e mnerëshme
prej Rrëmajit del
e merr zemrat e njerëzve:

Asht kushtrimi
I Fatosave
flijue për Atdhe...
që paqë nuk gjejnë,
tradhëtue idealesh –
e gjamën mnershëm lëshojnë
nga ai Monument.

** Vorrezat katolike,*
Shkodër, 2010, 3 Maji.

Kopshti i Gjetsemanit...

E prap sot, mbas një dhimbjes së fortë që në zemer më ka piskatë, ndigjova një za... Një gumzhimë e mnerëshmeprej Rrëmajit dele merr për ajrì Alpeve... E as nuk më shkonte kurrë nder mend, se në Kopshtin e Gjetsemanit të Gazullorëve të Sapës, ishte thye... një degë ullini, ku Shpirti im gjente Paqen, Dijen, Kulturen, Fjalen e ambel të mikut të vertetë, freskinë e një flladi që frynte pa pushue...e në çastet e vështira kur merzija më kapllonte mendjen e **një mall të pakuptueshem, Fjala “durim bre Burrë!”, më bante me pranue “Paqen” që** shperthente nga zemra e goja e Danielit...

E sot,
bash një degë ku ishte ma e mira asht thye...
Zoti e mori
Atë degë me e mbajtë në dorë të Vet...
I duhet Atij të Lumit, per me na predikue,
Paqen, Drejtësinë dhe Dashninë...
Asht Ajo “Degë Ullini” që sot ra në Lezhë,
pranë të Madhit Gjergj Kastrioti!
Pranë Tij, po po, Aty asht edhe Daniel Gazulli!

Melbourne, 13 Nandor 2012.



Revista Kuq e Zi me drejtorin dhe bashkëpuntorët e saj, me dhimbje të madh marrin pjesë në hidhërimin e familjës Gazulli duke i shprehun ngushullimet ma të thella. Me Danielin, familja humn njeriun ma të dashtun. Revista humb një nga bashkëpuntorët ma të shquem, dhe shoqëria, një intelektual e pertsonalitet të naltë të kultures shqiptare. Ai u nda nga jeta në një moshë aktive të krijimtarisë letrare, ku kontributi **tij do të vazhdonte t’ishte i** randësishëm. Kujtimi tij do të vazhdojë të ruhet në faqet e vepra qe ka lane. Pushoftë në paqën e përjetshme të lumturisë Qiellore.

Lajmi i zi per Danbiel Gazullin mbushi gjithë gazetat e mediat shqiptare si një humbje e madhe për kulturën shqiptare , te cilat i dedikuen faqe të tana shkrimtarë e intelektualë miq e dashamirë j dhe vleresue të veprave të tia.

Kolec Traboini

KAMBANA E ZOTIT PER **MIKUN TONE KISH RA...**

Shenim:
Kjo është leter origjinale që më ka derguar i ndjeri Daniel Gazulli me daten

1 Mars 2010*Gjithçka mund të shkruash për Danielin veç fjalën vdekje jo për besë. Nuk ka të bëjë vdekja me Danielin. Ishte teper vital në fjalën e tij ndaj nuk mund të mësohemi me idenë se ai nuk mund të shkruaj më. Ishim mësuar ti lexonim shkrimet e tij të cilat më së shumti kishin pathos atdhetar, ngulmonin në nxjerrjen në evidencë të traditave kombëtare por edhe në fushë të letërsisë. Padyshim kur vinte fjala për Gazullorët pasioni i tij ishte i ndezur, sepse vinin që nga Gazulli i madh në kohën skenderbejane e deri tek të fundit vëllezrit martir Dom Gjon e Dom Nikoll Gazulli.* Daniel Gazulli ishte një njeri me vizion të gjërë, nga ata njerëz që tundohen tërë jetën për fatet e kombit ani pse nuk kanë ndonjë ofiq a kollutuk nëpër zyra qeveritare. Jo rrallë ka ndodh e vazhdon të ndodh që ata që nuk e kanë atdheun për kurrgjë, dalin me shitmendje në krye të kombit, ndërkohë ata që punojnë për komb e atdhe pa zhurmë e bujë heshtohen. Miku ynë Daniel ishte nga të heshturit, por që punonin përditë duke nxjerrë prej shpirtit fjalë e mendime të bukura. Edhe natyra e tij ashtu ishte, e bukur. Buronte një urtësi tek ai, një dinjitet i merituesshëm për gazullorët me emër në histori. Çfarë e bënte fjalën e Danielit aq të urtë, aq mirëdashëse, aq të thellë? A thua veç prej ndikimit të gazullorëve të mëdhej të kombit. Nuk besoj se ishte vetëm kjo megjithëse kjo i jepte një dinjitet të lartë ardhë prej genit tepër vital. Por ndikonte edhe fakti se Danieli ka qënë mësues, një mësues i mirë, që përçonte tek nxënësit jo vetëm fjalën e bukur e të mënçur, pra dijen por e jeptë atë edhe nëpërmjet qëndrimit të tij, ndaj shumë e thërrisnin Profesor Danieli. Një emër plotësisht i merituesshëm anipse nuk ja dha ndonjë akademi apo institut, por atë ja dha vetë populli që di të dallojë e të vlerësojë.Edhe atëherë kur shëndeti po e lodhte ai nuk reshti së shkruari.Më ka ra shëndeti, shkruante në një letër, por megjithatë, ço e rrëzo, përpiqem me dhanë ndonjë kontribut. Dha aq shumë me shkrime e letërsi të mirëfilltë duke përfshirë ato tregime të mrekullueshme për vendlindjen, poezitë, esét që mirëpriteshin nga lexuesit e shumtë e admiruesit e vet. Pat shkue me shpresë shërimi në Itali. E erdh një çast që u shkëput. Pastaj u dëgjua një zë të cilin nuk deshëm ta besonim. Teksa bisedoja me një mikun tonë të përbashkët i thamë njeri tjetrit se ka edhe keqkuptime e fjala hapet ndonjëherë edhe pa qënë e vertetë çka thuhet. Por doli se qe e vertetë. Gjëma kish ndodhur. Kambana e Zotit për mikun tonë kish ra. Ne ende nuk duam të bindemi. Duam të vazhdojnë të rrimë me mendimin se ka shkuar në Itali për tu kuruar e do të kthehet. E rrimë e lexojmë ato gjëra të bukura që ka shkruar. Në të vertetë jemi ne që shkojmë pak e nga pak tek ai. Kjo është jeta. Një kalim gjatë të cilit duhet të lëshosh sado pak dritë. E miku ynë Daniel Gazulli e lëshoi dritën e tij.

Krist Gjinaj

Daniel Gazulli – Jetëshkrim (4.10.1944 – 12.11.2012)

Jam i sigurtë se im'amë, e mira, do të kishte heqë dorë nga ajo lojë e ngatrrueme me tim atë, që më solli në jetë, po ta kishte dijtë ç'kalvar do të kalonte i biri. Ishte saktësisht ora 13:45 e datës 4 tetor 1944 kur unë qava për herë të parë, e thonë se qava shumë, sikur parandjeja që e ardhmja që më priste do të ishte as ma pak e as ma shumë, po një rrugë mundimesh të pafund.

Kur fillova të rritesha, e bashkë me moshën u shtuan edhe mbrapshtitë e mia, dëgjoja të më qortonin shpesh e të më kujtonin se unë nuk mund ta baja këte apo ate, sepse isha "një Gàzull". Aq shpesh ma përsëriste këte sidomos im ungj Simoni, sa ngandonjëherë matesha t'i thoja se isha gati të hiqja dorë nga mbiemni, mjaft të më linin rehat, se unë nuk dija të sillesha ndrysh. (Ma vonë – jo fort ma vonë, kam qenë ma pak se adoleshent – i kam qenë mirënjohës mbiemnit, sepse më nxiti të isha dikush, sidomos të stujoja, ndërsa kërkoja të vërtetat për Gjon Gàzullin, atë astronomin e matematikanin e shquem dhe ambasador i Kastriotit në Shekullin e Madh, shekullin e XV, deri tek Gjon Gàzulli i fundit, deputet Nolist, varë në litar në Fushë të Druve në Shkoder më 05 mars 1927, e tek gjuhëtari Nikollë Gazulli, pushkatue më 02 shkurt 1946, që na kishte lanë një liber të trashë me titull "Fjalorth i Ri").

Ja, kështu fillova të rritesha unë.

Shpejt, shumë shpejt, isha jo ma shumë se 11 a 12 vjeç, një pyetje e ankthëshme filloi të më mundonte.

Kisha dëgjue prej të mijëve se si kishin luftue kundër otomanëve, kundër Shkjaut e Fashizmit. Po ja që, në bisedat e të moshuemëve, më kapte veshi herë mbas here disa thanje që më shqetësonin thellë në shpirtin tim ende të parrahun me dallgët e jetës.

Ata shpresonin të vinte "inglizi" e të nxirrte jashtë "këta të Moskovit". "Këta të Moskovit", unë e dija se ishin pushtetarët tanë, komunistët, që nuk ishin të huej, kurse të moshuemit tanë shpresonin e kërkonin që "inglizi" t'i nxirrte jashtë, si të ishin pushtues. Ishte një punë tepër e ngatrrueme për mue në atë moshë, por që nuk u desh shumë kohë të më kthjellohej gjithçka, edhe pse unë "rioshi rebel" nuk isha për ndihmë të "inglizit".Nga mosha 14 deri më 20 vjeç pata për udhëheqës shpirtnor Atë Justin Rrotën, fratin e urtë, klerikun përparimtar, gjuhëtarin e shquem, mbi te gjitha NJERIUN E MADH. Ai më mori përdore (edhe pse vetë ishte gjysë i paralizuem) e më shkëputi nga bestytni të kota, nga fantizmi, që ishte një mësim aq i vlefshëm, sidomos për një qytet si Shkodra ku unë po rritesha mes njëmijë dyshimesh, që vinin nga paaftësia ime me kuptue e me shpjegue çka ndodhte rreth nesh.

Kisha fillue të shkrueja poezi e tregime që në moshë fare të re, po profesori im i letërsisë në shkollën e mesme, më porosiste "t'i ruaja, t'i hiqja mënjëanë, për kohë ma të mira, e të mos ia jepja kujtëdo t'i lexonte. T'i dërgoja për botim jo e jo". E pra unë ato nuk i shkruaja kundër Shtetit, as më shkonte në mend një gja e tillë, po shkrimet ashtu vinin vetiu.

Më 1967 më larguan nga arsimi, si i padenje me edukue brezin e ri me frymë revolucionare. Në atë largim randont e edhe një gabim i imi rinor, por randonte sidomos fakti që të dy gjyshët e mi, nga baba e nga nana, kishin qenë kulakë. M'u desh të përballesha me vështirësi të jetës së përditëshme ndërsa punoja punëtor në bujqësi, pak ma vonë normist, llogaritar në Ndërmarrjen Bujqësore të Lezhës e ma vonë në Ndërmarrjen Pyjore.

Pikërisht atëherë ndjeva se kisha nevojë për hapsina të tjera.

Më 18-20 gusht 1968 shkrova romanin "Një vit dhe një jetë". E mbaj mendë mirë, sepse mëngjesin e 21 gushtit, ndërsa kërkoja diku muzikë në radjo për t'u çlodhë, mësova se Bashkimi Sovjetik kishte pushtue Çekosllavakinë, një akt, tronditja nga i cili nuk më ka kalue as sot e kësaj dite.

Po atë vit, nga fundi i tetorit, shkrova romanin "Anmiku i popullit" dhe rreth gjashtë muej ma vonë romanin tjetër "Jeta nuk asht lpjë".

Por tashti po ndodhte diçka që nuk e kisha mendue kurrë: zvenitja përfundimtare e shpresave. Ka qenë një ndjesi rrënuese, që më çoi gati të hiqja dorë nga letërsia, sidomos nga krijimtaria, aq sa, në vitet '70/'80 shkruaja tepër rrallë, vetëm kur shpirti nuk mbante ma, e atëherë shfreja në ndonjë poezi, që i kam përmbledhë në vëllimin "Pështpëritje në vargje". Vitet në vazhdim qenë thjeshtë përpjekje me mbijetue e me rritë dy vajza të mira.

Në vitet '90, mbas përmbysjes së madhe, kam qenë ndër të zhgënjyemit e parë. Kudo, në çdo qelizë të Shtetit, të politikës, të mediave, të ekonomisë, të botës shpirtnore, u ricikluen njerëzit e diktaturës, trazime të mbrendëshme që i kam pasqyrue në ciklin poetik "Shpresa dhe zhgënjime".

Gjatë periudhës të një mërgimi të detyruem, shkurt 2000 – prill 2003, shfreja vetëm në poezi, një pjesë të të cilave i kam përmbledhë në ciklin "Mallë".

Kur u ktheva në Atdhe më 2003, nuk arrijta ta mbaja ma për vete zhgënjimin e kështu lindi romani "Mërgimtar në Atdhe" e pak ma vonë romani "Deti në mes".

Gjatë gjithë jetës, edhe pse janë fusha ku unë nuk kam asnjë lloj përgatitjeje të mirëfilltë, jam marrë edhe me hulumtime gjuhësore, etnologjike, folklorike. Pjellë e këtyne qasjeve janë vëllimi "Rrëfime zadrimore", studimi etnologjik "Sapa" (bocet), sidhe ndonjë shfrim gjuhësor si "Gjuha shqipe, e mira, e mjera".

Ja, pra, ky do të ishte pak a shumë jetëshkri im, jetëshkrimi i njenit që tashma ka humbë sensin e humorit dhe të vetëironisë.

E nuk asht humbje e paktë.

Daniel Gazulli

Perkthime nga poezia botnore.

RABINDRANATH TAGORE

MOS U LIGSHTO

Mos u ligshto, mbaju fort,
e do të fitosh.
Nata po iken:
guxim, mos u ligshto.
Shiko, në ball të lindjes,
përmes pëlhurës së pyllit
nalt
asht ngritë ylli i mëngjesit.
Guxim, mos u ligshto.

Janë bijë të natës, që në errsinë shtegtojnë
dëshprimi, dembelia, dyshimi:
ata, të pasigurtë, nuk janë
bijë të agimit.
Vrapo, nga errsina dil;
shiko, tej hidh vështrimin,
qielli po çelet.
Guxim, mos u ligshto.

EINRICH HEINE

HELENA

Më je betue në përjetësi,
Me fjalë të zjarrta gjithë magji,
Se do më duesh me afsh e zjarr,
Po s'më shuen etjen e jotja fjalë.
Buzët ti ven mbi timen gojë,
Der sa frymë t'na mbarojë.
Unë shpirtin tand ta pi due n' gotë
Dhe etja prap s'shuhet, asht e kotë.

MOS U BETO

Mos u beto, po ti puthje me jep;
betimin e grues nuk besoj; hesht!
E ambel fjala jote, po s'ka krahasim
me puthjen ne buze me rrembim.
Puthjes i besoj, puthjes qe me dhe;
fjala fluturon e nuk na nxeh.
Betohu, e dashun sa te duesh,
s'u besoj atyne kur t'm'i thuesh,
po kur koken ve ne gjinin tand,
atehere po, besoj e i lumtun jam.
Atehere besoj ne ty, e dashun, une,
se m'do perjetesisht e ndoshta dhe ma shume.

Arben Llalla

Skënderbeu
i fshehur nëpër arkivat greke

Nxierrë nga një artikull i historianit Arben Llalla

Skenderbeu, vizatim marrë nga një libër grek. Sipas Arben Allës, por edhe simbas disa hulumtimeve tona, rezulton se ne arkivat greke ruhen sekrete mjaf dokumentë historikë që upërkasin shqiptarve ashtu si dhe për Skënderbeun. Historia e popullit shqiptar është shumë e pasur me shkrime, libra, broshura që flasin për lavdinë e kombit tonë në luftë përekzistencë. Ato janë të fshehura nëpër arkivat e ndryshme të botës. Viteve tëfundit fal punës së palodhur të disa studiuesve shqiptar dhe të huaj kanë dalë në dritë gjëra të rëndësishme që lidhen me historinë e kombit shqiptar, por ende ka gjëra që nuk janë zbuluar dhe flenë diku nëpër bodrumet e shumëbibliotekave apo

Institucionet e ndryshme në Itali, Austri, Francë, Turqi,Greqi etj.Arkivat greke fshehin shumë dokumenta historike qëlidhen me shqiptarët. Për mendimin tim nëpër arkivat shtetërore, kishat, manastiret, bibliotekat private mund të gjenden gjëra me vlera të larta përshqiptarët si në fushën e gjuhësisë ashtu edhe atë historike. Por ende asnjë
studiues shqiptar nuk ka mundur të futet nëpër arkivat e shtetit grek sepseGreqia është kujdesur për konservimin e tyre për tu mbuluar nga pluhuri I harresës. Disa studiues kanë kërkuar dokumenta historike që i përkasin fillimeve të shek. XX, por revolucioni kulturor i rilindjes së vetëdijes
shqiptare ka nisur në fillimet e shek. XIX. Me plot gojë mund të thuhet lirishtse ka shumë dokumenta historike, gjuhësore e kulturore që janë botuar në gjuhënshqipe dhe greke në fillimet dhe nga mesi i viteve 1800 në Greqi. Por siç dhamë më lart Greqia është kujdesur që këto gjëra me vlera të larta për kombinshqiptar të mos dalin në dritë.Figura e Heroit Kombëtar të Shqiptarëve Gjergj Kastrioti duke qenë një figurë madhështore që e kanë zili ende sot. Disastudiues po krijon turbullira tek që më shumë do të thosha që janë kopjac tëkëqij se sa studiues serioz. Të cilët duke shpikur apo hedhur dyshime mbi origjinën e tij shqiptare kërkojnë tu dëgjohet pak emrin nëpër media tëndryshme. Që Skënderbeu ishte shqiptarë nga babai dhe nëna e tij këtë nuk eluan as topi, por ende në shekullin e XXI ka njerëz që duke parë madhështinë, krenarinë dhe trimërinë e këtij njeriu të madh dua ta "përvetësojnë" qoftë edhepër pak çaste.Në të vërtetë asnjë njeri nuk ka faj kur lexonvepra jo të trajtuara mirë, që më shumë i kanë shërbyer politikave ditore se sahistorisë së vërtetë. Grekët e shekullit XIX duke mësuar për trimëritëSkënderbeut frymëzoheshin dhe luftonin kundër Osmanëve për të fituar pavarësisë.Ka shumë shembuj për heronjtë e Kryengritjes grek të 1821 që ishin shqiptar osesiç i thërrasin grekët arvanitas mbanin me krenari shenjën e Bricjapit që dikure ka mbajtur Leka i Madh, Pirrua i Epirit dhe Skënderbeu.Gjatë kërkimeve të mia nëpër disa bibliotekaprivate dhe shtetërore gjeta shumë libra në gjuhën greke që flasin përhistorinë e kombin tonë të botuara në shek.XIX. Disa prej këtyre libravepërmenden tek-tek si bibliografi e shfrytëzuar, por që nuk na janë sjellë tëplota në botime. Edhe pse kërkimet e mia ka qenë private, të pa deklaruara munda të gjejë dhe të marrë gjëra me vlera të mëdha për kombin tonë. Emocione të forta ndjeva kur gjeta katër libra origjinalë në gjuhën greke që flisnin pëtrimëritë e Gjergj Kastriotit-Skënderbe.Edhe pse në këto libra bëheshin përpjekje për të faktuar që familja Kastrioti kishte origjinë greke ato kanëvlera sepse shkruhet për atë burrë që mbrojti pushtimin e Europës nga Osmanët.Që botërisht njihet dhe është vërtetuar shkencërisht që ishte shqiptar 24 karat. Grekët pretendimet e tyre për ta "Privatizuar" Skënderbeun më shumë ibazojnë tek emrat dhe mbiemrat e familjes Kastrioti që sipas tyre kanëkuptimësinë në gjuhën greke. Duhet të dimë se në shekujt e mëparshëm njerëzit e
kombeve të ndryshëm emrat dhe mbiemrat i kishin fetarë. Në qoftë se do tëmendojmë me logjikën e paditurisë që pretendojnë grekët atëherë do të themi se ish-Kryetarii Kubës Fidel Kastro është grek sepse ai mbiemrin e ka grek KASTRO (kala,kështjellë). Po të mendojmë me këtë logjikë të thjeshtë unë do të them sedeputetët grek kanë mbiemra të kuptimësisë në gjuhën shqipe, sllavisht,turqisht dhe shumë pak greqisht. Pa folur që qytetet e greke kanë emërtime qëzbërthehen në gjuhën shqipe. Edhe shumë emra të fesë ortodokse janë në gjuhënhqipe me disa ditë lutjesh fetare. Por kjo është temë më vete që duhet tëshikohet.Në qoftë se për një çast të mendojmë që Skënderbeuishte grek. Atëherë pse Skënderbeu nuk luftoi për çlirimin e Greqisë? PseGreqia e djeshme dhe e sotme nuk ka një bust të Skënderbeut për ta lartësuarfigurën e tij?Ish-sekretari në ministrin e jashtme italiane nëvitet 1930 De Martiko do të shprehej për grekët: "Grekët janë të aftë, që tëmarrin një zezak të vërtetë amerikan, të zi si qymyri, dhe pasi tapunojnëgjashtë muaj me të, ta kthejnë përsëri në Amerikë me besimin e plotë tek vetjae tij se ai është pasardhës i drejtëpërdrejtë i Themistokliut".Pra tezat fëminore e studiuesve grek, sllavë dhetë disa studiuesve të djeshëm dhe të sotëm për origjinën greke apo sllave tëfamiljes së Kastriotëve bien poshtë si teza të pavërteta të cilat nukmbështeten tek shkenca, por tek politikat ditore.Si përfundim Skënderbeu lindi shqiptar dhe vdiq shqiptar. Ai, ishte trashëgimtar i mbajtjes së shenjës së Bricjapit që e kishtembajtur Leka i Madh dhe Pirrua i Epirit.

Greva tragjike e urisë

Në emër të të gjithe të përndjekurve politikë qe jetojne jashte atdheut neper botë, i shprehim familjës së Lirak Bejkos, ngushullimet tona më të thella për vdekjën e të dashurit të të tyre. Sakrifica supreme e Lirak Bejkos, tronditi te gjithe shqiptaret ashtu dhe botën e jashtme. Por sacrifica e vdekja e tij duhet të trondise qeveritarët e politikanët që u bënë shkaktarë të kesaj tragjedie te madhe. Ai e dha mesazhin e madh të padrejtësive që u behën ish të përndjekurve politikë në Shqiperi. Shprehim ngushullimet tona edhe ish te burgosrve politikë bashkëvuejtës të tij, që ne Lirak Bejkon njihën e simbolizohen. Ai mbetet nje hero i vertete i te drejtave te njeriut !

Skena e tmerrshme e vetflijimit me zjarr të Lirak Bejkos që mbushi TV e botës.

Kujtimi i tij qoftë përjetësisht i lavdishëm.

Lirak Bejko në grevë

Përciellim këtë mesazh me fotot e tragjedisë tronditëse të vetflijilmi tij, një akt i pashëmbëllt në historinë e shoqërisë shqiptare. Një akt i një sakrifice që nuk mund të mbetët në heshtje e që tingëllon si një akuzë e madhe ndaj atyre që u bënë shkaktarë pa pasur ne vetvete asnjë pikë ndjenjë humanitare !

Lirak Bejko i jep zjarr vetes, i vetedishëm përsakrifikimin e jetës tij për të drejtat e mohuara, duke shkruar një faqe heroizmi të pashëmbëllt në historinë shqiptare.

Mediat e hueja.

Albanian dissident dies of burn wounds

November 2 2012 at 08:40pm
By Reuters

Agjensia e Lajmeve Reuters

Lirak Bejko, an Albanian former political prisoner in Albania who was seeking speedier government compensation has died three weeks after he set himself on fire during a hunger strike, activists say.(AP Photo)

Tirana - An Albanian communist-era dissident died on Friday of severe burns after he set himself on fire during a hunger strike calling for compensation for time spent in jail under communism.

Lirak Bejko, 47, set himself on fire three weeks ago, two days after another dissident - both of them among a group of 20 hunger strikers.

The dissidents said they had been paid only a fraction of the money owed to them under a 2007 law meant to compensate political prisoners held during the Stalinist regime of late Albanian leader Enver Hoxha.

Bejko had been sent to hospital in Bari, Italy, where he succumbed to complications from his injuries

On interviewer in hospital that he wanted his fellow dissidents to continue their protest but not to follow his example.

"I love them very much. I do not want them to feel my pains. They are atrocious, it is like meat roasting," he said, his head bandaged and his voice rasping.

The hunger strikers ended their fast last month, some after collapsing and being taken to hospital. The government refused to talk to them, saying it saw their strike as politically-motivated.

Some 6 000 people were executed under Albania's communist regime, which collapsed in late 1990. Tens of thousands were jailed or sent to labour camps or internal exile. - Reuters

BBC NEWS

2 November 2012 Last updated at 23:12 GMT

Albanian ex-dissident dies after self-immolation protest

Mr Bejko was one of tens of thousands imprisoned under Albania's decades of communism

Continue reading the main story

Skena e tmerrshme e vetflijimit me zjarr të Lirak Bejkos

.

Related Stories

An Albanian former political prisoner who set himself on fire in protest at delays in government compensation for communist-era dissidents has died

Lirak Bejko, 47, had been taken to a hospital in Bari, Italy after setting himself on fire on 10 October.

He was one of 20 former dissidents who began a hunger strike over the compensation issue in September.

The government refused to talk to the protesters, saying that their action was politically motivated.

.

Before his death, Mr Bejko - who suffered burns on 50% of his body - told an interviewer in hospital that he wanted his fellow dissidents to continue their protest but not to follow his example, Reuters news agency reports.

"I love them very much. I do not want them to feel my pains. They are atrocious, it is like meat roasting," he said.

'Desperate acts'

Under a law passed in 2007, Albania's former political prisoners are entitled to compensation of 2,000 lek (£11.50; $19) for every day that they spent in prison.

The hunger strikers in the capital, Tirana, had accused the government of failing to deliver that entitlement.

Një sakrifice tepeër e madhe e tragjike që jep qartas moskokëçarjen e shtetit ndaj atyne që pësuan terrorin e egër komunist.

Skender Tufa, head of the association of former political prisoners, said Mr Bejko's self-immolation, and that of fellow ex-dissident Gjergj Ndreca, were "desperate acts" by people he described as "walking corpses, deprived of any dignity".

The hunger strike was called off after some of the participants became severely weakened.

Tens of thousands of people were executed or imprisoned in labour camps during the decades-long communist rule of Stalinist leader Enver Hoxha.

BBC NEW

RFI, Francë

Un ancien détenu politique albanais décède après s'être immolé par le feu.

Des manifestants brûlent des portraits du Premier ministre albanais en soutien aux anciens prisonniers politiques en grève de la faim.

Un ancien détenu politique albanais est décédé dans un hôpital de Bari, dans le sud de l'Italie. Il s'y trouvait depuis trois semaines, après avoir tenté de s'immoler par le feu à Tirana. Il réclamait le paiement d'une indemnisation pour les années passées en prison sous le régime communiste albanais.

Lirak Bejko n'avait que 47 ans. Il y a trois semaines, par désespoir, il s'est arrosé d'essence devant une caméra, puis il a craqué une allumette. Il s'est transformé sur le champ en torche vivante.

Auparavant, avec vingt autres anciens détenus politiques, il avait suivi pendant plusieurs jours une grève de la faim dans la capitale albanaise, Tirana. Brûlé à 50%, Lirak Bejko a été transporté et soigné dans un hôpital de Bari (Italie). Avant sa mort, il a dit qu'il voulait que

ses camarades continuent à réclamer leur droits, mais sans suivre son exemple, car les douleurs sont atroces.
Une loi datant de 2007 donne droit aux anciens prisonniers politiques albanais à un dédommagement de 14 euros pour chaque jour passé en prison. Selon une source officielle à Tirana, plus de 11 000 anciens détenus politiques ont déjà bénéficié d'une première tranche de cette indemnisation.
Les protestataires, dont faisait partie Lirak Bejko, accusent les autorités albanaises de ne pas vouloir dialoguer avec eux, sous prétexte que leur action serait motivée politiquement. A cause des dissensions entre la majorité de droite et l'opposition de gauche, les réformes avancent difficilement en Albanie, ce qui bloque son intégration euro-atlantique

==========

Ded Gjo Luli me trimat e tij.

"FLAMURI NE DEÇIQ"

I PALOK TRABOINIT

Një libër me dëshmi historike për Kryengritjen e vitit 1911



Një libër me vlerë historike.

Kopertina e librit të Palok TraboiniNë kuadrin e 100 vjetorit të pavarësisë vjen në botim libri "*Flamuri në Deçiq*" me autor Palok Traboini (Gojçaj). Gjithçka që ka të bëjë me krijimet e Palok Traboinit janë botuar pjesërisht më parë apo kanë mbetur në dorëshkrim dhe i takojnë viteve 1908-1911. Libri përfshin katër kapituj që paraqesin aspekte të ndryshme të krijimtarisë e të jetës së këtij autori që gjithashtu ka qenë një veprimtar i njohur në vitet e pavarësisë si gazetar, mësues e si luftëtar. Ai ka qenë sekretar i Ded Gjo Lulit dhe i ngarkuar prej tij ka sjellë përmes Dalmacisë flamurin e porositur në Vjenë nga Alardo Kastrioti për kryengritësit shqiptarë të Malësisë së Veriut, flamur ky i njohur nga Fotografia e Marubit fiksuar me emrin Flamuri i Deçiqit apo ndryshe Flamuri i Ded Gjo Lulit. që bien e ndër ta Kol Marash Vatës, Gjon Ujk Çekut e trimave të tjerë të rënë për liri.

Moment të veçantë në poemë zë ai kur Ded Gjo Luli u kërkon djemve të shkojnë e të vënë flamurin e Skënderbeut në maj të Bratilës së Deçiqit. Shkrimet e studiueve Hamit Boriçi, Fran Camaj, Gjovalin Shkurtaj dhe Fatmir Terziu mbi disa tipare tipare të publicistikës dhe analiza të poemes historike të Palok Traboinit përbëjnë kapitullin e tretë të librit "Flamuri ne Deçiq". Kapitulli i katërt vijon me dëshmitë e ish-nxënësve dhe bashkkohësve mbi veprimtarinë e mësuesit dhe luftëtarit të dy luftrave kombëtare duke përfshirë dhe luftën e Koplikut 1920, Palok Traboini e në vazhdim kujtimet e të birit Kolec Traboini, i cili, anipse i mbetur jetim që në moshë të vogël, nëpër vite ka arritur të mbledhë plot materiale e fakte mbi jetën e prindit të munguar. Shënimet e birit për Atin mbajnë titullin "*Një kërkim që fillon e nuk mbaron kurrë*".

Libri mbyllet me një album fotografik të nxjerra nga *Fototeka Marubi* ku Palok Traboini shihet bashkë me Ded Gjo Lulin e krerët e Malësisë që në vitin 1908, në mes të një grupi të vogël që Kel Marubi e ka shënuar "Disa luftëtarë të Deçiqit", një foto tjetër ku Palok Traboini është bashkë me At Gjergj Fishtën, At Anton Arapin, At Benardin Palaj, At Martin Gjokën, At Marin Sirdanin, Simon Rrotën, Kol Gurashin, Kolë Kamsin, Ndue Palucën e të tjerë si trupa mësimore e shkollës së fretënve në vitin 1924. Dëshmitë që sillen në këtë libër plotësojnë një kuadër të munguar të ngjarjeve historike të Kryengritjes së Malësisë së madhe 1911, por edhe sjellin në vëmendje një figurë atdhetare të lënë në heshtje, publicistin, poetin, mësuesin e parë të Malësisë së Madhe, sekretarin e Ded Gjo Lulit.

Nik Klementi

Pse Skenderbeu Nuk Dúhet me Fól Toskrísht?

Nik Klementi

Në novelen e tíj 'Shkundullíma', Martin Cámaj trajton një aspekt të shoqnís moderne të pagjétun në letersín, artin, e mendímin shqiptár. Atë të ruajtjes dhe të perkujdésjes ndaj kultúrave lokaleve – respektimit te etnis se një populli. Ne at veper ai pershkruan një fshat Arbnesh në jug të Italís i cili kishte arrít një balánc të perkryeme ne mes te njeriut e natýrs, moralit e sjelljes, intelektit e ndjenjave. Një luhátje sado e vógel mund ta disbalanconte ket harmoni. Ndodh qe një bír i ktij fshati, i cili ishte 'civilizua' ne veriun e qytetnuam të Italis, kthehet per t'u sjell katundarve Arbnesh 'urbanízmin'. Ideja e tij ishte ndertimi i një ure që do të lidhte katundin me një qytet te madh, çka do te mundsonte

tregtimin e madhnave dhe shkembimeve kulturore. Por projekti i tij nuk permbushet prejse, ashtu si në tregímet e grékve të lásht, vét tóka 'shkundullohet'; shperthen flák e shkatrim nga zémra e dhéut. I gjíth katúndi sheshóhet. Úra thërmóhet.

Sót në Shqiptarí ka shum kultúra lokále të cílat kán krijúa një balânc të perkrýeme prejse banórt e ktýne zónave kán shékuj që bashkjetójn. Ato kultúra duhen rúajt së báshku me dóket, zakónet, kângt, legjéndat, e herójt e týne. Por, idéja se pasunía kulturóre, giuhsóre, e materiále e një etníe dúhet rúajt në trájtën origjinâle, vazhdon me kên e húaj për shqiptárt. Elítat shqiptáre dominóhen nga koncépte pseudo-patriotíke / nacional-folkloríke, ku aspéktet etníke të nëngrúpeve shqiptáre shíhen vétëm si përçáse te 'unitétit kulturór e giuhsór' te Shqiptarís. Prandéj, kultúrat lokále në shqiptarí vazhdójn me kên objékt stereotopizími e përçmími.

Si pópull, nâ nuk e kém kuptúa kúrr sá dúhet rândsín e perkujdésjes dhe zhvillímit të tradítave të láshta shqiptáre. Veçsísht, nâ nuk kém kuptúa koncéptín se etnía dhe historía e pópullit nuk guxón të modifikóhet. Vét 'Epíka Shqiptáre' nuk u pat regjistrúa as botúa në të fólmen e Lékve të Malcís, por në koinén e Komisís, e cíla shkrín gegnísht qytetáre, dukagjinísht, dhe myzeqarísht. As në 'Lahúta e Malcís' personâzhet nuk flásin në Leknísht. Nuk mund t'i akuzójm Palajn, Kurtin, e Físhten për shkímje te qellímëshme të giúhs e kultúrs së Lékve, préjse ata punúan me të gjith potenciálin e týne për t'a rúajt atë. Por, prápsepráp, në kto dý vépra të pazevendsúashme, ndóshta mâ te pazevendsúashmet në letrát shqipe, âsht modifikúa e etnía autoktóne.

Pas demokracís, disa persóna, jo fórt të thúkt, vendósen me i perkthye 'Epíken' dhe 'Lahúten' në toskrísht. Për hér të pár, një númer i madh intelektualsh, giuhtársh, e shkrimtársh, në mes tyne edhe giuhtári Gjovalin Shkúrtaj dhe botúasi Hasan Lékaj, presidént i shtëpís botúase Cámaj-Pipa, u ngríten kunder ksáj idéje. Ajo idé u fashit për do kóh. Por kët vjét, ky koncept ka qít krýe práp në kanálin televizív 'Vizion Plus' si një ndërmârrje e Piro Milkânit dhe Esat Mysliut për t'a pershtát ligjrátën gége në fílmin e Sergei Yutkevichit, 'Skanderbeg', në toskrísht.

Esati thót se versióni tósk tingullón mâ besúashëm, mâ natýrshëm, dhe mâ artistik. Sesi tingullúaka një Dibrân, pra Skenderbeu, mâ i besúashëm dhe mâ natyrshëm në toskrísht sesa në gegnísht kjo nuk mund të konceptóhet nga një méndje që âsht së páku në gjéndje normále. Dublími i ligjrátës së një dibrâni në toskrísht âsht përtej teprímit. Skenderbeu si Lalë?! Si Láb!? Kjo e bân atë me tingullúa qesharák. Imagjinó, Selam Musain para sulmit mbi ushtrin italiâne në Vlorë me 1920 duke u fól labëve në dibranisht. A nuk do të tingullónte Selami qesharak? Në mënyré sesi ai shkrúan (egzaktísht) , '… do të tingllojë që shum më teper i besushëm, shumë më tepër i natyrshëm, dhe shum më tepër artistik'. Çka dmth 'shum më teper i besushëm'? Fjála 'téper' dmth super-mír, apo kéq? A jân gjânat e téperta, dhe të teprúame, të dëshirúashme? Me kén téper i besúashëm dmth me kên shum i besúashëm apo mashtrúas?

Dublími i fílmit (meqë shqiptárt nuk jân të zótët me bâ një film të vétin) duhej të kíshte ndjék rrúgen e kúndert—dréjt gegnishtes; mâ Dibrân! mâ Skenderbe! Nâ a dúam Skenderbéun me kén dibrân, me u vésh si dibrân, me fól si dibrân, me u sjéll si dibrân, me u ndjé si dibrân. Na dúam Skenderbeun autentik, Skenderbéun që u rrít në oborr të Sulltânit. Skenderbeun që u lídh me evrópen. Nâ dúam Skenderbéun e vertét, jo Skenderbeun anti-katolik të Yutkeviçit; as Skenderbeun myzeqár të Esat Myslíut. Veçsísht, nâ nuk dúam t'a abuzójm figúren e Skenderbéut për te propagandúa gjúhën e Kongresit '72.

T'a bâsh dibrânin e para 500 vjétve me fól si myzeqár i shékullit 21 âsht mâ shum se cek

si – âsht idiotizem.

Shënim :

Si përkthyes i veprës së At Dhimitër Frangut nga italishtja e vjetër popullore (vulgare), me doli problemi se në ç'far forme të gjuhës shqipe duhej. Zgjodha gegenishtën letrare, jo vetëm se isha verior, por duke qene se e gjithe historia e Gjergj Kastriotit zhvillohej ne viset veriore e vete Skënderbeu e trimat e tij, flisnin dialetin kruetan, matjan, dibran e malesor, siç e tregon vetë historia. Nuk kishte asnjë kuptim qe fjalimet e tij të transkriptohëshin tosknisht. Dhe pata një befasi të kenaqëshme, sepse kush e lexoi librin nuk gjeti asnjë vështirësi, dhe bile me pergezuen qofte Prof. Verioë ashtu dhe Jugorë, dhe asnjë nuk bani vrejtje për gjuhën e përdorun, por pata dhe lavderime ne atë drejtim. Pra të shkruejsh shqip si duhet nga ana letrare, qoftë gegnisht ose tosknisht, nuk krijon pengesa as ne lexim as ne kuptim, sepse shkruhet shqip. Prandaj si genishtja ashtu tosknishtja letrare, jane përmasat e gjuhës shqipe, pa asnjë dallim. Kambngulja me qëndrue ne « gjuhën standarde » tosknishtja e diktatorit, asht sa absirde, aq dhe nje sjellje përçarëse antishqiptare.

Dulimi i filmittosknisht do t'ishte një gabim trashanik dhe nje fyerje për vetë Gjergj Kastriotin Skënderbeun, por edhe për autorët e regjizorët e filmit, që mirëfilltas i kanë njoun problemet gjuhësore shqiptare.

Lek Pervizi

Leonora Koçi

KUQ E ZI

(kushtuar revstës Kuq e Zi)

Kushtuar revistës Kuq e Zi me 1997.
Ne dore te marr shpesh e te veshtroj,
ap fletet nje nga nje e rri e mendohem.
Larg tres shikimin ndersa lexoj,
Per çka shruhet ne to rri e kujtohem.

Shum vite kalueo nen ate roberi,
Te vegjel ishim-dhe nuk e besonim
S'aq gjate do te qendronim n'skllaveri:
Mbas pes'dhjet vjet lirine do te fitonim.

Sa here e merrja penen ne k'te dore
Per te radhitun q'ishirn duke pesuar,
etrat roe lot i laja si nje e gjore:
Kush mendonte se i' dit' do kisha shkruar?

Isha e re, n'vargje shprehja hidherimin
Lart mbi terracen, detin duke veshtruar.
Tut je mbi dallkat tretnja shikimin :
Zog dishroja t'isha per t'fluturuar.

Me pisha t'larta rrethohesh krejt shtepia.
Cicirima e zogjve vazhdimisht degjohc0h.
He kapte ne zemer e madhe zilia :
Liria e tyne dq shum me deshirohesh.

Ish toka jone, atdheu yo' shqiptar
Por bisha barbare per kete s'rnendonte
Dh'e kish kethye ne burg e ne varr,
Prandaj njerzit i vriste e aty i mbulonte.

Ku shkuan intelektualet e Shqiperise,
Qe dijten aq bukur per te shkruar ?
Ku shkuan patriotet e Parnvaresise ?
Degdisur nder kampe mizore, shuar !

Kush dijti te kendoje per Memedhene,
Te ringjalle deshiren e lirise ?
Kush e shuajti dashurin per atdhene
me peshen e rancie te tiranise ?

Sa hypi ne fuqi qeveria barbare
E ngritur mbi eshtrat e shejta deshmore,
Me mijera intelektuale u qiten fare,
Pushkatuar e tretur nder kampe mizore.

Ife gjyqe speciale e qesharake gj ykuar,
Plot trillime, genjeshtra e sajime kurdisur,
Kush t'verteteo me thane do kish guxuar,
Me plumb ne koke do te kish bitisur.

Per nje gjysm shekull' pesuem keto mundi::
Jè, Prej t'egrit regjim komunist ne fuqi. '
Sot e verteta po deI neper shkrime,
T'revistes flamurtare " KUQ E ZI " !

==========

Vlash Prendi

Papa Klementi XI dhe arsimi shqip

1 Gjergj Kastrioti dhe selia e shenjtë, Republika, 4.11.'12

Marrëdhëniet e Gjergj Kastriotit me Vatikanin janë pasqyrë e një prej aspekteve më të rëndësishme të personalitetit të tij prej burri shteti dhe diplomati të lindur në Dibër me 6 maji 1405 dhe vdekur në Lezhë, më 17 janar 1468. Duke qenë se Selia e Shenjtë në Mesjetë ishte pushteti qendror i Evropës dhe ushtronte autoritetin e saj si mbi aspektet fetare të banorëve të Evropës, ashtu edhe mbi të gjitha aspektet e tjera të jetës së tyre, ishte mençuri nga ana e Skënderbeut që të përpiqej të fitonte vëmendjen e Vatikanit dhe ta përdorte për qëllimet e tij. Qysh në fillim duhet theksuar që marrëdhëniet midis Skënderbeut dhe Selisë së Shenjtë u ndërtuan mbi bazën e një interesi të ndërsjellë, si nga ana e Skënderbeut ashtu edhe nga ana e Selisë së Shenjtë, interesa këta që erdhën duke u forcuar me kalimin e kohës dhe me rritjen e famës së Skënderbeut si strateg në luftën kundër osmanëve. Që Skënderbeu të fitonte plotësisht besimin e Selisë së Shenjtë iu desh kohë dhe shumë fitore kundër turqve. Papët Eugjen IV (1431-1447) dhe Nikolla V (1447-1455) e afruan mjaft Skënderbeun, por nuk mund të thuhet se ata të vetmen shpresë e kishin tek ai dhe për këtë arsye ta përqendronin të gjithë vëmendjen e tyre për luftën kundër otomanëve te ai. Ata e kishin të përqendruar vëmendjen e tyre edhe tek shteti Hungarez, por dhe tek Kostandinopoja, që aso kohe mbanin barrën kryesore të luftës së krishterimit kundër jobesimtarëve, ndërkohë që me Papën Kalisti III (1455-1458), sidomos në fund të pontifikatit të tij, vëmendja e papatit ndaj Shqipërisë rritet, për të arritur kulmin me Papën Piu II (1458-1464), i cili e konsideronte Skënderbeun si komandant të ushtrisë së krishterë kundër turqve. Që në fillim të fushatës së tij antiosmane. Skënderbeu tregon qartë që po kërkonte një orientim perëndimor-katolik. Disa historiane thonë se papët e ndihmuan Skënderbeun vetëm me bekime apostolike, por Noli e hedh poshtë këtë gjë, duke pohuar që papët "e ndihmuan Skënderbeun me të holla tingëlluese që arrinin në mijëra dukatë ari të thesarit papal".

Marrëdhëniet diplomatike midis Skënderbeut dhe Selisë së Shenjtë, si dhe përkrahja financiare e papëve për fushatat e tij kundër turqve, kishte qëllime politike në sfond. Kryqëzata kundër turqve ishin shpallur nga të gjithë papët e shekullit XV, por me Papa Piun II, i njohur si predikues e promovues i kryqëzatës dhe që kishte treguar interes për Shqipërinë e për Skënderbeun, ngrihej në përfytyrimet papnore si një bazë për planet kryqtare dhe Skënderbeu si udhëheqës i kryqëzatës së planifikuar. Kjo duket qartë në një dokument të prillit të vitit 1463, në të cilin Papa Piu II, Republika e Venedikut, si dhe aleatët e tjerë i kërkonin Skënderbeut që të nënshkruante një marrëveshje me ta për luftë kundër turqve. Pas fitores së Skënderbeut në

Papa shqiptar, Klemnti XI

vitin 1464, Papa Piu II ishte përfundimisht i bindur që Skënderbeu do të ishte udhëheqësi i ushtrisë kryqtare të krishterë kundër turqve. Por, Papa Piu II vdiq në Ankona, kur po fillonte kryqëzatën dhe bashkë me vdekjen e këtij pape, vdiqën edhe idetë e tij.

PAPA KLEMENTI XI =GJON FRANCESK ALBANI – LAÇI

Padyshim një kontribut te shquar në lëvizjen për zhvillim kulturor dhe arsimor në trojet shqiptare dhe më gjerë ka dhënë edhe biri i Arbërisë Papa Clementi XI – Gjon Francesk Albani, papë ky që la gjurmë në historinë shumëshekullore të Selisë së Shenjtë. Në listën e gjatë të 282 papëve që kanë udhëhequr Selinë e Shenjtë deri në ditët tona, figurojnë edhe disa emra papësh dhe kardinalësh shqiptarë që kanë drejtuar këtë institucion të shenjtë. Sipas fakteve dhe dokumenteve historike janë katër papë shqiptarë qe e kanë drejtuar këtë Seli duke filluar nga Shën Eleuteri (174-189), Shën Kaji (283-296), Shën Gjoni IV (640-642), por papa që la gjurmë në historinë shumëshekullore të Selisë së Shenjtë është papa Klementi XI, Gjon Francesk Albani-Laçi ose Xhian Francesko Albani De Lazio)1. Edhe patër Vincens Malaj mendon se për origjinën e tij nuk ka kurrfarë dyshimi se është shqiptare, sepse ".. . familja Albani e ka prejardhjen nga dy emigrantë shqiptarë Gjergji dhe Filipi, dy djemtë e Mëhill Laçit që dikur kishin qenë luftëtarë nën urdhrat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Këta burra trima e të njohur për patriotizëm duke mos duruar zgjedhën turke braktisën atdheun e tyre dhe u strehuan në Urbino…") 2. Kështu mendon edhe studiuesi i njohur italian Giovani Armilota ku thekson se "…Familja Albani u krijua nga dy vëllezërit shqiptare, Gjergji dhe Filipi të Mikelit nga Laçi…") 3. Këtu, Frederiku dhe Guidoboldi i Montefeltros shfrytëzuan aftësitë e tyre duke i caktuar si nëpunës për çështjet diplomatike dhe ushtarake. n Albanezi, që më vonë Altobeli, djali i Gjergjit e ktheu në

Në fillim u njohën me mbiemri Albani. Më pas, "nga Altobeli (1495-1564), lindi Hanibali (1530-1591), nga Hanibali Lindi Horaci (1576-1653). Nga djali i tij Karli (1623-1684), martuar me Helena Moskën nga Pezara me 1649 lindi Gjon Francesku…") 4. Të habit fakti se në shumë jetëshkrime të tij nuk përmendet prejardhja e tij nga Laçi, që i përket Kurbinit. Mbiemri i tij Laçi është i justifikueshëm, pasi ky qytet del në dokumente me emrin Laç, me 1467, me 1557 del me emrin Sebaste, ndërsa me 1644 dhe 1672 përsëri del me emrin Laç)5. Prandaj edhe emërtimi Laçi përputhet plotësisht me periudhën e lindjes së tij. Këto të dhëna që na i sjell Dr. Vincens Malaj vërtetojnë se Papa Klementi XI ka patur origjinë nga Laçi i Kurbinit. Nuk është e rastit edhe letra që u dërgon Vincens Smajeviku gjithë Ipeshkvinjve të Shqipërisë për ti mbledhur ato në kuvend sipas porosisë së Papa Klementit. Dhe kjo letër drejtohet nga Kisha e Kurbinit, vendlindja e Papa Klementit ku thuhet: "Ju pra o vëllezërit e mi, kryeipeshkvinj, jeni thirrur prej meje, e ju o ipeshkvinj që jeni nën mua dhe meshtarë të tjerë, të parët e kishave, duke ju urdhëruar po ju bëj të ditur që të vini e të mblidheni në Kuvend të Arbnisë." Shkruar në Kurbin në të dhjetën ditë të dhjetorit 1702) 6. Prejardhjen e tij nga Laçi, e ka vënë në dukje edhe gazetari dhe studiuesi italian Giovanni Armilota, studiuesja Engjëllushe Varfi, gazetari Altin Kreka si dhe publicisti i njohur Adrian Beshaj, duke vërtetuar origjinën e saktë të Gjon Francesk Albanit-Laçi. Nga kjo familje me tradita kulturore dhe fetare rrodhën papë, kardinalë, diplomatë dhe burra të shquar shteti. Gjon Francesk Albani i biri i Karlit dhe Elenës nga Laçi, lindi me 23 korrik 1649 në Urbino ku vite më parë familja e tij kishte ardhur nga Laçi i Kurbinit për t'i shpëtuar regjimit osman. Që në fëmijëri, Gjoni u dallua për zgjuarsi, shkathtësi dhe këmbëngulje për kryerjen e detyrave. Kur ishte vetëm 11 vjeç, filloi studimet në Romë në kolegjin roman të jezuitëve me rezultate të shkëlqyera. Puna e tij bie në sy të mbretëreshës Cristina Sversia qe e ndihmoi. Pasi përfundoi filozofinë dhe teologjinë mori me shumë devotshmëri pushtetin meshtarak. 7. Shpejt fitoi simpatinë e Papës qe e caktoi në detyra të ndryshme të nivelit të lartë si Ipeshkv i Rietit, pastaj i Sabinës e Orvietas e deri Sekretar i letrave papnore, ndërsa Papa Aleksandri i VIII e shuguroi kardinal në vitin 1690. 8. Ishte i biri i Karl Abanit, nga familja e njohur shqiptare Albani, qe u bë njeriu më i shquar në Selinë e Shën Pjetrit.

Me 1 nëntor 1700 vdes Karli II, mbreti i fundit i dinastisë së absburgëve, i cili duke mos pasur më pasardhës të tij, testamenoi në fronin mbretëror Filip D'Anzhu, nip i Luigjit XIV mbret i Francës. Pikërisht me 6 nëntor të vitit 1700 Filip D'Auzhu u shpall mbret i ri i Spanjës me emrin Filip V, qe shenonte fundin e dinastisë së absburgëve dhe fillimin e dinastisë burbone. E gjithë kjo ndodhte kur Selia e Shenjtë kishte humbur qe me 27 shtator të vitit 1900 Papa Inocens-Automia Pignotelli, fisnik napolitan dhe po bëheshin përgatitjet për zgjedhjen e papës së ri. Duke ndjerë rrezikun qe i kanosej, Selia e Shenjtë mblodhi Konklavën 3 ditë pas shpalljes së mbretit Filip V i Spanjës, pikërisht me 9 nëntor 1700 dhe me 8 dhjetor të vitit 1700, u zgjodh si pasardhës i Inocencos XII Kardinal shqiptar Giovanni Francesko Albani, në moshën 51-vjeçare.

Kuq e Zi hyn në 20 vjetorin e botimit të saj më tetor 1993

Në punimet e Konklavës morën pjesë 57 kardinalë, nga 66 të tillë qe përbenin kolegjin e Shenjtë, mes të cilëve edhe Ipeshkvi i Faences Marcello Duroria – Durrësi)9. Konklava e kardinalëve e zgjodhi Gjon Francesk Albanin papë, nisur nga cilësitë e tij të vyera morale dhe fizike. Aftësitë e tij të mëdha intelektuale, sjelljet e përpikta e të shkëlqyera, dinjiteti i jashtëzakonshëm, përvoja e gjatë në zbatimin e së drejtës komunare dhe kishtare, njohja e thelluar e situatës politike aftësia e formulimit me shkrim dhe me goje e qëndrimeve, puna e palodhshme, temperamenti i përzemërt dhe kujdesi ndaj të varfërve", vlerësoheshin në gjithë rrethin e kardinalëve. Me tej G. Moroni e përshkruan këtë fisnik nga Laçi, me trup të lartë, me pamje të bukur. Ishte i pari pas Klementit VII qe u ul në fron pa mjekër. Ballë lartë, me shikim të mprehtë, me pamje disi të zbehtë, flokë dhe sy të zez, kishte zë tingëllues, mendjemprehtë, kujtesë fenomenale. Zotëronte bukur gjuhën greke dhe latine. Ishte erudit i madh dhe njeri i drejtë".)10

Me ardhjen e Papës Klementi XI në Selinë e Shenjtë për kishën katolike shqiptare fillon rilindja shpirtërore, Jezuitët fillojnë të interesohen për shqiptarët. Nën kujdesin e tij mblidhen letra, qarkore ipeshkvnore dhe dokumente të tjera nga trevat shqiptare me qellim qe të kompletohet përmbledhja "Illirikum Sacrum") 11. Bëhej fjalë për dokumente të rëndësishme që flisnin për historinë e trojeve të Arbërisë dhe për mbledhjen e materialeve në këto territore flet edhe Daniel Farlati në veprën "Ilirikum Sacrum". Ai na bën më dije se Papa Clementi XI dërgoi në territoret e Arbnisë, përgjatë bregdetit Mesdhe një anije, e cila do të mblidhte dokumente historike për këtë territor. Kjo anije venedikase preku brigjet e "Arbnisë venedikase" deri në Tivar, pastaj kaloi edhe në "Arbninë osmane". Kështu At Riceputi hodhi një baze të fuqishme dokumentare duke mbledhur dhe renditur togje të mëdha dokumentesh që përmbanin të dhëna dokumentare për Arbninë, sipas porosisë së Papës Gjon Françesk Albani. Për sa i përket "Arbnisë osmane" thuhet se një qerre e madhe e tërhequr me qe dhe e ngarkuar me dorëshkrime, libra dhe dokumente të tjera historike, pasi kapërceu baltat e vështira të Zadrimës, u mbyt aksidentalisht duke kapërcyer lumin e Drinit, bashkë me të gjithë dokumentet e grumbulluara. Kishte dashuri të madhe për vendlindjen dhe thoshte me krenari prejardhjen e tij shqiptare. U dhuroi D. Farlatit dhe F. Riceputit një sasi dokumentesh të mbledhura në rininë e tij me qellim qe të shkruanin për origjinën dhe vjetërsinë e Ilirisë. Kërkoi nga Marin Bici qe ndodhej në tokat shqiptare të interesohej për prejardhjen shqiptare të familjes Albani. Edhe arqipeshkv Vencens Zmajevic bën fjalë për prejardhjen e Papa Klementit XI. Ai i shkruan profesorit të tij A. Patricia: "… Më gëzon së tepërmi zgjedhja e eminencës Albani në fronin e Papës, duke ditur se është miku yt.. . ")12.

Gjon Francesk Albani është pasardhësi i 261-të i Selisë së Shenjtë, ai e drejtoi këtë Seli për 21 vjet me radhë. Ai shquhej për një kod të lartë moral. U interesua shumë për rilindjen politike dhe fetare të atdheut të vet)13. Identitetin e tij shqiptar e pohon edhe Papa Pavli VI, në letrën e tij të botuar me 17 janar 1968 në Romë, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut ku mes të tjerave thuhet: "Nuk i harrojmë as ato burra të cilët ruajnë edhe fenë e tyre baraz me perkushtimin ndaj Selisë Apostolike për shërbim të së cilës ato dhuruan njerëz të përmendun për dituri dhe virtyte, si me kënaqësi po përkujtojmë paraardhësin tonë Klementi XI nga popullsia Albane, i cili krenohej me prejardhjen e vjetër të tij shqiptare")14.

Në vitin 1701, Papa Klementi themeloi për shqiptarët e Italisë një kolegj ne San Dimitria Korone dhe me 1708 siguroi një vend të përhershëm për një student shqiptar në këtë kolegj. Kur u emërua në Selinë e Shenjtë në territorin shqiptar kishte vetëm katër ipeshkvinj: Pjeter Zymi-arqipeshkv në Durrës, Pjeter Karaxhiq-ipeshkv i Pultit, Nikollë Veldonjin-ipeshkv i Lezhës dhe Gjergj Theodhori-ipeshkv i Sapës. Ai emëroi Vencens Zmajevikun në kishën metropolitane të Tivarit, Anton Babin në kishën e Shkodrës me 1701 dhe Marin Gjinin ipeshkv të Pultit… duke plotësuar kështu selite vakante në diocezet kryesore shqiptare) 15.

Për të nxitur reformën kishtare në Shqipëri sipas vendimeve të Koncilit te Trentas, ai caktoi si vizitor apostolik në të gjitha diocezat e Shqipërisë me 8 qershor 1702 ipeshkvin Vincens Zmajevic. Ky i fundit, nga vendlindja e tij e informonte se: "… Në Kurbin: Gjendet kisha abaciale e Shen Prendes, katedralja e ipeshkvit të Durrësit, me tri piktura të Shen Marisë, njëra e madhe e punuar nga Monsinjor Skura me portretin e tij dhe dy të vogla vendosur me shije mes disa pikturave të tjera. Në këtë kishë është froni i arqipeshkvit, dy kryqe arqipeshkvnore argjendi të gjata tri pëllëmbë të dala në reliev mbi dru, një ostëmbajtëse, një kambane 400 libresh") 16. Më tej vijon lista e priftërinjve qe shërbenin atë kohë në Diocenzin e Durrësit. Ja disa prej tyre: Arqipeshkv i Durrësit ishte Monsinjor Pjeter Zymbi, D. Martin Bushalla, vicar i përgjithshëm është mësues shkolle, D. Primo Prodani, D. Primo Shkjezi në Kurbin, D. Llesh Perlati në Skuraj, D. Lazër Dajçi në Selitë, D. Llesh Ceza në Zhejë etj. Është interesant fakti se në këtë listë meshtaresh ka edhe mësues, qe me sa duket jepnin mësim në shkollën e Shenpremtes në Kurbin. Pikërisht në këtë dokument flitet edhe për shkollën e Kurbinit, për të cilën interesohet drejtpërdrejt edhe Papa Clementi XI. Në relacionin e Zmajevikut drejtuar Papës thuhet: "Është për t'u numëruar edhe ndërtimi i shkollës në Kishën e Kurbinit me përgatitje mjeshtërish për çdo vjet, pra ata xhakonë të rriten në rrugën e Tënzotit e të mësojnë letrat, shkrim dhe lexim shqip." Ky relacion e njohu Papa Klementin XI me gjendjen dhe e detyroi të merrte masa urgjente në përmirësimin e gjendjes. Nisma e parë ishte vendimi për mbledhjen e Kuvendit të Arbrit mbajtur në Merqi të Lezhës në vitin 1703. Këto dokumente autentike dëshmojnë se arsimi shqip ka lindur në Kurbin, në shkollën e Shënpremtes rreth tre shekuj më pare dhe jo me 7 mars 1887, siç dëshmohej në periudhën e sundimit komunist.

Shqipëria në atë periudhe vuante nën thundrën e sundimit osman. E harruar dhe e braktisur nga Europa që dikur e shihte me zili për luftërat qe pati bërë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, qe luftoi për 25 vjet rresht për mbrojtjen e krishterimit dhe qytetërimit europian, kishte ardhur momenti qe të dilte ne drite lufta dhe përpjekjet e saj për ekzistencë. Pikërisht në këto momente të errëta ndriti për popullin shqiptar një rreze shprese. Biri i saj i shquar Gjon Francesk Albani tre vjet pasi u zgjodh papë, urdhëroi qe të mblidhej Koncili i Dheut të Arbrit. Ky Koncil u mbajt në Mërqi të Lezhës në vitin 1703 në kishën e Shen Gjonit nën drejtimin e arqipeshkvit të Tivarit Vinko Zmajevic. Ky Koncil u mor me problemet kyçe të jetës së krishtere. E ndër ta, padyshim është problemi i apostoezise së madhe të popullit shqiptar, përkatësisht të kalimit të tij në islamizëm)17. Shenjat e ringjalljes e të shpresës i pasqyron në letrën e tij vetë arqipeshkvi i Tivarit qe me 10 korrik 1703 ia dërgon Papës Klementi XI, ku thuhet: "… Ti më urdhnove o i shenjti Papë me i shkue e me i vu oroe porsi si vizitor apostolik kishat e Shqipërisë, sheut t'em. E une urdhnit tan i ndigjova, dheut iu solla rreth e rreth, gjithë mbarë kërkova e pashë nevojat e Shqipërisë. Pashë shumë mjerime…Nën hijen tende, o Atë i Shenjtë dheu i Shqipërisë po gazmohet e pas shumë vjetësh po merr frymë e po çile sytë. Kjo Shqipni qe deri tash ka ndejë si e harrueme, mbulue e vorfnue prej mjegullës, nën nji Papë shqiptar po del në dritë e mezi prêt me fitue emnin dhe lumninë. Me kaq unë me të tjerët vllaznit e mi e me gjithë popullin e Shqipërisë, bashkërisht i lutna Zotit qe ty Pape shqiptar me të rujte për të gjatë mot e jetë e me shëndet, për të mirë të kishës e për fatin tonë. Arqipeshkvi i Tivarit Vincens Zmajeviku" 18.

Ishte hera e parë qe Papa po njihte gjendjen reale ekonomike dhe shpirtërore të popullit shqiptar. Gjendja ishte e rendë, prandaj Papa Klementi XI u trondit shumë. Nuk mjaftonte gjendja e rendë ekonomike por tani ishte shtuar edhe presioni i autoriteteve turke për konvertimin e popullsisë, nga katolikë në myslimanë. Për këtë arsye Papa lëshoi disa urdhra, të cilët kishin qëllim forcimin e unitetit të popullit rreth kishës katolike. Në një prej tyre ai theksonte: "Mos braktisni vëllezërit tuaj qe u kthyen në myslimanë. Zoti është nji edhe në qiellin shqiptar është vetëm nji Zot, i cili do t'u mëshiroje duke u futur në mbretërinë e tij Qiellore… ") 19.

Përpjekjet e tij për përhapjen dhe mësimin e gjuhës shqipe në atdheun e tij janë të hershme. Pas kërkesës së Françeskaneve në Shqipëri dhe të arqipeshkvit të Tivarit, Vicko Zmajeviq, me urdhër të Papa Klementit XI, qe nga prilli i vitit 1711 deri në fund të shek. XIX u mësua gjuha shqipe)20. Gjate gjithë periudhës kur sundoi në Selinë e Shenjtë, ai u interesua për zhvillimin e kulturës shqiptare. Posti papnor, ndikoi qe edhe në mjedise të tjera letrare dhe shkencore të zgjohej interesimi për gjuhën shqipe. Ai mbështeti fuqimisht botimin e veprës së albanologut Luibnici, ku shfaqeshin pikëpamjet mbi origjinën ilire të shqiptarëve, botuar me 1709. Me guxim dhe vendosmëri hapi një seminar arbëresh në Palermo duke i dhënë një hov të paparë lëvizjes së gjerë patriotike dhe kulturore, dhe me 20 prill 1711, me iniciativën e tij, hapet e para katedër e gjuhës shqipe ne Universitetin e kryeqendrës së Perandorisë Romane, në Romën e Qytetëruar, që do të ndikonte në zhvillimin e albanologjisë në Europë.

Në vitin 1711 Papa Klementi XI ndërhyn pranë Republikës së Venedikut për t'i ndihmuar shqiptarët në luftë. Këtë thirrje ia bëri gjithë Europës, por Europa përsëri qëndroi indiferente ndaj çështjes shqiptare. Vlen të përmendet këtu miqësia e ngushtë që pati Papa Klementi XI me

Gjergj Guxetën (1682-1756), themelues i Seminarit papnor të Palermos. Ky seminar arbëresh që u hap me 30. 11. 1730, do të luante një rol të madh në përhapjen e kulturës shqiptare tek arbëreshët dhe arsimin e shumë intelektualëve të shquar arbëreshe si Pjetër Andrea, P. Parina, Nikoll Keta) 21 etj. Nikollë Keta thotë se Gjergj Guxeta i kushtoi Papës Klementi disa sonete ku tregoi lidhjet e ngushta miqësore mes tyre. Dallohet, veçanërisht, një poezi e tij që ka rreth 56 vargje njëmbëdhjetërrokëshe me rimë të alternuar, ku thuhet: "…Gjergji i dashur është dhe i denjë i Klementit, /Yt vëlla, sikur Serafinin i vdekur, /S'është e vërtetë jo, s'vdes heroi i fjalës, /Jeton shpirti i madh i tij mbi qiellin e lartë, /Edhe emri i tij jeton më amshim, në botë…") 22.

Në korrespondencën e Gjon Francesk Albanit ruhen dy letra që shprehin pikëpamjet dhe qëndrimin e tij kundër Jonsemizmit. Ai ndërtoi shumë shkolla edukimi dhe jetimore për t'u ardhur në ndihmë shtresave të varfra. Me emrin e tij lidhet ndërtimi dhe funksionimi i spitaleve të para publike. Pasuroi shumë bibliotekën e Vatikanit dhe restauroi shumë statuja dhe obeliske. Bibliotekën e tij shumë të pasur ua la nipave të tij kardinalë dhe intelektualë të zotë dhe bashkë me të edhe një apigram që është shkruar në bazilikën e kishës së Shën Pjetrit, në të cilën thuhej: "Klementi XI-Albani, Papë, më pare vicar, e pastaj kanonik i kësaj bazilike, vdiq pas një pontifikati… Lutuni për të") 23. Vdiq me 19 mars 1721 ditën e Shën Jozefit, pajtorit të të vdekurve. Në dhomën e tij u gjetën vetëm 60 skude, bashkë me një listë me emrat e 600 familjeve, shumica me origjinë arbëreshë që jetonin me lëmoshat e Selisë së Shenjtë)24.

Vdekja e tij nuk bëri jehonë të madhe, pasi kronikat dhe historia nuk na japin informacionin e duhur. Pati dëshiruar të varrosej me një ceremoni të thjeshtë dhe ashtu u bë. Eshtrat e tij u varrosën në dyshemenë e korit të Bazilikës së Shën Pjetrit ku prehen edhe sot pas 286 vjetësh, mbuluar nga një pllakë e thjeshtë mermeri ku është skalitur me germa ari emri i këtij kurbinasi të ndritur. Veprimtaria e Klementit XI për çështjen kombëtare, shqiptare ishte aq e madhe sa edhe emri i tij Albani që mbi të gjitha ishte një emër krenarie për të qenit shqiptar. Ky Papë me personalitetin e tij të spikatur ndikoi fuqimisht në zhvillimin kulturor dhe fetar të arbëreshëve dhe për këtë ai duhet të vlerësohet nga historiografia shqiptare. Duhet ditur se nën kujdesin e tij janë thirrur 15 koncile, janë gjetur 1412 letra, 28 ligjërata, 2 biseda me rëndësi të veçantë dhe shumë materiale të tjera të rëndësishme. Prandaj studiuesi Engjëll Sedaj mendon se "pavdekësia e këtij Papë qëndron në aktivitetin e tij të vazhdueshëm kundër turqve dhe mbrojtjen e krishterimit") 25.

Gjatë ushtrimit të detyrës së Atit të Shenjtë ai u përball me shumë sfida. E përjetoi me hidhërim nënshkrimin e traktatit të Utrehtit me 2 prill 1713, por edhe atë të 6 marsit 1714)24. Kjo i dha mundësi të punonte për rritjen e autoriteteve dhe famës brenda vendit. Themeloi një akademi pikture, nxiti zbulimet arkeologjike me qëllim zbulimin e rrënjëve të lashtësisë dhe pasuroi bibliotekën e Vatikanit. Obelisku në sheshin e Panteonit është vepër e Papa Klementit të XI, ashtu si dhe porti i Ripetës mbi Tibër, i cili u shkatërrua në vitin 700, ku u ndërtua ura Covour, Universiteti i Urbinas ku u shkollua ky Papë pati prioritet e kujdesit të tij të vazhdueshëm. Vdekja e tij nuk bëri jehonë të madhe, pasi kronikat dhe historia nuk na japin informacionin e duhur. Pati dëshiruar të varrosej me një ceremoni të thjeshtë dhe ashtu u bë. Eshtrat e tij u varrosën në dyshemenë e korit të Bazilikës së Shën Pjetrit ku prehen edhe sot pas 286 vjetësh, mbuluar nga një pllakë e thjeshtë mermeri ku është skalitur me germa ari emri i këtij kurbinasi të ndritur.

Një nga papët shqiptare, më të rëndësishmit që kanë drejtuar Vatikanit ka qenë edhe Papa Eleuteri. Në listën e gjatë të papëve në bazilikën e Shën Pjetrit në Vatikan ai është i 13-ti. Ka drejtuar Selinë e Shenjtë rreth 15 vjet rresht nga viti 174 deri në 189. Ai ka lindur në Pervezë të Nikopojës, por në 169 u vendos në Romë pranë papës Antiket. E udhëhoqi Vatikanin në një periudhe të vështirë historike atëherë kur Roma udhëhiqej nga perandori Mark Aureli. Ai e kreu me përkushtim detyrën duke shuguruar me urdhrin e shenjtë edhe 12 meshtarë, 8 dhjakë dhe 15 peshkopë. Papa Eleuteri punoi me përkushtim për përhapjen e krishterimit dhe forcimin e traditave apostolike. Një portret i tij është punuar me kujdes dhe mjeshtëri nga piktori i madh Mikelanxhelo, një vepër e jashtëzakonshme në llojin e vet.

Sipas enciklopedisë italiane në historinë e papëve të Vatikanit, kanë qenë plot shtatë papë me origjinë ilire dhe shqiptare. Këta janë Shën Eleuteri, Shën Urbani I, Shën Kai, Shën Pali IV, Papa Gjoni IV, Papa Sisti V dhe Papa Klementi XI. Shën Eleuteri papë ishte me origjinë prej Nikopolit të Epirit – Preveza, në jug të Çamërisë, i cili është shpallur martir. Eleuteri e mbajti fronin papnor në vitit 171-185. Festa e tij është me 26 maj. Renditet i katërmbëdhjeti në listën e papëve. Është biri i Abondit të Nikopolit. Një nga papët shqiptarë, më të rëndësishmit që kanë drejtuar Vatikanit ka qenë edhe Papa Eleuteri. Ka drejtuar Selinë e Shenjtë rreth 15 vjet rresht. nga viti 174 deri në 189. Në vitin 169 u vendos në Romë pranë papës Antiket. E udhëhoqi Vatikanin në një periudhë të vështirë historike atëherë kur Roma udhëhiqej nga perandori Mark Aureli. Ai e kreu me përkushtim detyrën duke shuguruar me urdhrin e shenjtë edhe 12 meshtarë, 8 dhjakë dhe 15 peshkopë. Papa Eleuteri punoi me përkushtim për përhapjen e krishterimit dhe forcimin e traditave apostolike. Një portret i tij është punuar me kujdes dhe mjeshtëri nga piktori i madh Mikelanxhelo dhe sot gjendet në katedralen e San Pietros në Vatikan, një vepër e jashtëzakonshme në llojin e vet.

Shën Urbani I, papë ishte me origjinë prej Ilirisë, edhe ky i shpallur martir. Urbani e mbajti fronin papnor në vitet 222-230. Festa e tij është me 25 maj. Rënditet i tetëmbëdhjeti në listën e papëve. Shën Kai papë ishte me origjinë ilire, prej salone në Dalmaci, edhe ky i shpallur martir. Kai e mbajti fronin papnor në vitet 283-296. Festa e tij është me 22 prill. Renditet i njëzetenënti në listën e papëve. Papa Pali IV – Karafa me origjinë shqiptare e mbajti fronin papnor në vitet 1555-1559. Renditet i dyqind e njëzetë e pesti në listën e papëve. Gjatë kohës së tij, me 1555 botohet në gjuhën shqipe "Meshari" prej klerikut shqiptar, Gjon Buzuku. Sot një fshat arbëresh i Kalabrisë – Katanzaro, mban emrin Karafa. Ndërsa Papa Gjoni IV-Dalmati, me origjinë prej Ilirisë, e ka mbajtur fronin papnor në vitet 640-642. Papa Gjoni renditet i shtatëdhjetë e katërti në listën e papëve) 26.

Stema e Papës Klementi XI

Nga emrat e tjerë që dolën nga familja Albani dhe që lanë gjurmë në histori janë edhe Giovanni Girdoma (1509-1591), kardinal dhe kaut, Orozia (1576-1653) diplomat dhe senator i Romës, Anibali (1682-1751) President i dhomës Apostolike Alessandro (1692-1779) kardinal, sekretar i Memorialëve, ndërtues i Villa Albanot, Gion Francesko (1720-1803) kardinal, peshkop i Sabinës dhe më pas i Ostias. Mendohet se familja e madhe Albani u shua në vitin 1852 dhe i fundmi i kësaj familje që Filipi. Këto figura të shquara kanë ngritur lart lavdinë e vendit të tyre.

LITERATURË:

1- Z. Mirdita: "Krishtenizmi ndër shqiptar", Zagreb 1998/294

2-P. Vincens Malaj: "Kuvendi i Arbrit-1703", Prishtinë 1998 /41

3-G. Armilota: "L'Oseavatore Romano", Romë nr. 139 dt. 20. 06. 2001

4-P. Vincens Malaj: "Kuvendi i Arbrit-1703", Prishtinë 1998/42

5 –L. Pervizi : « Revista Kuq e Zi » Bruksel » nr 27, 2002.

6.- L. Pervizi : « Kurbini », Bruksel : 2002.

RILINDAS

NUM VEQILHARXHI

ZENEL GJOLEKA



JERONIM DE RADA



FILIP SHIROKA

ELENA GJIKA

PASHKO VASA



GJERGJ FISHTA



NDRE MJEDA

NAIM FRASHERI

S AMI FRASHERI

ABDUL FRASHERI



SHTEFEN GJE.ÇOVI

Bashkë me plot te tjerë patriotë e luftëtarë nga të gjithë trojet shqiptare.

Nder e lavdi atyne qe nuk kursyen asgja për Lirinë e Pavarësinë e Atdheut

5-D. Luka:Revista "Studime historike" nr. 1/1977 fq. 158
6-P. Vincens Malaj: "Kuvendi i Arbrit-1703", Prishtinë 1998/41
7-F. Gushta: "Kumona e së diellës" nr. 5/1992, fq. 20
8-Pasho Baku: "Fjalori enciklopedik", Tiranë 2002/371
9-Adrian Beshaj: Gazeta "Shqip", dt. 15. 08. 2006/fq. 18
10-Z. Mirdita: "Krishtënizmi ndër shqiptarë", Zagreb 1998/294
11-Z. Mirdita: "Krishtënizmi ndër shqiptarë", Zagreb, 1989/204
12-V. Zmajevik: Letër drejtuar G. Patër, Venedik 27 12 17002
13-Altin Keka: "Gazeta shqiptare"-reportazh, nr. 20/fq 2
14-Z. Mirdita: "Krishtënizmi ndër shqiptar", Zagreb 1998/189
15-P. Vincens Malaj: "Kuvendi i Arbrit-1703", Prishtinë 1998/82
16-F. Gushta: "Kumona e së diellës", Shkodër nr. 5/1992, fq. 20
17-F. Gushta: "Kumona e së diellës", Shkodër nr. 5/1992, fq. 20
19-Namik Resuli: Revista "Shejzat", nr. 12/1970, fq. 317
20-E. Sedaj: "Baba i skamnorëve…", Rilindja dt. 10. 04. 1995/9
21-E. Sedaj: "Baba i skamnorëve…", Rilindja dt. 10. 04. 1995/9
22-E. Sedaj: "Baba i skamnorëve…", Rilindja dt. 10. 04. 1995/9
23-F. Gushta: Kumona e së diellës", Shkodër nr. 5/1992, fq. 21
24-E. Sedaj: "Baba i skamnorëve…", Rilindja dt. 10. 04. 1995, fq. 9
25-Gazeta "Tirana Observer", e premte dt. 27 mars 2009, fq. 30
26-Gazeta "Telegraf", Tiranë, e hënë, dt. 18 janar 2010 fq. 12-13

100 VJET PAVARESI-PËRKUJTOHET FIGURA E RIZBULUESIT TE FLAMURIT, FAIK KONICËS NË BRUKSEL

November 4th, 2012

nga Agron Shele

"...më 7 të Prillit 1939, Flamuri ynëu çduk në gjak; edhe në qoftë se duket,duket i lidhur me litarin e robërisë. Por vazhdon së valuari lirisht në zemër të çdo Shqipëtari që ka sedrë, nder dhe kuptim. Edhe ka për të valuar sa kohë që të mbetet në faqe të dheut një shqipëtar i vërtetë."

Faik KONICA

Vendosja e pllakës në shtëpinë ku ka jetuar e punuar Faik Konica më 1897-1903, Rue **d'Albanie, në Saint Gilles, Bruksel.**

Në kuadrin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Shqipërisë, jeta social-kulturore e komunitetit shqiptar këtu në Bruksel është përfshirë nga një sërë aktivitetesh dhe eventesh të ndryshme, si :restaurimi bustit të Skënderbeut , takimet simbolike në Parlamentin Evropian, vendosja e pllakës përkujtimore të martirit dhe heroit Enver Hadri,i cili ishte themeluesit i së parës shoqtatë për të drejtat e njeriut, të drejta që sensibilizuan Komunitetin Evropian dhe atë Ndërkombëtar për dhunën dhe represionin serb në Kosovë, , takime të ndryshme me tematikë historike dhe letrare si dhe botimi antologjisë poetike në gjuhën frënge me rreth 80 autorë shqiptarë nga mbarë trevat shqiptare.. Nën këtë nismë "Shoqata Kulturore Konica", në bashkëpunim me Shoqatën e Shkrimtarëve Shqiptarë në Belgjikë , në 27 Tetor 2012, organizuan një tjetër event të rëndësishëm, sikurse ishte vendosja dhe inagurimi i pllakës përkujtimore të personalitetit te madh kombëtar Faik Konica, në ish shtëpinë ku kishte jetuar, punuar dhe botuar gazetën "Albania", si dhe orën letrare me të ftaurin special nga Uashigtoni Z. Ilir Ikonomi, autorin e librit "Faik Konica, Jeta në Uashington". aktivitetit do të niste në rrugën "Rue d' Albania, rrugë në të cilën kishte jetuar Faik Konica , ku të gjithë pjesmarrësit dhe të ftuarit do priteshin sipas traditës shqiptare nga Znj Hadri, bashkëshorte e martirit Enver Hadri, dhe poseduesja e kësaj prone sot.

Ngrohtësia e krijuar nga kjo familje tipike shqiptare, si dhe përfaqësimi pjesmarrësve nga gjithë trevat shqiptare do krijonte një sferë shumë të këndshme dhe shembull për tu ndjekur nga komunitetet e tjera shqiptare në vende të ndryshme të botës.Në këtë takim nderonin me pjesmarrjen e tyre ambasadori i Shqipërisë Z.Ilir Tepelena, ambasadori i Kosovës Ilir Dygolli ,përfaqësuesi ambasadës së Maqedonisë Daim Iliazi dhe përfaqësuesit shqiptarë pranë NATO-s .Z. Lek Pervizi, Kryetar i Shqqatës Perndjekurve Politikë Shqipëtar-Belgjikë, Z. Myrteza Bajraktari N/Kryedtar, Vendosja e pllakës përkujtimore ishte nismë e drejtëpërdrejtë e komunitëtit shqiptar, e Shoqatës "Konica" dhe mbështetje e komunës Sint-Gilles, në Bruksel. Fjalën e hapjes në cermoninë e inagurmit të pllakës përkujtimore e bëri Kryetari Shoqatës Kulturore "Konica" i cili foli për kontributin e Konicës në Bruksel, mesazhin e madh dhe rolin e Gazetës Albania në komunitet dhe më gjerë, si dhe potencialin e tij intelektual, potencial që u vu në shërbim të interesave të mëdha kombëtare. Ambasadori i Shqipërisë z Tepelena do përshendeste të pranishmit, do falenderonte inisiatorët, si dhe do ndalej në modelin e krijuar nga ky personalitet në fushën e diplomacisë. Më pas përshëndetën dhe ambasadorët e tjerë dhe së fundi fjalën përmbyllëse e mbajti historiani, poeti, përkthyesi dhe piktori Lek Pervizi. Përfaqësuesja e Shoqatës Kulturore "Konica" znj Alisa Aliu dhe ambasadori shqiptar Z Ilir Tepelena zbuluan pllakën përkujtimore mes duartrokitjesh dhe një sfere shumë të gëzushme për gjithë pjesmarrësit, duke e berë rrugën Albania më Shqiptare, më të plotësuar dhe më emblematike.

Përurohet libri i Ilir Ikonomit:

"Faik Konica, jeta në Uashington"

Pas cermonisë së inagurimit të pllakës përkujtimore, pjesmarrësit u drejtuan për në sallën e Shërbimit Social të Hebrenjve, sallë ku zhvillohet shumica e aktiviteteve shqiptare dhe



NJë libër me vlerë qe tregon jetën e veprimtarinë e Faik Konicës në Washinkton., shkruar nga Z. Ilir Ikonomi, gazetar i Zeri të Amerikës nga 1992, 20 vjet.

kjo jo rastësisht, por me domethënie të plotë për miqësisë dhe mirënjohjen e madhe që ka populli izraelit për mbrojtjen dhe ndihmën që ju afroi Shqipëria dhe shqiptarët gjatë viteve më të vështira të mbijetesës dhe egzistencës së tyre në Luftën e Dytë Botërore.

Për auditorin u zhvillua një bisedë e hapur me autorin e librit "Faik Konica, jeta në Uashington", z. Ilir Ikonomi i cili kishte ardhur posaçërisht për këtë event përkujtimor nga Uashingtoni. Monitorimin e kësaj bisede mbi përmbajtjen dhe faktet historike të librit e animoi znj.Shqiponja Duro, koordinatore e Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptarë në Belgjikë. Biseda e hapur u ndal në rolin e Konicës si diplomat, marëdhëniet e tij me ish-Qeverinë e Zogut, replikat e tij me Fan Nolin, aspekte të krijimtarisë së tij eseiste, letrare…si dhe u cekën disa elemente nga karakteri i tij dhe jeta e tij private. Z. Ikonomi u ndal në faktin se Konica kishte armën më të fortë në atë kontekst kohor: erudicionin, ironinë, sarkazmën dhe humorin. Fakti që Konica, qysh djaloshar 20-vjeçar çeli gazetën Albania në Bruksel; dëshmojnë për formimin e tij të hershëm.

Në Uashington ai mbrriti me misionin e njohjes së vendit të vogël që ai përfaqësonte dhe këtë mision e kreu me sukses edhe mbasi ish-Qeveria e Zogut u rrëzua mbas pushtimit të vendit nga Italia (1939). Konica ishte në atë kohë-shton autori i librit- diplomati më i përgatitur se gjithë diplomatët e tjerë të botës. Kjo mund të ilustrohet edhe me marrjen e çmimit të Konicës "kapelja e lartë" nga revista më elitare në Uashington "Gjykatësi".Përsa i përket replikave të tij me Nolin; ato kishin karakter konkurues, por në fund, në emër të idealit të përbashkët, ata pajtohen dhe se bashku takohen për herë të fundit në pallatin e vogël të Konicës (mbas pushtimit të vendit Konica nuk pranoi të përfaqësojë Qeverinë e pushtuesëve Italianë në Tiranë, dhe humbi kështu akreditimin si diplomat). Për auditorin, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, znj. Duro recitoi vargjet e Konicës për flamurin shqiptar:

KUSH KISHTE MA SHUMË VLERË PER LIRINË E ATDHEUN, "BESË–LIDHJA E MALËSISË..." APO "LUFTA NAC.–ÇL." ?

Në 100 vjetorin e Pavarsisë…

Kapiten Gjelosh Luli (1908 – 1946)
Foto Marubi, Shkoder 1941.

Kur "historianët" do të shkruejnë të vërtetën, që Rinia Shqiptare me e mësue "até"?!

Sa do të më pelqente sikur "prof. dr. e akademikët" me e dijtë këte emen, kush ishte kjo **"Besë – Lidhja e Malësisë së Madhe, Rranxave dhe Postribës"**, kush e krijoi dhe pse u krijue, apo cili ishte qellimi i Saj Atdhetar?! Nuk dij a e kanë lexue ndonjëherë Programin e Saj!!

Prej vitit 1941 krahinat Veri – Perëndimore të Shkodres, tue fillue prej Ulqinit, Tivarit, Hotit dhe Grudës, ishin të lira nga jugosllavët dhe malazezët, mbas sa luftave per Lirinë e Tyne, dhe shpejt ishte e lirë edhe Kosova e Maqedonia, deri poshtë ku kishin hy forcat gjermane, që kërkonin shkëputjen e Trojeve Shqiptare nga zgjedha sllave. Menjëherë ndër ato krahina u hapen 120 shkollat shqipe me 250 mësues nga ministri Ernest Koliqi dhe qeverisjet lokale të tyne ishin nga Shqiptarët, të cilët filluen edhe organizimin e policisë dhe administrimin e vendit.

Kur ushtria naziste filloi terheqjen nga Ballkani me humbjen e luftës, ndihej nevoja e organizimit ushtarak ndër ato krahina për me mujtë me sigurue "Lirinë" e Tyne, e cila jo vetem do të rrezikohej, por pritej edhe përdhosja e Tyne nga forcat komuniste jugosllave të Titos, i cili kërkonte edhe njëherë aneksimin e tyne në vathen e vjetër sllave, por këte herë i ndihmuem nga forcat ushtarake sovjetike dhe nga komunistët shqiptarë, që ndihmoheshin materialisht nga forcat ushtarake të Aleatëve. Nga fundi i vitit 1943 forcat nacionaliste shqiptare "Balli Kombëtar", "Legaliteti" dhe Indipendentët, luftoheshin haptas nga forcat komuniste "partizane" të drejtueme prej agjentëve jugosllavë, që kryesoheshin gjoja nga Enver Hoxha, që tashti kishte shpalosë haptas flamurin e tradhëtisë, me luften civile në Shqipninë e Jugut...dhe pritej që Shqipnia Europjane t' ishte tansisht nën pushtimin bolshevik komunist të Titos. Me këte vepër tradhëtije pajtohej edhe blloku i Aleatëve, nen parullen e "Konfederatës Jugosllave"; i cili ndihmonte me të gjitha mjetet financiare dhe materiale "nacional – çlirimtarët" e bllokut komunist të Stalinit.

Me daten 23 Shtator 1943, kapiten Gjelosh Luli, major Mul Bajraktari, major Dodë Nikolla (Ivezaj), kapiten Llesh Marashi, të mbledhun per me shpëtue Atdheun nga një robni e ré që po kercnonte krahinat e Shqipnisë së Veriut të porsalirueme nga sllavët dhe italianët, që po administroheshin nga Shqiptarët, kur gjermanët ishin në terheqje, Këta Burra, në një mirëkuptim të plotë edhe me Krenët e vendit, të gjithë bashkë, formuene **"Besë – Lidhjen e Malësisë së Madhe, Rranxave dhe Postribës",** e cila kishte si pikësynim kryesor: 1. Mbrojtja e Kufijëve të sotëm të Shtetit Shqiptar...2. Qetësia e mbrendëshme në **krahinat Shqiptare…dhe një Program të** plotë, që perputhej me interesat kombtare të Lirisë, Pavarsisë dhe të zhvillimit e përparimit të Tyne me kahun e pikpamjet Europjane – Perëndimore.

Të nisun edhe nga sakrificat e Familjes së Atdhetarit Dedë Gjo' Lulit në vitin 1911, trashigimtarit të Gjakut të Tij, po edhe pasues i divoçem per nga Atdhetaria, kapiten Gjelosh Lulit nga të gjithë drejtuesit iu besue drejtimi dhe organizimi i mandejshem i Saj.

Të parët që miratuen dhe u bashkuen me këte "Besë – Lidhje të Veriut" ishin Krenët e Hotit, Grudës, Kelmendit, Kastratit, Shkrelit, Triepshit, Koçës, Fundës (Luare – Ledhe) , Reçit, Lohes, Rrjollit, Koplikut, Buzë-Ujit dhe Postribës. Shumë shpejtë me ta u lidh edhe koloneli Atdhetar i Dibres Muharrem Bajraktari. Me daten 19 Dhjetor 1944, drejtuesit e Besë – Lidhjes i drejtojnë një kerkesë edhe anglezit, kolonelit Nill (Neell), që ndodhej në Veri...i cili "premton po nuk mban asnjë nga ata që premtoi." (Dosja 1883, Arkivi Min. Mbrendshme Tiranë, 1998).

Të parët që iu përgjegjen Lidhjes ishin grupi i ushtarakëve ndër shpellat e Shllakut, që kryesohej nga kapiten Gjergj Vata (Cukali), Martin Sheldija, Zef Agostini, Kolë Ashiku, Zef

Jakoviq, Loro Vata dhe ma vonë, organizatori i Rinisë Katolike Shkodrane, Ndoc Jakova.

U gjet perkrahja e grupit ushtarak të shpellave të Dukagjinit, ku ishin oficerat Gjon Destanisha, Pal Thani, Mark Mala, Nik Sokoli, Ndue Pali, Zef Kol Prela etj.

Në Postribë ishte Jup Kazazi, Abdullah e Nuh Kazazi, që mbeshteteshin tek Parija aty.

Pa kalue as pak muej në perkrahje të "Besë – Lidhjes së Veriut" vihet edhe Puka me të ushtarakët e njohun e trima, Mirakajt, Mirdita me major Markun dhe Lleshin e Zi Markagjoni...

Me kenë se Gjelosh Luli ishte edhe mik i At Mati Prennushit, provinçialit Françeskan të Shqipnisë, i cili kishte lëshue një urdhen të premë mbas vrasjes së At Lekë Lulit, kur bashkpunoi me Legalitetin dhe u vra tradhëtisht, Ai urdhnoi që "asnjë Klerik Katolik nuk duhet të perzihet në politikë", në këte "Besë – Lidhje të Veriut" nuk u angazhue asnjë nga Klerikët e këtyne zonave. Por edhe pse Kleri Katolik nuk u perzi fare, Ai u godit ma keq se kushdo, tue fillue nga data 25 Mars 1945 që u pushkatue Don Ndre Zadeja dhe mbas tij, me rradhë dijetarë e Atdhetarë për 47 vjet rresht panderpremje deri tek Don Lazer Sheldija në vitin 1988, që u vra nga sigurimi komunist i yni në Amerikë, vetëm se ishte Bir besnik i Atyne trojeve të Besë – Lidhjes së Veriut.

Kur forcat komuniste të Mehmet Shehut e Koçi Xoxës, e sa e sa "gjeneralëve" halabakë, sulmuen mbas shpine Atdhetarin Prekë Cali, bashkë me forcat jugosllave që kishin pushtue Gruden, me "Besë – Lidhjen e Veriut" u bashkuen edhe çetat e Shqipnisë së mesme me Alush Lushanakun, Mark Zef Palin dhe Gjon Mark Ndojin, të cilët ruenin lidhjet e veta me "Çeten e Hekurt" të Sul Selimes në rrethinat e Tiranës. Rezistenca antikomuniste në Shqipni fillon pa mbarue Lufta e Dytë Botnore. Atdhetarët e vërtetë nuk u pajtuen kurrë me komunizmin gjakatar.

Në Shkoder asht i pari në Europë Mark Çuni, që formon organizaten antikomuniste "Bashkimi Shqiptar", me anen e së ciles kerkoi pluralizmin politik dhe zgjedhje demokratike. Askush nuk mund të harrojë qëndresën heroike shqiptare të Pjetër Dedës me gruen e tij Maria (Zojzi), të Ludovik Saraçit, të Pashuk e Palë Bibë Mirakajt, të Frano Mirit, të Gjon Dodanit, të Hasan Isufit, të Marash Ndue Mirit, të Pashko Zef Hotit, të Hysen Lepenicës, të Zagoll Shenos, të Sami Lepenicës etj., po gjithmonë tue vue në fletën e parë të këtyne volumeve të qendresës heroike Shqiptarin Gjelosh Lulin e Hotit dhe të Maleve të Veriut, që nuk e bân kurrmâ Nana.

Në vitin 1999, në muejn Tetor, më ka shpjegue zonja e Nderueme Helena Luli (Mirakaj), e shoqja besnike e Gjelosh Lulit, që atë natë kur Gjeloshi do të merrte malet, mbasi u vesh me rrobat ushtarake, vuni nën koletin e xhaketes një Kryq të vogel, dhe mbasi puthi dy vajzat e veta të vogla, Klaren dhe Belen, i kishte kerkue zonjës Helena revolverin që e ruente të mbyllun me çels. Kjo ia kishte sjellë dhe Ai e kishte marrë në dorë, e kishte shikue dhe i kishte thanë: "Mos e thashtë as mos e premtoftë Zoti, që unë me këte armë me rrëzue Landen e Tij!" - dhe e kishte vue në brez, ishte perqafue me Té dhe kishte dalë nga shtëpia për mos me u kthye kurrmâ. Me daten 31 Dhjetor 1946, tek zyret e ndjekjes së Koplikut asht ekspozue vetëm koka e preme e Gjelosh Lulit, për me terrorizue Malet e Veriut dhe krahinat antikomuniste! Pothuej të gjithë Emnat e Atyne Burrave që kam përmendë ma siper janë vra e zhdukë edhe trupat e tyne, kush pa krye, kush pa kambë, kush pa sy e kush pa krahë, perfundimisht gati të gjithë janë "pa Varr"!

Po monument per Këta Atdhetarë, viktima të komunizmit a ka sot kund!?..

– Jo, "monumentet" janë per vrasësit e tyne, per kriminelët e dekoruem atëherë e sot!

"Monumentet" janë e do të jenë per "nacional – çlirimtarët" tradhëtarë e kolaboracionistë me bolshevikët sllavo – komunistë të Jugosllavisë së Titos, Rusisë terroriste staliniste dhe Kinës së Mao Ce Dunit...shfarosës e barbar, me etiketen e "Revolucionit"...të cilëve u kanë sherbye dhe vazhdojnë me u sherbye me perkushtim, se i lidhë të gjithë bashkë "ideali antiatdhetar"...

Po "ideali i antarëve të parë të partisë komuniste" cili ishte?

– Sot, dimë vetëm një fakt, se pothuej të gjitha përpjekjet e Shqiptarëve për liri u shtypën me gjak, hekur, torturë, vrasje dhe tradhëti. Koçi Xoxe deklaron: **"Për vrasjet pa** gjyq kam qenë këshilluar dhe janë bërë me urdhër të shokut **komandant."***(Dosja 1623)*. Torturuesit dhe kriminelët Haxhi Lleshi, Zoi Themeli, Vaskë Koleci, Lefter Lakrori, Muço Saliu, Siri Çarçani, Mestan Ujaniku, Nesti Kopali, etj., tregojnë se kur ishin në Shkodër, në janar të 1945, ishte në dijeni edhe Mehmet Shehu dhe Enver Hoxha për operacionin e Veriut, ku pasonin ushtarakët Sheuqet Peçi, Gjin Marku, Rahman Perllaku, Ramiz Alia etj. "...që kishim urdhër me vra dhe me i tretë në proskë njerëzit e dyshimtë dhe Parinë e **vendit...." Ata partizanë që u vranë në** Luften Nacional – Çlirimtare, të gjithë pa **perjashtim, vrritën per një "ideal", per "idealin" komunist: "Bijtë e Stalinit jemi né, rroftë Stalini i math, babai ynë!"...**

E dij se e kanë të veshtirë me arsyetue me trunin e tyne marksist-leninist të mykun nga "historia e PPSh" dhe parimet komuniste "prof. dr. e akademikët" e Tiranës anadollake, por duhet të tregojnë haptas se cilat ishin programet e tradhëtisë prej 8 nandorit 1941, të komunistëve të Tiranës, Permetit, Beratit, e deri tek Ramiz Alia, në 1991, në sherbim të komunizmit gjakatar?

Në 1991 Ramiz Alia thotë: "Edhe gjak do bëjmë..!", ja "ideali" i kriminelit të 1943...!

E verteta historike asht vetem një: Komunistët anadollakë të Shqipnisë për me sigurue një kolltuk, até të Enver Hoxhës, shiten Atdheun, shiten Trojet Shqiptare, vranë e masakruen të gjithë Atdhetarët dhe inteligjencen Europjano Perëndimore, kthyen një Popull në bujkrob per me punue per terroristët e tradhëtarët, vodhen e vorfnuen vendin dhe pushtetin ua dorzuen veglave të tyne besnike, per me ua sigurue edhe mbasardhësëve pushtetin e perjetshëm...antiatdhetar!

Mundohen "disa" me gjetë krraba me varë "programet" e Mukjes apo te Bujanit tash nga pleqnia...e aty nga fundi kujtojnë se u ka ardhë prap koha edhe "këtyne" me u thirrë "pashallarë" ...dhe askush nuk thotë të verteten historike! Mashtrojnë dhe gënjejnë edhe pse janë në gryken e vorrit...E nuk kujtohen se mbi rrasen e "mermerit" të tyne Populli Shqiptar, ka me i daltue se:

"Këtu asht edhe një tradhëtar i Shqipnisë Europjane të Gjergj **Kastriotit!".**

Në 100 vjet histori nga dita e 28 Nëndorit 1912 Shqipëria e Shqiptarët njohën vetem 42 vjet liri, prej ku zbriten Lufta e Parë Botnore (4 vjet, 1914-1918)), pushtimi intalian (4 vjet, 1939-1943), diktatura komuniste, (48 vjet, 1944-1992).

Jozef Radi

Nji Nanë... Njimijë Nana dhe Njiqind vitet e Shtetit Shqiptar...

Nji Kangë që duhet me e këndue të gjithë bashkë.

Nënë Sava, 1912-2012

Shteti shqiptar ka hy në kapërcyell të shekullit dhe sigurisht nga maja e këtyne njiqind viteve të mbrrituna, ka mundsi me soditë me qetësi, po edhe me krenari e dhimbje jo veç rrugën po krejt përpjekjet e bame, jo veç luftat po edhe heronjtë, jo veç fitimtarët po edhe të mundunit, jo veç arritjet po edhe praghumnerat, jo veç burrshtetasit po edhe diktatorët, jo veç

historigrryesit po edhe dinjitarët, jo veç ata me tituj e grada po edhe ata ma të thjeshtët, që quhen Popull, e që me t'përditshmen e tyne rraskapitëse s'mbrrijnë kurrë me ba as emën dhe as mbiemën të shquem...

Nji shtet njiqind vitesh, simbas mendjes sime, duhej të ishte si nji plak i moçëm e i urtë që mat me kujdes në t'gjitha anët, që i ndigjon vëmendshëm t'gjitha daullet, që s'shkumzon inati si nji adoleshent: "Ku rafsha mos u vrafsha!" dhe që nji pjesë t'mirë të punëve t'veta duhej t'i kishte futë kahera nëpër hullitë e duhuna...

Sikur faji ndër ne t'kërkonte nji emën të vetëm do ta kishim pasë krejt të lehtë me e gjetë atë, por problemi

asht se faji ndër ne edhe për mjaft kohë ka me mbetë

kopil, e

ne të gjithë së bashku në kor kem me gjetë gjithfarë emna fajtorësh, duke harrue se ma e mira do të ishte të merrte gjithkush nga pak faj, me pshtue jo veç nderin tonë edhe të këtij shteti që kurrë s'po mbrrin me u ba si nji plak i urtë e me nda kuvend si burrat...

Nejse, a s'asht ma mirë me e lanë shtetin n'at shejtninë e tij fatlume të shekullorit e ne me iu kthye atyne vogëlsinave të mëdha që po i humbim përditë, dhe që po kujtohemi për to veç kur seleksioni natyral na i shkul dhunshëm ato vlera dhe ata njerëz, për të cilët çdo monument o piedestal sado madhështor do të ndehesh në vështërsi të mëdha përballë veprës hyjnore të atyne ma heroikeve të këtij truelli e të këtyne maleve; të atyne që me dhimbje e me sakrifica të pashkrueshme i dhanë nji emën dhe nji vlerë që s'ka zot me e zhba dhe me e zhbi prej shpirtnave tonë: *Nanat shqiptare*

Në nder të gjithë atyne Nanave të kësaj toke, të gjithë atyne grave që e shtynë dhe ende po e shtyjnë qerren e jetës shqiptare me shpirt nëpër dhambë, kam nji emën të vetëm, nji emën të vetëm Nane që asht sot pothuej motake me shtetin shqiptar, e që jeton për turpin tonë, sot e kësaj dite atje n'ato kampet dikur skëterrë të internimeve dhe me qetsinë olimpike të nji shenjtoreje e stocizmin madhështor të nji heroine, pret paasnji grahmë lëvdate as lavdie, at udhëtimin e gjatë drejt përjetsisë…

E mora këtë guxim sot, sepse nesër ka me qenë vonë, tepër vonë e ndoshta flaka e atij kandili n'shpirtin e saj do t'jetë shue; sepse s'asht njerzore me këndue nji requiem të dhimbshëm kur mundemi me këndue nji simfoni! Po, po, nji simfoni heroike shqiptare, pa shumë zulme e hove, pa shumë lajle e ojna, thjesht me e thanë me gjithë shpirt emnin e saj: *Vojsava Zguri - Kuqeshi*, për të gjithë ne që e njohin prej vitesh thjesht: *Nënë Sava*! Ose le të shtrembnohet paksa emni i saj dhe të bahet si nji flamur i rreckosun vuejteve pafund: *Nënë Savra!*

Nënë Sava, mbrriti në kampin e Savrës aty nga fundi i viteve pesëdhjetë, me të shtatë fëmijët e saj pesë djem e dy vajza. I kishin përzënë prej Leskoviku dhe i hodhën nji mbramje si kafshë aty midis barakave prej pupuliti. Grueja, fëmijën e fundit e kishte n'gji dhe të madhin posa i kish kalue të njizetat. Ajo, s'la asnji nga fëmijtë me qa, po i mblodhi të shtatë ashtu kokë më kokë, i dha secilit detyrën dhe u nis e vetme pa burrë, në at kalvar pafund, që për dreq vazhdon ndaj saj edhe sot e kësaj dite... Pesë djemtë e saj e morën baltën e Myzeqesë si të ishin eskavatore, dhe ajo që ishte e frikshme për shumë nga bashkvuajtësit, për djemtë e saj dukesh si nji lodër. A asht ndokush që e ka harrue Thanasin, Evgjeninë, Petraqin, Polikronin, Sofon dhe të tjerët... S'ma merr mendja!

Po gjithkund ishte ajo Nënë Sava. E veshur krejt në të zeza si kallogre... po që dinte edhe të qeshte... po ama fjala e saj, thirrja e saj ishte ligj... e vendimi i saj ndoshta ishte edhe ma i rreptë se vetë ligjet e diktaturës... e ndoshta ajo, diktatura që s'kishte frikë askënd në botë, duhet të ketë pasë frikë prej nji grueje, prej nji Nane, prej nji Heroinë që pa frikë ia kalonte çdo burri: *Nënë Sava...*

Dhe i martoi ajo grue vit mbas viti djemtë dhe vajzat; dhe i priti ajo grue vit mbas viti nipat e mbesat dhe u mplak ajo zonjë vit mbas viti, dhe ashtu në at vetminë e saj të zezë dhe solemne prej patriarku, s'guxonin nuse as djalë, vajzë as dhënder, nip as mbesë të vinte në diskutim fjalën e saj...

Kjo asht ajo *Nënë Sava*, që në mars të vitit që vjen, *mbush plot njiqind vite, e bahet motake me Shtetin...*

Gjithë gratë dhe shoqet që ndanin të njejtin fat me të tashma i kanë ikë kësaj bote, po pakkujt i ka ra ndërmend me u kujtue për To, me e ngritë sado pak zanin kundër kësaj padrejtësie që rrin pip në kambë, e s'po na len me pa larg ndër kohna, e me u kujtue se në fund të fundit të gjithë ne jemi vepër e nji *Nane Shqiptare* e nji grueje që e ka trembë rrezikun dhe të keqen me shembullin e saj, jemi të gjithë krijesa të nji *Nënë Save...*

Pse ajo s'ishte e vetme, ajo ishte vetëm nji prej atyne Nanave, emnat e të cilave jam përpjekë me ia grrye kujtesës dhe asaj dashnie që kam ndje për gjithë dhimbjet dhe sakrificat e tyne sublime... Ato i rritën fëmijët e tyne: pa burra, i martuan: pa burra, i rritën nipat e tyne: pa burra, dhe nëse ky vend flet për burra, burra të vërtetë janë vetëm *Nënë Savat* që e ruejtën dinjitetin dhe krenarinë e nji aristokracie shqiptare pa u ba zhele, pa guxue kush me ua shkelë dinjitetin, pa pranue asnji kompromis me të keqen e madhe, duke u dhanë fëmijve të tyne vërtet bukë ma pak, po nji shembull të pashkruem ende... Pati edhe mjaft Nana që i rritën fëmijët e tyne me burra në burg, e ndoqën fatin e tyne me trasta në krahë, i veshën pantallonat e burrave me arrna ndër gjunjë të qepuna me fijet e flokëve të tyne; e hoqën kafshatën e bukës prej goje për burrat dhe fëmijtë e tyne, po gjithsesi hija e burrit ishte gjithkund aty rrotull... ndërsa për *Nënë Savën* dhe simotrat e saj të maposhtme hija e burrit o kaherë ishte tretë nën dhé, o prej kur s'mbahej mend kish marrë rrugët pakthim të ezileve...

Prandaj këtë kangë heroike e këndoj me ju për nji grue të vetme: mbas saj asht nji kor pafund me gra që unë jam mundue me i përmendë emën për emën, plot 53 gra, që kanë mbajtë Gurin e Sizifit në nji kamp të vetëm interrnimi: n'atë të *Savrës!* Po sa mija e mija gra ia vunë shpatullat këtij kombi, atherë kur burrat e vërtetë i përtypte plumbi o kurbeti i detyruem...

Lavdi kësaj Nane Shqiptare, ku ende vezullon nji grimë drite e gjithë Nanave tona të ikuna me shpirt të trishtuem!

Le t'ia nisë kush të mundë këtë emën dhe këtë kangë të shkulun prej së thelli Presidentit të Shtetit Shqiptar, Kryetares së Parlamentit Shqiptar, Kryeministrit Shqiptar, që nesër mos të lodhen me e kujtue mbas vdekjes, po në të gjallë ta nderojnë se e meriton këtë grue për gjithë simotrat e saj! "Nderi i Kombit", pakkush e meriton si Ajo dhe gjithë Ato Nana që ruejtën me dinjitet emnin dhe nderin e krejt atyne familjeve të mëdha të cilave komunizmi u përpoq me iu shkatrrue gjithçka...!

Listë e ndërtueme veç me kujtesë të atyne 53 Nanave që i rritën pa burra fëmijët e tyne në kampin e Savrës...

Vojsava Kuqeshi (nga Leskoviku)
Caje Merlika (nga Kruja)
Velide Çapa (nga Dukati i Vlorës)
Ana Pervizi (nga Skuraj i Kurbinit)
Xhina, Kune e Cube Mirakaj (nga Iballa e Pukës)
Rukije e Sulltana Dine (nga Maqellara e Dibrës)
Mrike e Marta Markagjoni (nga Oroshi i Mirditës)
Vitore Radi (kosovare nga Durresi)
Hajrie Mulleti (nga Tirana)
Vocërr Sherifja (Hoxha) (nga Tropoja)
Kadife Matjani (Matjani i Lushnjes)
Lekani Gjoka (nga Brezhdani i Përmetit)
Gjylije Kolgjini (nga Kukësi)
Hanife e Hava Alla (nga Zgoshti i Librazhdit)
Hazize e Kadife Biçaku (nga Lenia e Librazhdit)
Merushe Plaku (nga Çamëria)
Vasfije e Tefta Dema (nga Homeshi i Dibrës)
Dhemashqini Kokali (nga Aliko e Sarandës)
Hatixhe Çeliku (nga Borja e Kuksit)
Kafile, Hane e Dije Sina (nga Muhurri i Dibrës)
Xhevrije e Xhevahire Spahiu (nga Kolesjani i Kukësit)
Zengjine e Resmie Laholli (nga Vidohova e Korçës)
Sheme e Ziqe Kaloshi (nga Peshkopia)
Tushe e Dije Lamçe (nga Elbasani)
Lefkothe Anastasi (nga Vllaho-Psillotere e Permetit)
Nënat e Kullëve (nga Zemblaku i Devollit)
Mrikë Gjergji (nga Malsia e Madhe)
Nëna e Maçeve (nga Tirana)
Nëna e Kosta Guvellit (nga Dhivri i Sarandës)
Zeqije Agolli (nga Peshkopia)
Vaje Kupi (nga Kruja)
Jorgjica Kënuti (nga Dropulli i Poshtëm)
Bute Berisha (nga Tropoja)
Aishe Neza (nga Tropoja)
Kaliopi Peçi (Leshnicë e Sarandës)
Xhemile Cani (nga Peshkopia)
Ike Tola (nga Peshkopia)
Vezire Taho (nga Starje e Ersekës)
Feruze Brahamaj (nga Greshica - Mallakastër)
Sabrete Asllani (nga Luftinja e Tepelenës)

Ketyne emnave duhen shtue nana të tjera të kampeve të tjerë,që mbushnin Shqipninë fund e krye. Sistemi i përbindshëm komunist nuk ndalej para asnjë krimi, dhe krimi ma I madh ishte denimi familjeve te tana , ku pati fëmijë që nga djepi u rritën e u pmlakën në gjendje internimi, ata që i shpëtuen vdekjës që në to korri me bollek.

NANAVE TRIMNESHA

Moj ju nanat fort trimnesha,
Fort trimnesha dhe krenare,
Ju thrret populli burrnesha,
Përballuet një koh barbare.

T'internueme ju gjith jetën
Me fëmijë t'varun pas gjinit,
Shum prej tyne aty mbetën,
Prej çerberve t'sigurimit.

Sa mallkime keni lshue,
Diktatorit gjakatar,
Që aq rand ju kish denue,
Me ju humbun soj e farë.

Te pamoshtme ju qendruet,
Bijt i rritet me mundime,
Mrekullihst ato i shpëtuet,
Nga ato burgje e internime.

Sot ata me krenari,
Kudo janë juve nderojnë,
Kanë fitue nder e lavdi,
Vepra t'bukura krijojnë.

Emni tyne veç përmendet,
Siç permendej emni i t'parve,
Të nderuem janë ndër vendet,
Krenaria e gjithë shqiptarve.

Mallkue qoftë koha mizore,
Mbush me krime e llahtare,
Që Shqipnin e kthej në vorre,
Bijt e saj i qiti fare !

Ajo koh ka perëndue,
Drejt së ardhmes shkon Shqipnia,
Djemt e juej kan m'e drejtue,
N'vend do t'shkojë historia.

The Dangerous Truth about Communist Crimes It Was a Long Time Ago, and It Never Happened Anyway: Russia and the Communist Past

By David Satter

Yale University Press, New Haven and London, 2012 HC, 383 pages, US$29.95
ISBN: 978-0-300-11145-3
Reviewed by Marek Jan Chodakiewicz
October 24, 2012

In apocryphal 16th century story has Polish diplomats meeting their Russian counterparts about yet another Muscovite invasion. The Poles try to reason with the Russians: "Look, you come every year and we defeat you invariably. Each time you lose at least 10,000 men. What a waste of human lives!" The negotiators respond: "We have a lot of people." Cracow's envoys dealing with Moscow at the time were usually Polish nobles of Ruthenian, Eastern Slav origin and often Chrisitan Orthodox faith. They were virtually cousins of the Muscovite diplomats. However, unlike the latter, they were also Westernized. They valued human life. They understood innate dignity of individuals. Their counterparts did not as they emulated their erstwhile Mongol overlords to subjugate human beings to the needs of the state for the purpose of retaining, increasing, and projecting power. Thus, in the Muscovite system the individual was expendable.

Historians Jan Kucharzewski and Richard Pipes have described this vicious *modus operandi* of the Kremlin throughout Russia's history, including the Soviet times. Now David Satter, in his incisive new book, has demonstrated that the tradition sadly continues in Putin's Russia.

The pattern of disregarding the individual translates into the inability of the Russian Federation to shake off the legacy of the past and to construct a viable *Rechtsstaat* with a robust free market economy. The post-Soviet system is simply post-Communism rather than liberal parliamentarism. The system retains institutions, personnel, and symbols of the USSR. It evolved merely into a soft totalitarian version of its predecessor. It is corrupt and oppressive.

Only a comprehensive dismantling of the totalitarian legacy, physical and spiritual, could result in a free Russia. But to do away with the heritage of collectivistic Communism requires a paradigm shift to Western individualism. The Russians would have to embrace the shocking idea that the state serves the individual and not the other way around. That should be the foundation of a successful transformation of Russia. It has not happened precisely because the post Soviet successor elites refuse to jettison the bad old ways for they alone guarantee their monopoly of power.

The easiest way to commence the dismantling process leading to the reassessment of Russia's priorities would be to examine the past critically. That, in turn, would require coming to grips with the crimes of Communism as they impacted individual human beings. However, the post-Soviet ruling elites are incapable of relating with empathy to human suffering. They continue to think that the horrors of Communism were justified because they resulted in a strong state, which stood the test of history, most notably during the Second World War. For them Russia is the state, and not the people. In this context, human suffering is immaterial. Consequently, for the lack of empathy really, Russia has failed to change.

Instead, Moscow treads a familiar path of glorifying state power through stubbornly pursuing a schizoid historical policy (*istoricheskaia politika*). It is based on brazenly upholding and meshing all features of Russia's past that are congruent with the idea of the supremacy of the state, on the one hand, and on rejecting and vilifying all elements that challenge the statist myth, on the other. Consequently, it consists of a dialectical series of ideological and propaganda contortions forged by the Tsar and tempered by the komissar. For instance, there is an effort to reconcile the Whites and the Reds in Russia's Civil War in a way that suggests that both were right.

The ostensible reason for the Kremlin's historical policy sounds like the U.S. State Department's mantra: stability. The official trope goes as follows: If we open the archives to independent inquiry, it will result in chaos and civil war. The truth about Communist crimes is dangerous because brother murdered brother in Russia. So let's keep everything under wraps. Therefore we must also ignore, discourage, and even persecute, if needs be, grass-roots efforts to commemorate the victims of the Red terror. If there is no other way, let us neutralize them by allowing the Orthodox Church to appropriate and monopolize the commemorations. Thus, despite the fact that they came from all ethnic backgrounds and faiths, henceforth all victims will be considered and perceived as Russian and Orthodox, thus further unifying the state. This also permits them to use the Christian gospel of forgiveness to let the perpetrators off the hook. Commemorating therefore will be collective, anonymous, and harmless to the executioners. The process is foolproof because of the traditional, Byzantine nexus between the Church and State in Russia, including past KGB pedigrees of many an ecclesiast and current chummy personal relations with the FSB.

The Kremlin argues that denigrating Russia's past undercuts the state. Let us be positive. Hence, the best way to commemorate the history of the KGB is to put up the plaque to its erstwhile head, Yuri Andropov, at the Lublianka headquarters of the secret police in Moscow. And let us not forget the great Feliks Dzerzhinski, Russia's leading modern hero (but never mind that he was really a Polish Catholic nobleman Feliks Dzierżyński, hell-bent on destroying the empire of the Tsars). These Chekists must be remembered and eulogized. Meanwhile, there is no mention of the torture and execution of tens of thousands at Lublianka and millions elsewhere in the former USSR. The

"Vepra" e diktaturës komunistz.
Vizatim nga ish i burgosuni Gëzim Çela

Drapni e çekani, simbol i përçudun i krijuem nga nje mendje e përçudun, që i përshtatej një sistemi të përçudun.

victims are either glossed over in silence or sentenced to obscurity as reflected by a handful of understated, even abandoned memorials half-erected in obscure places. Mass graves remain unexplored; their contents consigned to anonymity. Only the perpetrators bask in the Chekist glory. After all, they served the state and only carried out orders, even if mistakes were made.

Moscow's foreign policy also serves this paradigm. Take the most notorious case, the Katyn Forest massacre, for instance. At the end of the 1980s, during perestroika, Mikhail Gorbachev resolved to re-visit the case and admit Soviet guilt to an extent. But he also created a propaganda safety hatch: the story of 40,000 Bolshevik POWs who allegedly died in Polish captivity in 1920. In fact, some Soviet prisoners did die, along with the Polish guards and hundreds of thousands of Polish civilians because of hunger and epidemics, in particular so-called "Spanish fever" which decimated Europe in the wake of the First World War. But at the twilight of the USSR the Soviet propaganda introduced a false narrative to posit a parity between Stalin's treatment of Polish POWs and Pilsudski's attitude to captive Bolsheviks. The humbug of the Red military martyrs is alive and well under Putin, despite the impressive cooperative effort by Russian and Polish scholars alike, which conclusively has shown that Poland did not massacre Soviet POWs in 1920.

David Satter, the former Moscow correspondent, clearly and succinctly explains all these intricacies of Russia's pathology with great wisdom and compassion. He hopes to enlighten the Westerners about the sources of Moscow's condition and, perhaps, to help the Russians defeat their historical amnesia. Remembrance is an indispensable tool to imagine and implement freedom. Russia will learn this or relapse deeper into servitude.

Marek Jan Chodakiewicz is a Professor of History at the Institute of World Politics: A Graduate School of National Security and International Affairs in Washington, DC, where he also holds the Kościuszko Chair in Polish Studies.

Nje analizë e thellueme e këtij profesorin anglez, që zbulon me kompentencë shkencore tmerret e komunizmit, që po ka akoma njerëz të mufatun me atë ideologji, që duen t'i mbulojnëe t'i zvogëlojn ato tmertre, çuditnisht tani, kur ai sistem i yrryem na ka marrë të keqen një herë e për gjithmonë.

Te huajt për shqipërinë e shqiptarët

Piro. M. Tase

Nga Tepelena në Berat

(Shënime)

"Shtatori i vitit 1815. Fshatrat, disa nëpër faqet e maleve dhe të tjerët, të fshehur përgjatë luginave, kishin një pamje monotone dhe të trishtuar. Shtëpitë, ndërtuar me një lloj guri të zi si në të kuqëremtë, ishin të vendosura shumë larg nga njëra-tjetra. Konstruksioni i tyre shërbente për të na dhënë neve idenë e frikës dhe të pasigurisë që kishte pushtuar këtë vend kaq të varfër kohë më parë se sa të pushtohej nga Ali Pasha. Çdo shtëpi ishte e ndërtuar në trajtën e një kulle, me hyrje në katin e dytë, të paktën gati tre metro sipër themeleve të ndërtesës, dhe, sa herë që ndokush dëshironte të hynte apo të dilte, një shkallë prej litari, lëshohej apo ngrihej, përsëri lart,nga pjesëtarët e tjerë të familjes. Dritaret prej nga mund të hynte lirisht drita , mungonin. Nuk mund të shikoje as një copë qiell që nga brënda këtyre kullave apo burgjeve… Mund të shihje veç ndonjë frëngji të hapur në mur prej nga, gryka e një pushke, merrte në shënjë hasmin e fisit. Pothuajse të gjithë banorët e kësaj treve, ishin myslimanë edhe pse nuk dinin asgjë për shënjtorin e tyre, Muhametin. E kishin braktisur Kristianizmin për të vetmen arsye që të siguronin zotërimet e tyre edhe pse patën të njëjtin fat duke u përbuzur si nga grekët ashtu edhe nga osmanllinjtë. Disa vjet më parë ky vend ishte i pakalueshëm për udhëtarët e huaj. Ishte aventurë të ecje pranë ndonjë shtëpie, pasi pushka e fshehur pas frëngjisë, kishte vënë në shënjestër jetën tënde. Natyrisht, që edhe vet tirrania e Ali Pashës, plotëson imazhin e këtij shteti!"

Peizazh marramendës dhe banorë të qytetëruar

"Në të djathtë ngrihet Tomori, i cili, me linjat dhe madhështinë e vet, i ngjan Etnës, ngjashmëri, të cilën nuk ma ka zënë syri kurrë në ndonjë mal tjetër.

Maja e tij e lartë, e veshur me një mantel të bardhë dhe të shndritshëm dëbore, spikat mes reve me një shkëlqim mahnitës, tamam si një kështjellë e banuar mes atij terreni të hapur dhe malor.

..Kur u afruam vetëm disa milje në afërsi të Beratit, gati 12 orë larg nga Tepelena, na u shfaqën përpara fushat e mbjella, dhe vendasit e qytetëruar.

Aty ndaj të perënduar, u futëm në një luginë magjepsëse që zgjatej në drejtim të veriut, përmes së cilës, një përrua, pasi gjallëronte me ujin e vet të mbjellat përgjatë shtratit të tij, derdhej në Apsus.

Këtu, në të shumtën e rasteve, na zuri syri vila që ngjanin shumë me ato që kishim parë në Turqi. Disa nga ato ishin ndërtuar në breg të lumit dhe qenë të rrethuara nga lëndina apo nga plantacione dhe gardhe që do të dukeshin më tërheqës po të ishte treguar më shumë kujdes.

Ngjyrat mjaft të bukura të qiellit, hidhnin dritë mbi këtë peizazh që po na shfaqej përpara, ndërsa po merrnim anën e djathtë të shtratit të mrekullueshëm të Apsusit.

Gjithë ato kulla dhe minare! *Dhe në sfond, Tomori vigan me kokën mes reve, qëndronte si një monument madhështor*.

Peizazhi ishte aq marramendës sa ne e quajtëm të vetmen kënaqësi të mundshme që po na falte natyra pas gjithë atij udhëtimi të lodhshëm që nga Janina.

Të tilla skena mahnitëse, natyrisht, e përligjin frymëzimin e poetit, duke e ngacmuar atë që të shkruajë vargjet e "Çajld Haroldit" gjatë vizitës që ai bëri në këto vende egzotike.

Në një largësi prej gati gjysëm milje, tej luginës, një urë e mrekullueshme, me tetë harqe, mbi shtratin e lumit Apsus, të shpie në periferi të Beratit, në një varrezë piktoreske.

Në lindje të saj ngrihet ëmbël një kodër e kurorëzuar hijshëm prej mureve rrethues të kështjellës dhe të sarajeve të Pashait. S'kishte pak kohë që ato ishin ripërtërirë dhe lartësuar nga pushtuesi.

Që nga ura, një rrugë që kalonte përgjatë bregut të djathtë të lumit, të shpinte në qytetin e ndërtuar në luginë dhe, kryesisht, të shtrirë përreth faqes së pjerrët të anës jug-lindore të Akropolit.

U strehuam në shtëpinë e një tregtari që quhej Nikollaq, në lagjen Goricë, të vendosur në bregun e majtë të lumit Apsus, ku banonte një pjesë e të krishterëve. Edhe pse shtëpia e tij mbahej si nga më të mirat në këtë lagje të qytetit, dhe e shoqja e tij, na përgatiti dhomën më të mirë, afshi i rëndë dhe mbytës i ajrit, të kallte krupën!

Të zotin e shtëpisë e gjetëm të ulur pranë zjarrit, ndërsa afër tij rrinin me duar në prehër një gjysëm duzinë njerëzish, fytyrat e të cilëve ishte e vështirë t'i dalloje për shkak të resë së dëndur të tymit i cili, në vend që të kalonte në oxhak, përhapej i gjithë nëpër dhomë.

Se sa gjë e zakontë ishte kjo skenë për këta njerëz, e tregon më së miri dialogu që u zhvillua midis zotit Parker dhe pronarit të shtëpisë:

-C'e fumo qui, Signore! (Shumë tym, Zotëri!)

-Si, Signore, dal fuoco! (Po, Zotëri, nga zjarri!)

Ishte e pamundur që të më zinte gjumi.

U ngrita shpejt, pa lindur mirë dielli dhe shoqërova Mustafanë për në qytet. Sapo kaluam urën dhe mbritëm në periferi të qytetit, pamë turkeshat, të cilat hipur mbi kuaj, kishin dalë grupe-grupe për t'u freskuar në ajrin e mëngjesit. Ato qëndronin qiri përmbi shalë dhe me këmbët të mbërthyera pas yzengjive. Në të shumtën e rasteve, një shërbëtor ecte përpara çdo kali duke mbajtur nëpër duar një shkop të shkurtër.

Disa prej turkeshave ishin pa ferexhe, duke shpresuar, sipas mendimit tim, se në këtë orë nuk do të ndesheshin me sytë mëkatarë të të krishterëve.

Këtu, në Berat, ky mantel kishte ngjyre blu… përgjithësisht i përbërë nga një copë e plotë që mbërthehej me dy lidhëse nën mjekër.

Pazari që ishte pjesa me e hapur dhe më tërheqëse e qytetit të Beratit, shtrihej ngjitur me lumin dhe ishte i mbushur plot e përplot me të gjitha llojet e mallrave të sjella nga Kostantinopoja dhe qytetet e tjera të Maqedonisë si dhe mallrat e huaja të importuara nëpërmjet portit detar të Avlonës.

Pazari ishte plot me njerëz, ndaj dhe pamja e një të huaji nuk kishte se si të mos e rriste më shumë kureshtjen në sytë e banorëve.

…Sidoqoftë, Mustafai, i cili ishte me origjinë maqedonase, ishte mjaft i njohur dhe, kur takohej me ndonjë njeri, sipas zakonit të tyre shumë të lashtë, putheshin në faqe.

Ende nuk kishim vendosur të ktheheshim në banesën tonë, kur vëllai i tij, i cili kishte marrë vesh për ardhjen e Mustafait dhe kishte udhëtuar për gjithë ditën, që nga qyteti i Manastirit, për të takuar të vëllanë, zbriti nga kali tek porta e hanit.

Përqafimi i përmalluar dhe lotët që rodhën prej gëzimit nga sytë e këtyre dy burrave në këtë takim, ishte një gjë shumë prekëse ndaj ndjeva dëshirën për të mos i shkëputur nga njëri-tjetri, duke u kthyer i vetëm për në shtëpi."

Një vizitë për tek Hysen Beu

"Pasi hëngrëm mëngjesin, vendosëm t'i bëjmë një vizitë Hysen Beut, djalit më të madh të Muktar Pashait, i cili bënte këtu punën e kajmekamit të të jatit nën kujdestarinë e plakut Jusuf Arapi.

Beu i ri banonte në sarajet e vjetra, në këmbët e Akropolit. Ai na priti shumë përzemërsisht dhe shprehu dëshirën për të na shërbyer për çdo gjë gjatë gjithë kohës që do të qëndronim në zotërimet e tij.

S'ka asgjë për të shënuar, qoftë me pamjen e tij apo edhe me mënyrën e të sjellurit, vetëm se ishte më i dashur dhe më i kulturuar se sa i jati. Edhe pse s'kishte mbushur ende të nëntëmbëdhjetat, po bënte dy vjet që ishte martuar, por deri tani nuk kishte asnjë fëmijë.

Para se të niseshim, në intimitet, na tha se në brëndësi të Akropolit, disa gjurmë të hershme mund të paraqisnin interes për ne, ndaj dhe na ofroi kuajt e tij për të shkuar deri atje.

Ne e pranuam ftesën dhe, menjëherë, u dhanë urdhërat për përgatitjen e kuajve.

Para se të niseshim kaluam nga ajo anë ku rrinte Jusuf Arrapi për t'u përshëndetur me të, por nuk mundëm ta takonim pasi ishte pa qef. (Karakterin e tij prej gjaksori por edhe prej një njeriu jashtëzakonisht besnik, e ruajti deri sa vdiq-T.Hjugs.)

Sidoqoftë, i ishte bërë qefi nga vëmendja që ne kishim treguar për të dhe na dërgoi për drekë një gjel deti të mrekullueshëm.

Tek po zbritnim shkallët, dëgjuam trokitjen e patkojve të kuajve dhe hingëllimën e tyre. Ishin dy kuaj ngjyrë krem: për zotin Parker dhe për mua.

Na ra menjëherë në sy tërbimi i tyre i papërmbajtshëm, por ama, ato ishin edhe kafshët më piktoreske që unë kisha parë ndonjëherë në jetën time. Kofshët dhe gjokset e tyre të gjerë, qafët e trasha dhe paksa të përkuluara, kreshtat e valëvitura, kokat e vogla dhe sytë që u lëshonin xixa, e mrekullonin më tej atë përshkrimin e shkëlqyer oriental të kuajve të luftës që bën Job-i në librin e tij."

Duke iu ngjitur Akropolit

"Udhëtimi ynë me kalë nuk ishte aq i këndshëm sa e mendonim. S'ishte e lehtë të bëje zap këto kafshë të shkathta dhe me një shalë turke mbi kurriz, e cila pengonte ushtrimin e forcës së gjunjve në ecjen me kalë, karakteristikë kjo e stilit tonë dhe që të siguron një kalërim të këndshëm.

Qëndrimi im në shalë u bë aq i pasigurtë kur po i ngjiteshim Akropolit, sa, po të mos kishte vepruar me shkathtësi kafshari dhe të mbërthente frerët, në çast besova se do të kisha rënë me gjithë kalë në një hendek gati 100 këmbë të thellë.

Kur zbrita, kjo kafshë me huqe, ngriti këmbët me shumë forcë lart dhe vrapoi gojë hapur pranë meje, sa unë munda t'i shpëtoj vetëm duke nxituar të hipij mbi një shkallë të sarajeve.

Edhe një tjetër shkak u bë burim alarmi në këtë çast: në kala po bëheshin punime për riparime dhe zgjerime të hapësirave. Sheshi ishte pothuajse i mbushur plot me qerre dhe saja të tërhequra nga buajt. Këto kafshë nuk e duronin dot ngacmimin që u shkaktonte ngjyra e kuqe e ndezur e rrobave që unë dhe zoti Parker kishim veshur për të nderuar Beun në ceremoninë që ai organizoi për të na pritur neve. Disa nga kafshët, bile, i përmbysën qerret e tyre dhe e thyen zgjedhën në përpjekje për t'u çliruar prej saj.

Për ta qetësuar këtë gjullurdi, u futëm menjëherë brënda sarajeve, ku na priti me shumë përzemërsi, Ismail Beu, një turk i pasur prej Janine, vjehrri i Hysen Beut, që kishte ardhur këto ditë për të parë të bijën.

Pas asaj pritje tradicionale me kafe dhe cigare, për t'u çlodhur sado pak nga udhëtimi me kuaj, dhe pas një bisede interesante , ky osmanlli i sjellshëm dhe me kulturë të gjerë, na shoqëroi nëpër saraje dhe fortifikime duke shënuar pastaj me dorë në drejtim të një kodre, gati 500 m. larg, prej nga Aliu, në kohën e Ibrahim Pashait, qëllonte me katër topa këtë fortesë, deri sa e detyroi të kapitullonte.

Ibrahimi nuk kishte marrë masa mbrojtëse që më parë për të parandaluar depërtimin e gjyleve deri në sarajet e tij, ku ndodheshim ne, dhe, ku ende ruheshin të freskëta, dhe jo pa qëllim, gjurmët e tyre.

Të huajt kan folur e shkruar keq e mire per shqiptarët, dhe shqiptarët kanë folur e shkruar keq e mirë për ta. Reciproke !

Hjugsi për lashtësinë e Beratit

"Me të dalë nga porta e madhe e fortesës, na kapi syri disa ndërtesa masive, shumë të lashta, që përbëjnë pjesën e poshtme të gjithë konstruksionit të Kalasë, dhe që shtriheshin në disa drejtime për t'u bashkuar pastaj me muret. Ato kishin format e gërmadhave të një Isodomoni (Kompleks ndërtimesh) dhe blloqet e përdorura ishin të përmasave gjigande.

Prej këtej, bëmë një shëtitje përreth kodrës në të cilën, emri tepër i njohur 'akropolis' përdoret për të treguar se brënda mureve rrethues dikur ka egzistuar një qytet i vogël, gjurmët e të cilit i shikon tek kishat e shumta të kohës së Perandorië së Ulët.

Fillimisht ushqeva dyshime për moshën e kësaj pjese të qytetit dhe të asaj poshtë, në luginë, si shtojcë që nga koha e pushtimit turk. Në të vërtetë, tek "Jeta e Skënderbeut" unë kam gjetur këtë pohim lidhur me këtë fakt, se: ky qytet është ndërtuar mbi majën e një mali, ose siç shprehet vetë Meletius…

"…qytet i skalitur si kurorë mbi majën e një mali, i ngjashëm me fronin e një arqipeshkvi".

Se si është quajtur ky qytet në lashtësi, e kam të vështirë që ta përcaktoj. Disa e shikojnë zanafillën tek Eordea, që sipas mendimit tim, është gabim, sepse, sipas Plin-it eordensët i përkasin fiseve Peonia (lib.iv.c.10), fakt të cilin e konfirmon edhe Strabo-ni, i cili, në përshkrimin që i bën rrugës mjaft të njohur Egnatia, thotë se ajo kalon nga Apollonia përmes maleve Candavian të Ilirisë në Lychnidus dhe Pylon, vende të cilat ishin kufijtë midis Ilirisë dhe Maqedonisë: Prej andej ajo kalon përmes Heraclea-s duke iu shmangur Eord-it , dhe pastaj nëpër Edessa dhe Pella deri sa mbyllet në Thesalonik.

Polibi, gjithashtu, e vendos Eordian në Maqedoni dhe, po të njëjtën gjë bën edhe Thyreudides (lib.ii.p.164.ed.Duk.) Kështu, unë nuk shikoj të përmendet në ndonjë vend tek autorët e lashtë ndonjë qytet i quajtur Eordea.

Midis gjithë emrave të paqartë të këtij krahine, unë do të priresha për nga emri, Antipatrea, qytet që u pushtua nga Apustius, gjeneral i Sulpicius Galba, në luftën midis Republikës Romake dhe Mbretit Filip të Maqedonisë.

Por, e gjithë topografia e këtij vendi mbetet tej mase e errët dhe më e lehtë është të biesh në gabim se sa të arrish në një përfundim të saktë. Gjithashtu, vështirë është të përcakohet edhe koha kur ka filluar që të quhet me emrin që ka sot.

Nga shumë historianë bizantinë është përmendur me emrin Belagrada dhe Belagrita, ndërsa tani ai quhet Belgradi shqiptar (Arnaut Belgrade),(Leunclavii,Pand.Hist.Turc.p.444) për ta dalluar atë nga qyteti me të njëjtin emër i

vendosur në brigjet e Danubit.

Shumë herë, perandorët grekë e kanë bërë këtë vend kryeqëndren e tyre, sa herë që u duhej të vinin në këto vise për të ndëshkuar revoltat e shqiptarëve apo të fiseve të tjera që banonin në këto treva. Ai është i një rëndësie të veçantë dhe kyç i të gjithë kësaj zone."

Pasi vëzhguan fortifikimet e kësaj kështjelle dhe pasi shijuan kënaqësinë që u jepte peizazhi që shpalosej nga të gjitha anët e saj, u hipën kuajve tek porta e Sarajeve dhe filluam të zbrisnin poshtë Akropolit. "Unë, për vete,-tregon Hjugsi-nuk kisha ndonjë talent të veçantë për të ngarë kalin, por midis këtyre njerëzve, ishte e domosdoshme të mos shfaqje asnjë shënjë frike dhe pasigurie."

Pasi falenderuan Hysen Beun për mirësjelljen që ai tregoi gjatë kësaj vizite, ata u shpërndanë kafsharëve dhuratat e zakonshme dhe filluan të bëjnë një shëtitje, më këmbë, nëpër rrugën që kalonte përmes qytetit.

"Qëndra e qytetit qe e hapur dhe kishte trembëdhjetë xhami turke. Prej këtej, bëmë një shëtitje përmes varrezave, gjëja më e mrekullueshme në këtë pjesë të qytetit; pranë ndodhen një varg kopshtesh të mëdhenj , shumica të rrethuar me gardhe. Na bënë përshtypje tufat e mëdha me buaj që hanin bar apo freskoheshin në buzë të lumit, i cili në atë pjesë bëhej po aq i gjerë sa edhe Tamisi në Richmond...."

"Kur u kthyem në shtëpi, gjetëm të shtruar për drekë gjelin e mrekullueshëm të plakut Jusuf dhe në mbrëmje pritëm për një vizitë disa zotërinj të respektuar grekë: ata ishin të vetmit njerëz, deri në atë kohë, me të cilët mund të shprehnim sado pak simpatinë tonë për Ali Pashë Tepelenën. Ata na e kundërshtuan këtë mendim duke folur me një pasiguri të turbullt që buronte nga agresiviteti i tij gjatë viteve të sundimit të Ibrahimit; për më tepër, ishte e natyrshme, që synimet e këtij despoti, tanimë, janë kthyer nga veriu dhe se ai është shumë i dëshiruar të shtrijë sundimin e tij edhe në Pashallëkun e Shkodrës; kështu pra epërsia e një karakteri të tillë, në këtë pjesë të vendit nuk shikohej me sy të mirë.

…Ramë shpejt për të fjetur pasi, të nesërmen, na priste një rrugë e gjatë në drejtim të Këlcyrës, Përmetit dhe Konicës, përgjatë luginës së Vjosës."

Berat, 2 Tetor, 1815. -Pashai sipas porosisë, na dërgoi kuajtë dhe ne u nisëm rreth orës nëntë të mëngjesit në drejtim të rrënojave të Pollinas, Apolonia e lashtë. (*Thomas Smart Hughes*.-"Travels in Sicili, Greece and Albania." *London, 1820.*p.:254-261

"Shqiptari ka shumë pak dëshira në jetë. Pak bukë të bërë me kallamboq, ose me misër indian, dhe një kokër qepë me djath është e mjaftueshme për të. Një jatagan dhe një pisqollë në brez si dhe pushka e gjatë i qëndrojnë gjithnjë pranë, edhe kur fle në qiell të hapur me kokën të vendosur mbi një gur dhe fytyrën të mbular me palën e gunës së trashë. Qeleshen e tij nuk e heq kurrë nga koka, as në dimër dhe as në verë. Në vend të këpucëve mban ca opinga lëkurë të thurura vetë. Është e habitshme se si kërcen ai me to kur ecën nëpër rrugët e 'shtruara' me shkëmbinj…"

Cockerell

Charles Cockerell Udhëtime në Evropën Jugore

Charles Robert Cockerell (1788-1863), lindur në Londër, ishte një arkitekt britanik, arkeolog dhe shkrimtar i cili kujtohet për veprat e tij në fushën e arkitekturës dhe për rolin e tij në gërmimet e tempujve të Aegina-s dhe Bassae-sw. Nga viti1810-1817, ai udhëtoi gjerësisht në Greqi, Shqipëri, Turqi dhe Itali. Më 1819, ai ishte kryearkitekt i Katedrales së Shën Palit në Londër dhe në vitet më vonë u bë President i Institutit Mbretëror të Arkitektëve Britanikë.

Ishte Janar i vitit 1814, kur ai vendosi të ndërmarrë udhëtimin e tij në Greqi, dhe pastaj të rrezikojë të udhëtojë drejt veriut, për në Shqipëri (që filloi në Prevezë) për t'i bërë një vizitë Ali Pashës, ku ai bëri edhe disa skica të gjalla. Një përshkrim i kësaj vizite është dhënë në revistën e tij: "Udhëtime në jug të Evropës dhe Levanti, 1810-1817" (Londër 1903).

Oborri i Ali Pashës

"…Me pak vështirësi mundëm të mbrijmë në Prevezë. Këtu, porti është shumë i mirë por mjaft i cekët për të pranuar anije të mëdha dhe të vështira për t'u manovruar. Gjithçka në breg të detit duket e shkretë dhe në një gjendje të mjerueshme, vetëm me një përjashtim, pallati i vezirit që shkëlqente nga larg. Nga ana e detit ai lartësohej mbi themele prej gurësh të sjellë nga Actium dhe nga San Pietro, Nikopolisi i lashtë, jo larg prej andej. Ne, sigurisht që shkuam në Nikopolis. Rrënojat janë shumë interesante atje. … Nga Preveza shkuam në Salona, porti i Artës dhe prej andej u nisëm të nesërmen në mesditë. Ditën tjetër, duke kaluar nëpër një rrugë të shtruar me kalldrëm, u nisëm për në Janinë ose Joannina, kryeqyteti i Ali Pashës. Në vështrimin e parë, qyteti i madh dhe liqeni, sigurisht, të lënë mbresa, por jo për një kohë të gjatë, ashtu siç e kisha menduar. Na priti në shtëpinë e tij, ministri ynë, George Foresti, tek i cili hëngrëm drekën dhe u takuam me Kolonelin Church që sapo kishte mbritur nga Durrësi. Ditën tjetër, me qënë se veziri donte që të na shikonte, natyrisht, edhe ne nga ana jonë dëshironim ta takonim atë, Foresti na shpuri tek pallati ku ai po jetonte përkohësisht. Ai ka jo pak, por tetë të tillë në këtë qytet. Ky pallat është i bukur, por me një planimetri të keqe dhe jo aq tërheqës sa e prisja unë. Fillimisht, na shoqëruan për në katin e sipërm të pallatit, ku ndodhej salloni i pritjes dhe ku pamë gjithë ata djem të rinj dhe të pashëm por jo me ndonjë veshje të veçantë. Pritëm aty gati një gjysëm ore dhe pastaj na shpunë në një dhomë me tavan të ulët, në qoshe të së cilës qëndronte i ulur ky njeri i jashtëzakonshëm. Ai na përshëndeti me mirësjellje dhe tha se shpresonte që ne të kishim patur një udhëtim të mirë dhe donte të dinte në se na kishte pëlqyer Janina, dhe, nëse gjatë kësaj kohe na kishte munguar ndonjë gjë, ishte i dëshiruar që t'ia bënim të ditur, pasi ai na konsideronte si fëmijët e tij dhe se djemtë e tij, shtëpia e tij dhe gjithë pjesëtarët e familjes do të viheshin në shërbimin tonë. Ai pyeti nëse ndonjëri prej nesh dinte të fliste greqisht dhe kur e kuptoi se unë dija, më tha se kur e kisha mësuar dhe sa kohë kisha qëndruar në Athinë. Pastaj, duke vështruar nga Hjugsi i cili po qëndronte pranë zjarrit, urdhëroi që t'i sillnin një mbulesë, duke thënë se zjarri nuk është për të rinjtë por vetëm për pleqtë, dhe filloi të qeshë me shumë dashamirësi, mdërsa fytyra i mori një pamje aq të butë e duke shprehur një dashuri aq prindërore dhe të përzemërt sa e bëri atë burrw mjaft simpatik dhe të përsosur dhe që unë, duke sjellë nëpër mënd gjithë ato krime të përgjakshme që na kishin treguar rreth tij, nuk mund t'u besoja syve të mij. Së fundi, ai na tha se shpresonte të njiheshin më mirë së bashku dhe na u lut të qëndronim gjatë. Ne,megjithatë, u përkulëm në shënjë respekti dhe dolëm jashtë. Ditën e 6 Janarit e kaluam me Psallidën, i cili është mësues në një shkollë të Janinës. Në gjithë qytetin e mbajnë për njeri të mësuar. Përveç gjuhës greke, ai flet latinisht dhe shumë pak italisht. Prej tij unë mësova lidhur me masakrën e Gardhiqit. U mora tre ditë me vizatimin e një fragmenti brënda pallatit të Vezirit dhe pastaj mora një kostum të cilën ia dhashë për të veshur Psallidas i cili për një ditë të tërë pozoi para telajos sime dhe na zbaviti me hisorinë e tij rreth Eufrosinës së bukur dhe të brishtë dhe që ishte bërë e famshme në këtë qytet

Charles R. Cockerell
Portret nga D. Ingres, 1817.

. Fati i keq i saj ishte bërë objekt i një balade të trishtuar. Historia e jetës së saj është, sigurisht, një tragjedi e tmerrshme. Ajo rridhte nga një familje e mirë dhe u martua me një burrë të respektueshëm. Nuk dallohej për ndonjë kulturë apo shkollim të veçantë dhe nuk qe ndryshe nga vajzat e tjera greke, bashkëmoshatare me të, por ishte shumë e bukur dhe kishte një cilësi natyrore që të bënte për vetë që në shikimin e parë dhe që quhej si mbretëresha e bukurisë. Muhtari, i biri i Aliut, një njeri i shthurrur, është tërhequr nga bukuria e saj, dhe, duke konkuruar simpatizantët e tjerë që silleshin rreth saj, u bë i dashuri i saj. Gruaja e tij, të cilën ai e kishte lënë krejtësisht pas dore për hir të pasionit të tij të ri, ishte një nga vajzat e vezirit të Beratit, dhe, kur ajo u ankua te vjehri i saj për sjelljen e djalit të tij, ai (Aliu) ka vendosur t'i japë fund kësaj historie. Një mesnatë, u vu në krye të rojeve të tij dhe pa pritur, mu në mes të natës vajti befasisht në shtëpinë e Eufrosinës, dhe pasi e akuzoi atë si mashtruese e të birit dhe e quajti me lloj-lloj emrash të tjerë, e detyroi atë t'i jepte të gjitha dhuratat që ajo kishte marrë prej Muhtarit dhe e shpuri në burg bashkë me shërbëtoren e saj. Ditën tjetër, me qëllim që ta bënte atë si shëmbull e me anën e këtij dënimi të egër të mund të kontrollonte imoralitetin në qytet, në përgjithësi, dhe djalin e tij në veçanti, bashkë me nëntë gra të tjera të njohura për karakarakter të ulët, të cilat ai i kishte arrestuar që më parë, e çoi edhe Eufrosinën në buzë të greminës mbi liqen, atje ku ngrihen muret e një kalaje.. Shërbëtorja besnike refuzoi të shkëputej prej saj, dhe

bashkë me Eufrosinën, të lidhura për krahësh me njëra-tjetrën, ashtu si të gjitha vajzat e tjera, përfunduan në fund të atij shkëmbi fatal. Në mbrëmjen e 14 Janarit u thirrëm nga Ali Pasha. Atë ditë ai ndodhej në Pallatin e Kalasë që ishte e ngritur në buzë të një shkëmbi mbi liqen. Ne kaluam nëpër një galeri të gjatë të përshkruara nga Bajroni, dhe në një paradhomë të ulët, dhe prej andej në një apartament shumë të këndshëm, shumë të ngrohtë, me një zjarr të madh në të, dhe me një divan të zbukuruar nga një mbulesë me tantella ari. Aty qëndronte Aliu, atë ditë një figurë me të vërtetë orientale. Ai kishte një qylaf kadife, një mantel të stërmadh mbi supe, dhe po thithte tymin e duhanit nga një çibuk i gjatë persian, mdërsa në duart e tij mbante një libër.. Foresti na thotë se ai e bëri këtë me qëllim për të na treguar se dinte të lexonte. Varur pranë tij ishte një armë e vogël e veshur me diamante; në të djathtën e tij ishte, gjithashtu, një pendë freskuese. Në të majtë,ishte një dritare me pamje nga oborri, prej nga mund të shihje nëntë kuaj të pajisur me shalë dhe me frerë, gati për t'u shaluar. Më thanë se edhe kjo skenë është pjesë e ceremonisë së përcjelljes. Në pamje të parë dukej se, me qëllim apo jo, kësaj here pritja ishte më pak e ngrohtë se sa në fillim, dhe ai kërkoi shumë pak informacion nga ne. Ai pyeti Parkerin nëse ai kishte prindër dhe vëllezër, dhe kur dëgjoi se ai ishte djalë i vetëm, i tha se ishte mëkat që e kishte lënë vetëm nënën e tij. Nuk do të ishte më mirë sikur të kishte qëndruar në shtëpi?Më 15 Janar i bëmë një vizitë Mukhtar Pashës. Më 16 Janar vendosëm që të bënim një ekskursion për në krahinën e Sulit. Më 19 Janar moti u përmirësua dhe u nisëm në drejtim të lumit me shpresë se mund të ishte e mundshme për ta kaluar, por kur mbritëm në breg pamë së ai ishte i rrëmbyeshëm dhe i thellë. Njëri nga turqit që kishte marrë përsipër të na shoqëronte kundrejt një pagese të mirë, u fut në lumë dhe për një çast u zhyt brënda në ujë, ndërsa, rrjedha e fuqishme e ujit e mori me vete bashkë me kalin. Një nga vëllezërit e tij, duke ndjekur me ankth këtë skenë dhe pa qënë i zoti ta ndihmonte, filloi t'i lutej me zë të lartë Allahut e, në të njëjtën kohë, shkulte mjekrën nga tmerri e duke u dridhur i tërë. Edhe një minutë të kishte kaluar, ai patjetër që do të ishte mbytur por në çast, shërbëtori ynë, Antoneti, përveç se një kristjan i mirë edhe njeri me kurajo, u hodh menjëherë në ujë dhe e shpëtoi atë duke e nxjerrë në breg. I gjori turk, ishte gati pa ndjenja. Bëmë ç'ishte e mundur për ta sjellë në vete, dhe u detyruam të ktheheshim përsëri në Dervishinë. Gjithë rrugës, i ngeli goja te pushka që i kishte mbetur në fund të lumit në vend që të falenderonte Allahun, që shpëtoi për një qime nga vdekja, apo Antonetin që e nxori nga uji. Ditën tjetër u kthyem përsëri në Janinë. Unë e kisha bërë mëndjen top tani se ishte humnbje kohe ta vazhdoje më tej këtë udhëtim, ndaj dëshiroja që të ktheheshim sa më parë në Athinë. Por para se të largoheshim, une e shikoja si detyrim që të takoheshim edhe njëherë me Ali Pashën Me të mund të merreshe vesh shumë mirë. Unë isha i befasuar nga ngrohtësia e tij dhe humori që i pushtonte gjithë qënien kur bisedonte me ne. Në datën 26 Janar, shokët e mij, për çudi, u ngritën herët në mëngjes, dhe u gjendëm në një barkë me të cilën do të shkonim në një fshat të vogël ku unë do të merrja kuajt. Aty u përshëndeta me ta dhe i hipa kalit. Filloi të bjerë shi, dhe i lagur deri në palcë, mbrita tek Tre Hanet që të kaluar natën. Ditën tjetër shiu u kthye në borë por unë, megjithatë, u bëra gati për të vazhduar rrugën për në Mezovë. Na u desh që të kalonim disa herë nëpër një lumë, deri sa më në fund mbritëm në Mezovën e mbuluar nga bora. Skena ishte e mrekullueshme dhe vendi ishte tepër i begatë. Mezova është një fshat VIlehësh dhe njerëzit flasin një lloj greqishte të përzierë. Si piktor, nuk mund të them se fitova shumë, por asnjëherë nuk u pendova për kohën që shpenzova në Shqipëri. Klima ishte më e butë se në pjesën tjetër të Greqisë dhe mua më bëri shumë mirë. Peizazhet, edhe pse ishte stina e dimrit, ishin nga më të rëndësishmet, kurse njerëzit nga më të mrekullueshmit-jo shumë të bukur,por truprëndë dhe mjaft energjikë. Shqiptari ka shumë pak dëshira në jetë. Pak bukë të bërë me kallamboq, ose me misër indian, dhe një kokër qepë me djathë është e mjaftueshme për të. Një jatagan dhe një pisqollë në brez si dhe pushka e gjatë i qëndrojnë gjithnjë pranë edhe kur fle në qiell të hapur me kokën të vendosur mbi një gur dhe fytyrën të mbular me palën e gunës së trashë. Qeleshen e tij nuk e heq kurrë nga koka, as në dimër dhe as në verë. Në vend të këpucëve mban ca opnga lëkure që i ka thurrur vetë. Është e habitshme se si kërcen ai me to kur ecën nëpër rrugët e 'shtruara' me shkëmbinj…"

[Fragment nga Charles Robert Cockerell: *Travels in Southern Europe and the Levant, 1810-1817: the Journal of C. R. Cockerell, R. A.* (London: Longsman, Green and Co., 1903, reprint London: Routledge & Thoemmes Press, London 1999), p. 232-245.]

Fran Radoja

LORO BORIÇI

BIR' I DENJË I SHKODRES DERI NË VDEKJE

Në 100 vjetorin e Pavarsisë…

LORO BORIÇI (1922 – 1984)

Loro Boriçi, ka lé në qytetin e Shkodres me 22 Gusht 1922, në qytetin ku ka lé edhe futbolli shqiptar (1905), e asht edhe fidan i atij oazi të quejtun Gjimnazi i Jezuitëve të Shkodres, ku kanë mësue dhe janë formue breza të tanë qytetarësh intelektualë dhe dijetarë të Shqipnisë.

Në një oborr të vogel shkolle ku mori arsimin e mesem dhe kulturen qytetare shkodrane, dijti me nderthurë mësimin, formimin qytetar me até fizik, per me mbetë YII i pavdekshem jo vetem per Shkodren e mbarë Shqipninë, por edhe në plejaden e vet të lojtarëve të Europës.

Nuk kishte shkodranë që nuk dinte ku asht shtëpia e Boriçve, kur pyetej se ku gjindet.

Një nga shtëpijat ma të bukra per nga pamja, e ndodhun në rrugen e Badrave, po edhe e një familjes nga ma të vjetrat e në za të Shkodres, e dallueme në shenjë per nga nderi e burrnija e të Parëve. Një familje e paisun me virtytet ma fisnike të trashigimisë së Shqiptarit të nderuem.

Edhe djal' i atij truelli, Loro, deri në diten e vdekjes në Tiranë me 22 Prill 1984, pa mujtë kush me i ndrrue asnjë cilsi, e mbylli jeten me të gjitha tiparet e një Biri të denjë të Rozafës.

Në oborrin e asaj shkolle, Loro binte në sy per naltësinë e trupit, mbi 185 cm., dhe pikrisht aty në atë oborr veshi fanelen sportive, këpucet e futbollit dhe ishte nder ma të zgjedhunit e djelmënisë së viteve 1936, per me u quejtë "e ardhmja e Shoqnisë 'Vllaznija".

Në vitin 1937 asht lojtar i Shoqnisë "Vllaznija" të Shkodres. Një nder futbollistët e parë dhe krejtësisht i harruem nga burgjet komuniste, mjeku Luigj Radoja, kur e ka pa tue luejtë për heren e parë Loron në oborrin e shkollës, ka thanë: "Një fenomen që nuk ka shok në Ballkan!"

Një tjeter bashkohës i Tij, Prof. Ernest Helepiani, tregonte vetem fitore…fitore të një klubi shkodranë "Vllaznija", që trandi edhe gurt' e stadiumeve ballkanike me golat e bukur të Loros. Po Ai nuk mbeti vetem mbrenda cakut të kufijve tanë, mbasi shumë shpejt bie në sy të disa specialistëve italianë, të cilët i venë gishtin dhe e marrin në skuadrat ma të njohuna të tyne. Në vitin 1941 – 42 ka lujtë në Itali me klubin "Lazio", ndersa në 1942 – 43 me Romen.

Kthehet në Shqipni dhe nuk pranon me ndejë jashta Atdheut, ndonse asnjëherë nuk mund të arrihej me u mendue nga askush e ardhmja e Shqipnisë me izolomin e saj hermetik. Në vitin 1945 vazhdon me "Vllazninë" dhe fiton kupen e kampionatit kombtar të futbollit. Në vitin 1946 Shqipnia fiton kupen e kampionatit të shteteve ballkanike në Tiranë, në saje të golave të Loros, ku edhe me një teknikë të veten ban publikun me duertrokitë per fitoren e Kombëtares sonë. Edhe kur ishin mardhanjet në prishje mes dy qeverive tona komuniste, Loro u ndodh në Beograd dhe iu ofrue mundsia e qendrimit atje nga "miqtë" jugosllavë, po Loro refuzoi: "Jam Shqiptar dhe do të los me Kombëtaren Shqiptare, mbasi Ajo më ka ba të njohun si futbollist të tillë..."

E merr klubi "Partizani" në Tiranë dhe mbas vitit 1946 ka qendrue në kryeqytet.

Vazhdon me lujtë me skuadren e ushtrisë "Partizani" tue e mbajtë në krye të klasifikimit.

Tiparet e sjelljes së Tij e vendosin edhe në krye të klasifikimit si qytetar i nderuem.

Me sjelljen, kulturen dhe edukaten Loro, ban per vete edhe "ata" që e shikonin me synin e tyne prej fanatikësh, tue e konsiderue si nxanës të një "shkolle", të cilen pothuej në asnjë nga biografitë e tij të publikueme edhe sot "nuk tregojnë ku u formue dhe u zbulue ky talent i rrallë?"

Megjithate, nuk asht as i pari as i fundit që vazhdon të mbetet nder labirinte "harrese"!

Mbas disa "akrobacive" të njohuna ndaj elementit katolik shkodranë, nga vitet 1960, Loro gjindet në Durrës, Vlonë, me kombëtaren e të "Rinjëve", me shpresat...derisa kujtohen se asht i domosdoshem prap per me drejtue Kombëtaren e Shqipnisë.

Më ka tregue trajneri Cuf Pelinku, kur ishte në Hungari, porsa ka hy në një sallë të madhe të stadiumit Budapestit, ku në ballë ishte lojtari ma i madh i kohës Pushkas, rreth 250 X 130 cm., i shtati ishte Loro Boriçi nder dhjetë lojtarët ma të mirë të të gjitha kohëve në Europë.

Në vitin 1963, Loro merr "Medalje Argjendi" në lojnat e Ushtrive të Lindjes në Hanoi.

Në një nga ndeshjet që trajneri i Kombëtares sonë mbeti në kujtesen europjane, asht ajo me Gjermaninë Perëndimore, me 16 Dhjetor 1967, në Tiranë, perballë trajnerit Helmut Shén, ku me një mjeshtri të madhe Boriçi eleminoi skuadren gjermane nga kampionati Europjan.

Në vitet '70 Loro asht trajner i Kombëtares Kineze, ku perveç Kombëtares atje Ai ka ndihmue edhe disa skuadra të tjera futbolli, të cilat kanë shpreh edhe mirnjohjen e tyne.

Në vitin 1943...me daten 14 Tetor, kur shtëpinë tonë e kishte mbulue vaji nga vdekja e Babës tim,..Motrat e Loros, per me më largue nga tmerri, më moren e kemi shkue tek dhoma nalt, ku ishin vendosë shumë hurma per me u pjekë. Si fëmijë aty u "habita"!

Sa kujtime të paharrueshme ruen njeriu nga komshijtë e mbrekullueshem si Boriçtë...

Në vitet 1983 – 84 Loro smuret nga një kancer i perftuem siç mendonin mjekët nga pimja e panderpreme e cigares... Ishte në Itali per mjekim. Një ditë mjeku që e kuronte e pyet Loron: "Besoj e keni kuptue diagnozen?" Loro i pergjegjet: "Po, doktor! Ju falnderoj fort per kujdesin dhe mjekimin Tuej...Ma shumë u jam mirnjohës per kurimin Shpirtnor, të cilin nuk do të kisha mundsi me e pasë kurrë në Atdheun tim "ateist", në Shqipni!"

Loro Boriçi asht kenë Bir' i denjë i Shkodres deri diten e fundit të jetës...

Këta pak rreshta ia kushtoj në perkujtim të 90 vjetorit...Këtij Burri, që si pak kush e pat nderue Shkodren dhe Flamurin e Shqipnisë, kudo ku vuni kamben e Tij...

Kujtime e dëshmi pë Loron.

Në kohën kur vazdoja shkollën në Romë në një kolezh, të dielave na çonin me pa ndeshjet e futbollit ma të randësishme. Ne vitet fundit 40 - 43 filloj të njihej emni i një Boriçi, që sipas thanjeve, edhe une kujtoja fillimisht se ishte jugosllav, sipas italianeve. Une qëllova ne nje ndeshje me randësi të derbit Roma-Lazio, ku ndodhi qe centerfori i famshëm Piola ishte dëmtue dhe vendin e tij e kishte zanë ky Boriçi 19 vjeçar, i cili në atë ndeshje luejti shkelqyeshem e shenoi golin e fitorës për Lazio. Nga ajo ditë ai u ba i pazevendësueshëm e mori namë. Sigurisht se u mor vesh se ai ishte shqiptar. Vellai im ma i madh Genci, që dallohej edhe ai si futbollist me perspektive, e kishte takue disa here, e prej atij e mora vesh se Boriçi na ishte shkodran e mik yni. Ishin tre shqiptarët qe asokohë luenin ne skuadrat italiane. Llushta me Juventusi, Boriçi me Lazion e pastaj Romën, ,dhe Kryeziu me Romën. Të tre lojtarë të nivelit të naltë. Ma vonë Boriçin e kisha takue ne Tiranë, që lunente me Partizanin, deri kur u arrestova. Bile prej tij unë haja drekën në mensën e klubit Partizani.

Loro përfitoi nga mjeshtria e madhe e tij, si nder futbollistët ma të mirë te Europës. Pas fitimit të kampionatit balkanik, Loro u propozue qe te marrte pjesë ne skuadrën e zgjedhun Europiane ne nje ndeshje miqësore me Anglinë. Por qeveria shqiptare nuk e lejoi. Boriçi, ndonse nderohej nga halli si futbollist ipazevendësueshëm, mbahej nën synin e Sigurimit, sepse i takonte një famije reaksionare.

Deshën ta menjanonin nga aktivitetet sportive, popru ban shkak hungarezet siç tregon Pelinku, që ai të riabilitohej. Vetë Boriçi në shpîrt ishte antikomunist. Gja që e shprehte në shoqninë e ngushtë të tij.

Lek Pervizi

93 Vjetori i Futboll Klub Vllaznia

Aktualitet, Sport 4 Komente

KS Vllaznia është klub shqiptar i futbollit nga Shkodra , u themelua më 16 shkurt 1919. Cilesohet si "Djepi i Futbollit Shqiptar" per faktin se eshte ekipi me i vjeter ne Shqiperi. Më 1929 klubi ndryshon emrin dhe quhet Bashkimi Shkodran dhe në 1930 debuton në ligën kombëtare të Shqipërisë.

Klubi rimerr emrin e vjetër më 1935. Emri i klubit do të ndryshojë edhe dy herë të tjera. Në 1950 klubi u quajt Shkodra ndërsa në 1951 mori emrin Puna, Shkodër. Ndërsa që nga viti 1958 e deri më sot në skenën e futbollit është i njohur nën emrin me të cilin u themelua KS Vllaznia.

Sukseset

KS Vllaznia ishte nëntë herë kampione e Shqipërisë në futboll, ka fituar 6 herë Kupën e Republikës . Po ashtu KS Vllaznia ka marrë pjesë në kampionatet evropiane të futbollit: 3 herë ka marrë pjesë në Kupën e Kampionëve të Evropës , 3 herë në kupën e UEFA-së , 2 herë për kupën Intertoto, 2 herë për kupën e fituesve të kupave dhe tri herë për kupën ballkanike.

Ekipi i Vlaznisë i dha vendit lojtarë të shquem të rangut ndërkombëtar si

Boriçi,
Dibra
Rragami
Zhega
Bizi
Smijani
Mirashi
Ndoja, etj.

Në 100 vjetorin e Pavarësisë

Gezuar

edhe Klubit Vllaznia
në 93 vjetorin e themelimit, pikerisht kur shteti shqiptar sapo formohej e merrte frymë lirisht pas errësinës 500 vjeçare të pushtimt të perandorisë osmane.

Objekte figurative kushtuar Skënderbeut

Një shpatë e shkurtërdhe stema e Skënderbeut.

Thikë brezi me stemën e Skënderbeut

Donika Kastrioti-Komneni në bronz

Skënderbeu e bashkëluftëtarët e tij në një pjatë punuar në druri

Ilia S. KARANXHA

RIKRIJIMI I TRADITAVE KASTRIOTIANE NGA SHKODRANI

GJERGJ MARENA

Figura e lavdishme e Skënderbeut veç studiuesve e hulumtuesve të shumtë ka tërhequr rretth vehtes edhe një numur të pallogaritshëm krijuesish që në forma, në kohë e në vende të ndryshme janë përpjekur që me krijimet e tyre të rikrikrijojnë atë periudhe në imagjinatën dhe perceptimet tona. I takojmë këta krijues anë e mbanë Evropës por edhe përtej Oqeanit. I takojmë si piktorë, skluptorë, poete, prozatorë, dramturgë, kompozitorë apo artizanë të cilët me talentin e dashamirësinë e tyre na kanë trasmetuar shumë herë vepra të pavdekshme kushtuar Heroit Kombëtar Shqiptar. Zanafillën e këtyre krijimeve artistike mund t'i gjurmojmë qysh kur ishte gjallë vetë Skënderbeu i cili personalisht, edhe pse i angazhuar kryekëput me çështjet e luftrave të vazhdueshme, nuk ishte aspak indeferent kundrejt artit të kohës. Këtë krijimtari artistike e takojmë të prodhohet me të njëjtin pasion e dashamirësi edhe në ditët tona e përpara syve tanë. Bile nga shek. XIX shumfishimi i këtyre veprave është bërë me intensitet gjithmonë e më të madh e ka qënë pika bazë frymëzuese e rilindjes shqiptre dhe krijimit të shteti Shqiptar që tashti gëzon 100-vjet.

Duke kapërzyer shekujt dhe krijimet artistike të pamasa që detyrimisht dalin jashtë mundësive të këtij shkrimi qëndrojmë në Modena – Itali në shtëpinë e emigrantit shkodran Gjergj Marena i cili me iniciativë mjaft origjinale kishte meduar të rikrijonte objekte të cilat saktësisht ose përafërsisht mund t'i kishte përdorur Skenderbeu por edhe përjetësimin e figurës së tij dhe bashkëpuntorve të tij në medalione të posaçme. Të gjitha këto objekte janë punuar me mjeshtëri të lartë artistike nga specialistë të shquar në fushën e sektorit. Duke qënë objekte krejt të veçanta ato veç vlerave simbollogjike e artistike marin edhe vlerën si objekte të ralla për koleksionistët një prej të cilëve është vetë Gjergji që pasionin e tij të koleksionizmit e shikon të lidhur ngushtë me të kaluarën e shquar të popullit tonë. Jo pa qëllim revista e koleksionistëve italianë *Lame d'Autore* (Anno 14, luglio 2012, n* 56, ff. 64-66) i ka kushtuar një artikull të posaçëm Z Marena për këtë lloj pasioni nën titullin: *Rilindin thikat e gjigandit Skënderbe* me autore studiuesen e mirënjohur të albanollogjisë prof. Lucia Nadin dhe me skeda të pregatitur posaçërisht për disa objekte të koleksionit të tij nga Luljeta Qafa.



GJERGJ MARENA
në Ekspozitën

Kjo revistë prestigjose me një tirazh shumë të madh ka publikuar vetëm tre nga objeketet e finacuar prej Z. Marena që rikujtojnë kohën e Skënderbeut. Njëra është stema me shqiponjën dy krenare një punim me kualitetit të lartë në qeramikë dhe dy të tjera janë thika të cilat Z. Marena i ka rikrijuar sipas modeleve në grafika të epokës që tregojnë Skëndërbeun në dylyftim me turqit duke i firmuar ato herë me figurën e Skëndërbeut herë me përkrenaren e tij. Me një bukuri të veçantë janë kompozuar edhe medaljonet tek të cilët shikohet në në pjatë prej ulliri të gdhëndur figura e Donikës apo në një medalion të posaçëm ajo e Skëndërbeut e rreth e rrotull qëndrojnë komandantat e bashkëpuntorët e Tij të afërm.

Krijimin e një koleksioni të tillë me tematikë kryekëput shqiptare shkodrani Marena e ka shumë në zemër dhe për të mos mbetur në vend shikon ta pasurojë atë akoma më tej me pikësynimin që të rikthejë në ditët e sotme ato shkëndija të historisë sonë Rilindase të Arbërit të Madh që u shojtën me pushtimin turk.

Z. Marena, që në regjimin komunist ju mohua e drejta e studimeve universitare, me çiltërsinë e tij të pastër e me ndjenjën e flaktë të ardhedashurisë na thotë:

Nderimi dhe krenaria për qëndresën Arbërore kundër pushtuesve osmenë në shek. XV e prijsin e saj Gjergj Kastrioti Skënderbe si dhe gjithçka që përmbledh qerthulli i ti më kanë shoqnue qysh në rininë time.

Ato u mbrujtën si një ander atyre viteve kur në atë moshë të lindin plot, por në rrjedhën e jetës disa veniten, të tjera shuhen dhe ato që mbijetojnë i ke përherë mike në sofrën tënde.

Aso kohe (vitet 60-70 shek. XX) në atdheun e Kastriotit një koleksion privat ishte i pamundur, por sado i parealizueshëm, andra për ta pasur ndezej ma me flakë për ditë e më shumë në fantazinë time dhe tashti në këtë moshë 64 vjeçare është shndrue prush i pashuem i shpirtit tim.

Me tej me modestinë që e karakterizon Z. Marena ju shpreh mirënjohjen e sinqertë dhe falenderon gjithë ata artistë që me po aq pasion e mbështetën nisminën e tij mbasi tek e fundit ai e ndjen thellë në shpirt se në këtë mënyrë pasurohet akoma më tej arti dekorativ dedikuar Arbërit të Madhërishëm e në të njëjtën kohë i projekton ato në objekte të cilat mund të shndrohen gjithashtu si dekor i jetës sonë të përditëshme. Pra një ornament i pëlqyer për çdo shqiptari që e do vendin e tij.

Në vazhdim po referojmë disa nga punmet artistike të cilat sot janë pjesë e këtij koleksioni arbëror në shtëpinë e një shqiptari emigrant e atdhetar siç është Z. Marena.

1.Shpatë pëkujtimore e shoqerura me Përkrenaren. Burimi ikonografik: Grafika që paraqet dyluftimin e Skënderbeut me një persian në obotin e sulltanit të realizuar nga Jorg Breu më 1533.
Aplikimi : Mjeshtiri Vincenzo Apostoli - Brescia.
Gjatësija 560 mm. Çelik i derdhur K 100
.Doreza : Bri kaprolli siberian
Përkrenarja e Skënderbut në miniaturë. Derdhje në bronz

2. Stema e Skënderbeut
Punim në qeramikë nga Mirka Dorini – Mantova . Dimensionet 400x300x10 mm

3. Thikë brezi: SkënderbeuRealizimi e aplikimi i imazhit nga Stefan Gobec – Viena Austri

Gjatësia 330 mm Matreialet e përdorur: Çelik N690; Doreza: Fildisht nga mamuth fosil. Shëmbëlltyra e Skënderbeut – gdhëndje e punuar me dorë

4.Pjatë me shëmbëlltyrën e Skënderbeut dhe bashkëpuntorve të tij Punim artizanal në bronx – Kairo. Diametri 330 mm

5 Donika Kastrioti –

Derdhje në bronz aplikimi nga argjendari Luca Errico – Modena

Montuar mbi në pjatë ulliri të gdhëndur
Diametri 25 cm

Firenze 21.XI. 2012

Kartolinë e shpalljës së Pavarësisë, 1912

Luftëtarë të Labërisë

Hasan Riza Pasha me luftëtarë shqiptarë në Shodër.

Patrioti Prek Cali me luftëtarë të Malësisë Që luftuen për Liri e Pvarëssi.

Grup intelektualësh shkodranë që përjetuen shpalljën e Pavarësisë, ku një pjesë e tyne u pushkatuen e burgosën nga diktatura antishqipare komuniste.

Rroftë 100 vjetori i PAVARESISE !

Kalaja e Rosafatit që i qëndroi shekujve e pamposhtun.

Si e gjeti Shqipninë Pavarësia

Vllaznit Balkameni
Luftëtarë Kryengritës të Lirisë.
Krenaria e Korçës



Relief kushtue luftetarëve Kryengritës së Lirisë e Pavarësisë së Shqipnisë

28 Nëndor 1912

DITA E PAVARESISE SE SHQIPNISE